

Manuali i Rregullave
për
Shkollat Publike Worcester



2016-2017

Lutemi vini re: Formulari që ndodhet ne faqen e mbrapme të kopertines se ketij Manuali duhet të firmoset dhe t'i kthehet shkollës

WPS address: www.worcesterschools.org

Kalendari i Shkollave Publike të Worcester-it 2016 – 2017 RISHIKUAR 1/7/16



GUSHT						
S	M	T	W	T	F	S
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31			

SHATATOR						
S	M	T	W	T	F	S
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	

TETOR						
S	M	T	W	T	F	S
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31					

NENTOR						
S	M	T	W	T	F	S
	1	2	3	4	5	
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30			

DHJETOR						
S	M	T	W	T	F	S
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	31

JANAR						
S	M	T	W	T	F	S
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				

SHKURT						
S	M	T	W	T	F	S
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28				

MARS						
S	M	T	W	T	F	S
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	31

PRILL						
S	M	T	W	T	F	S
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30						

E Hënë, 29 Gusht, 2016: Dita e Parë e Shkollës për Klasat 1-12
E Martë, 6 Shtator, 2016: Dita e Parë e Shkollës për PreK & Kopshtin

E Hënë, 12 Qershor, 2017*: Dita e Fundit e Shkollës.
Dita e Fundit e Shkollës për Maturantët (seniors): 24 Maj, 2017*

* Kjo datë mund të ndryshojë si rezultat i numrit të ditëve të dëborës që do të përdoren gjatë vitit shkollor..

Përfundimi i përcaktuar i tremujorëve:

- 4 Nëntor, 2016
- 20 Janar, 2017
- 7 Prill, 2017
- 12 Qershor, 2017 ose dita e fundit e shkollës

= **DITET NE TE CILAT NXENESIT NUK KANE SHKOLLE**

MAJ						
S	M	T	W	T	F	S
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31			

QERSHOR						
S	M	T	W	T	F	S
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	

2016	2017
25 Gusht – Dita e Paraqitjes për Mësuësit/Stafin	1 Janar – Dita e Vitit të Ri
26 Gusht – Trajnim për Stafin	16 Janar – Martin Luther King
29 Gusht – Dita e Parë e Shkollës	20 Shkurt – Dita e Presidentit
5 Shtator – Dita e Punës (Labor Day)	21-24 Shkurt – Pushimet e Dimrit
7 Tetor – Trajnim për Stafin	14 Prill – Ditë Jo-Shkolle
10 Tetor – Dita e Kolombit	17 Prill – Dita e Patriotëve (Patriots Day)
11 Nëntor – Dita e Veteranëve	18-21 Prill – Pushimet e Pranverës
23-25 Nëntor – Thanksgiving	29 Maj – Dita e Përkujtimit (Memorial Day)
26-30 Dhjetor, 2 Janar	12 Qershor – Dita e Fundit e Shkollës
Pushimet e Festave të Fundvitit	

KORRIK						
S	M	T	W	T	F	S
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31					

Shkollat Publike Worcester janë një Mundësi e Barabartë/Punëdhënëse me Veprim Afirmativ/Institucion Edukimi që nuk bën dallim pavarësisht racës, ngjyrës, gjinisë, moshës, besimit fetar, origjinës kombëtare, gjendjes civile, prirjeve seksuale, identitetit gjinor, paafetësisë apo vendstrehimit. Shkollat Publike Worcester sigurojnë punësim të barabartë dhe një sërë programesh edukimi të përgjithshëm dhe profesional. Për më tepër informacion në lidhje me këtë Mundësi të Barabartë /Veprim Afirmativ, kontaktoni Manaxherin e Burimeve Njerezore, 20 Irving Street, Worcester, MA 01609, 508-799-3020

KOMITETI I SHKOLLËS

Kryetar i Bashkisë Joseph M. Petty, -Kryetar

Brian A. O'connell, -Zëvendës Kryetarja

Dianna Biancheria

Donna M. Colorio

John L. Foley

Molly O. McCullough

John F. Monfredo

MESAZHI I KRYEINSPEKTORIT

Shkollat Publike Worcester kanë kenaqësinë t'ju paraqesin Manualin e Politikave për vitin 2016-2017, i cili informon nxënësit dhe prindërit/ kujdestarët mbi rregullat dhe procedurat e rëndësishme që janë në fuqi në sistemin e shkollave tona.

Faleminderit rishikoni këtë manual me fëmijën tuaj dhe e mbani atë për referenca të ardhshme. Lutemi vini re që janë bërë disa ndryshime të procedurave dhe politikave nga viti i kaluar. Kërkojmë që ti kushtoni vëmendje të veçantë këtyre ndryshimeve. Urimet më të mira dhe suksese në vitin shkollor 2016-2017.

Maureen F. Binienda

Udhëzimi i Shtesës ose Ndryshimit të Rregullave për 2016-2017

	Faqe
Regjistrimet	1
Fillorja- Klasa e 6-të.....	1
Edukimi i Fëmijëve të Pastrehë.....	26
Kodi i Sjelljes	
Vonesa të Shumta.....	44
Telefonat Celularë, Pajisjet Elektronike, dhe Pajisjet me Lazer.....	44
Rregullorja per Mbarvajtjen e Shendetit	
IV. Mundësi për aktivitete fizike dhe Edukim Fizik.....	59
Transporti Aktiv për në dhe nga Shkolla.....	60
Rregullorja e Departamentit të Shëndetit Publik.....	66
Udhëzimet për mesazhet elektronike.....	93
Testimi Shtetëror.....	95
Proceset e Apeleve për MCAS.....	100

Regjistrimi.....	1
Dr. James L. Garvey qendra e informimit të prindërve.....	1
Kërkesat e Shkollës për Vaksinim.....	2
Rregulli i Regjistrimit.....	2
Fillorja (klasat K-6).....	2
Tetë-vjeçarja/e Mesmja (klasat 7-12).....	3
Rregulli i Transferimit Vullnetar të Kontrolluar.....	3
Rregulli për Studentët e Huaj që nuk janë Rezidentë, që kanë Vizë të Tipit J-1.....	5
Rregullat Ligjore.....	6
Procesi i Caktuar.....	6
Mosdiskriminimi.....	16
Ngacmimet Seksuale.....	19
Ligji Kundër Dhunës së Qëllimshme Mendore e Fizike.....	23
Zotërimi i armëve.....	25
Përdorimi i Duhanit.....	25
Zonat pa Drogë në Shkollë.....	26
Edukimi i Fëmijëve të Pastrehë.....	26
Shërbimi Përzgjedhës.....	28
Regjistri i Personave që Kryejnë Shkelje Seksuale.....	28
Rregulli i Betimit për Besnikëri dhe "Momenti i Heshtjes".....	28
Të Dhënat e Regjistruara të Nxënësit.....	29
Rregulli mbi Njoftimin e Prindërve në Lidhje me Edukimin Seksual.....	35
Njoftimi Vjetor i Prindërve/Kujdestarëve për Mbrojtjen e të Drejtave të Nxënësit Amendamenti (PPRA).....	36
Rregulli Vullnetar i Uniformës së Shkollës.....	36
Rregulli i Kodit të Veshjes së Nxënësve.....	36
Punishja e Shkollës Mesme Teknike të Worcester-it dhe Rregulli i Uniformës.....	37
Akti 2001, Asnjë Fëmijë të Mos Mbetet Mbrapa.....	37
Kodi i Sjelljes.....	38
Filozofia.....	38
Disiplina e Vendosur nga Shkolla.....	39
Sjellja e Pahijshme.....	41
Ngacmimet.....	47
Atletët dhe Pjesëmarrësit në Aktivitete Shkollore.....	49
Disiplinimi i Nxënësve Sipas Nenit 504 të ADA-s.....	52
Nxënësit me Paaftësi Fizike ose Mendore që Marrin Shërbime të Edukimit të Posaçëm....	54
Zgjidhja e Problemeve të Shkollës.....	55
Shërbimet e Shëndetësore të Nxënësve.....	56
Rregullorja mbi Mbarvajtjen e Shëndetit.....	56
Rregullat e Departamentit të Shëndetësisë.....	65
Administrimi i Barnave.....	66
Rregullat për HIV dhe për AIDS.....	67
Ndjekja e Shkollës nga Nxënëset Shtatzëna.....	69
Procedurat 911.....	69

Sugjerime Udhëzuese për Përdorimin e Sigurt të Çantës së Shpinës.....	69
Transporti.....	70
Programi i Transportit.....	70
Privilegjet e Autobusit.....	71
Nxënësit e Transferuar.....	72
Të Pastrehët.....	72
Kufiri Prej dy Miljesh.....	72
Ndalesat dhe Rruga e Ndjekur nga Autobusi i Shkollës.....	72
Siguria dhe Sjellja.....	73
Përdorimi i Autobusëve të Shkollës.....	73
Siguria në Laboratorët dhe Masat e Sigurisë.....	74
Masat e Sigurisë.....	74
Mposhtja Fizike.....	74
Dollapët e Nxënësve.....	74
Takimi me Nxënësit Gjatë Orarit të Shkollës.....	75
Vizitorët në Shkollë.....	76
Përdorimi i Automjeteve.....	76
Shërbimet e Nxënësve.....	77
Departamenti i Studimit të Fëmijëve.....	77
Neni 504-Dekteri mbi Amadamentin për Amerikanet Me Aftësi të Kufizuara.....	77
Edukimi i Posaçëm.....	80
Informacioni dhe Procedurat e Punësimit.....	81
Edukimi në Shtëpi dhe Spital.....	82
Arsimimi në Shtëpi.....	82
Rregullat e Mësimdhënies.....	83
Rregullat e Detyrave të Shtëpisë.....	83
Shkollat Filllore.....	83
Shkollat e Mesme.....	84
Procesi i Shperndarjes së Teksteve.....	85
Rregullat e Promovimit.....	85
Fillorja (klasat K-6).....	86
Klasat 7-8.....	86
Pandershmëria Akademike.....	86
Rregulli i Frekuentimit.....	87
Mungesat e Arësyeshme.....	87
Vonë për Shkollën / Shkarkimi i hershëm nga Shkolla.....	88
Përgjegjësia e Personelit Mësimdhënës.....	88
Mosdhënia dhe/ose Humbja e Kreditit.....	89
Mungesat pa Arësy.....	89
Rregullat e Frekuentimit të Shkollës së Mesme dhe Kreditet Akademike.....	89
Rregullat e Transmetimeve Televizive.....	90
Siguria e Internetit dhe Rregullat e Pranimi të Përdorimit.....	90
Rregullat e Ekskursioneve.....	93
Rregulli i Titullit të Nderit –Shkolla e mesme (9-12).....	94

Rregulli i Titullit të Nderit-Shkolla 8-vjeçare.....	94
Programi i Testeve të Standardizuara.....	94
Kërkesat e Diplomimit për Shkollën e Mesme.....	97
Kërkesat për Lëndët e Detyruara për Diplomim.....	99
Minimumi Kurseve të Detyruara për Pranim në Kolegjet Shtetërore të MA.....	100
Proceset e Apeleve për MCAS	100
Rregulli i Vendosijes së Klasave të Avancuara.....	101
Mesatarja e Pikëve në Përshtatje me Nivelin e Klasës.....	101
Kurset e Kolegjit për Nxënësit e Shkollës së Mesme.....	103
Çështje të Përgjithshme të Shkollës.....	103
Rregullat e Hapjes me Vonesë/Hapjes më Herët/Anullimit të Shkollës.....	103
Rregullorja dhe Procedura për Pushimet.....	106
Prindërit dhe Komuniteti.....	107
Këshillat Prind Këshillimore.....	107
Mundësi Mbështetje për Prindërit/Kujdestarët.....	108
Rregullat për Personelin Vullnetar.....	109
Politika mbi Mediat e Qarkut.....	110
Numërori Telefonik.....	112
Formulari që duhet firmosur për Marrjen e Manualit.....	faqja mbrapa
Kalendar.....	Brenda faqes së parë
Anëtarët e Komitetit të Shkollës.....	i
Mesazhi i Kryeinspektorit.....	ii

REGJISTRIMET

Qendra e Informimit të Prindërve Dr. James L. Garvey

Është e Hapur Gjatë Gjithë Vitit nga dita e Hënë- të Premten

07:30AM - 16:00PM

768 MAIN STREET

SHATTUCK BUILDING

JACOB HIATT COMPLEX

Telefoni: (508) 799-3299, (508) 799-3068, (508) 799-3069

Për të regjistruar një nxënës në Shkollat Publike Worcester, duhet të paraqitet dokumentacioni i mëposhtëm.

1. Certifikatë e Lindjes ose Pasaportë
2. Kujdestarët ligjorë ose të rriturit përgjegjës në familje të cilët mund të shërbejnë si kontakte në raste urgjence.
3. Vërtetim Banimi në Worcester (fature dritash, telefoni, qera, kredijetj.) ose FORMULARI I PLOTËSUAR I VERIFIKIMIT TË ADRESËS SE NXENESIT
4. Vaksinimet e detyrueshme nga shteti
5. Dokumentat nga shkollat e mëparshme, nëse ekzistojne

Kërkesat për vaksinimin dhe dokumentat e shkollës mund të mos kërkohen përkohësisht për studentët të cilët kualifikohen si të pastrehë sipas ligjit McKinney Vento për Ndhimën e të Pastrehëve.

PARASHKOLLORE – KLASA 6

Të gjithë studentet (parashkollorë - klasa 6) që regjistrohen, ose transferohen në, ose brenda Shkollave Publike Worcester, duhet ta bëjnë regjistrimin te Qendra e Informimit të Prindërve Dr. James L. Garvey.

Personeli i Qendrës së Informimit të Prindërve Dr. James L. Garvey:

1. Do t'ju japë informacion prindërve/kujdestarëve në lidhje me politikën e caktimit të nxënësve.
2. Do të ndihmojë prindërit/kujdestarët në zgjedhjen e mjedisit arsimor më të përshtatshëm për nevojat e fëmijëve të tyre.
3. Do të ndihmojë prindërit/kujdestarët në fazat fillestare të regjistrimit të kërkuara nga shkolla p.sh. dokumentat e lindjes dhe të vaksinimit, Formularët e plotësuar të anketës për gjuhën që flitet në familje, përshtatshmërinë për ndihmë mjekësore, etj.
4. Do t'i përgjigjen pyetjeve në lidhje me politikën e shkollës.

Rregullat e shtetit dhe federalit kërkojnë që të gjitha shkollat të përcaktojnë gjuhën (gjuhët) e folur në shtëpinë e çdo nxënësi me qëllim që të caktohen nevojat specifike gjuhësore të tyre. Nëse një gjuhë tjetër nga Anglishtja flitet në shtëpi, Distriktit i kërkohet të bëjë vlerësime të mëtejshme që të përcaktojë nëse nxënësi është Nxënës Fillestar i Gjuhës Angleze dhe të vendosë atë në një program mësimor të përshtatshëm që të mbështesë lëndët mësimore dhe mësimin e gjuhës.

KLASA 7 - 12

Studentet e rinj në klasat 7-12 rregjistrohen ne Qendren e Informimit të Prindërve Dr. James L. Garvey. Studentet ne klasat 7-12, qe transferohen brenda Shkollave Publike Worcester, do te bejne transferimin ne shkollat perkatese bazuar ne adresen e tyre te re. Studenteve te klasave 9-12 u jepet mundesia te rregjistrohen ne shkollat e mesme perkatese te tyre. Nxënësit potencialë të Anglishtes duhet që të plotësojnë regjistrimin tek Qendra e Informimit të Prindit Dr. James L. Garvey.

Kërkesat për vaksinim për Shkollat e Massachusetts për Vitin Shkollor 2016-2017*

Cerdhja/Parashkollorja

3 doza Hepatiti B
4 doza DTaP/DTP
3 doza Polio
3 ose më shumë doza të HIB
1 dozë e MMR
1 dozë e Varicella

KOPSHTI

3 doza Hepatiti B
5 doza DTaP/DTP
4 doza Polio
2 doza MMR
2 doza Varicella

KLASAT 1-6

3 doza Hepatiti B
4 doza DTaP/DTP ose 3 doza TD

3 doza Polio
2 doza Variçela
2 doza MMR

KLASAT 7-12

3 doza Hepatiti B
4 doza të TDaP/DTP ose 3 doza të TD
plus 1 dozë të Tdap
1 dozë të Tdap deri në 3 doza
2 doza Variçela
2 doza MMR

Rregulli i Regjistrimit

Fillore (Kopshti - klasa e 6-të (K-6))

Nxënësit në Shkollat Publike Worcester, do të ndjekin shkollën bazuar mbi linjat ndarëse të distrikteve ku banojnë. Ata kanë të drejtën të ndjekin gjashtë shkollat “magnet” të qytetit bazuar mbi numrin e vendeve që ekzistojnë dhe nëse shkollat “magnet” plotësojnë kriteret e Planin e Ç’izolimit të Shkollave Publike të Worcester-it. Pesë shkollat “magnet” të qytetit tonë janë (1) Chandler Magnet School, (2) City View Discovery School, (3) Hiatt Magnet School (4) Norrback Avenue School, dhe (5) Worcester Arts Magnet School. Nxënësit e shkollës fillore që banojnë në Noth Quadrant kualifikohen të ndjekin shkollën magnet të North Quadrant, Shkollën Roosevelt, sipas hapësirës së disponueshme. Në zbatim të politikës së Transferimit Vullnetar të Kontrolluar, transferimet lejohen në çdo shkollë brenda zonës nëse transferimi ndikon pozitivisht në përqindjen e minoritetit të shkollës, dhe nëse ka vende.

8 Vjecare (klasat 7-12)

Në vartësi të distriktit të shkollës në të cilën banon nxënësit, ai/ajo mund të ndjekë shkollën e mesme lokale. Kjo përcaktohet nga klasa më e fundit që nxënësi ka përfunduar dhe ka kaluar, përveç rasteve kur është kërkuar leje e posaçme nga prindi/kujdestari për të ndjekur një shkollë tjetër. Ndjekja e Shkollës së Mesme Teknike Worcester, kryhet mes aplikimit dhe procesit të përzgjedhjes të aprovuar nga Departamenti i Edukimit të Shtetit.

Rregulli i transferimit vullnetar të kontrolluar

I. Kushtet për transferimin jashtë distriktit

Është rregull i Shkollave Publike Worcester, që nxënësit të ndjekin shkollën bazuar në kufijtë e distriktit ku banojnë. Përjashtimet nga ky rregull lejohen kur zbatohet "rregulli i transferimit vullnetar të kontrolluar" e cila lejon transferime në shkolla të tjera fillore, 8-vjecare dhe të mesme ose në shkollat "magnet" në mbarë qytetin sipas këtyre kushteve:

- a) Duhet të ketë vende në shkollën që merr.
- b) Shkollat fillore, 8-vjecare dhe të mesme që kanë përqindje minoriteti më të madhe se mesatarja e tërë qytetit më 1 tetor të çdo viti do të ndjekin kufizimet e mëposhtme:
 1. Nxënësit nga minoritetet nuk do të lejohen të transferohen në një shkollë e cila ka përqindje minoritetesh më të madhe se mesatarja e shkollave në tërë qytetin më 1 tetor të çdo viti.
 2. Studentët e mazhorancës nuk do të lejohen të transferohen nga shkolla përveç rasteve kur shkolla dërguese ndjek ligjin dhe shkolla marrëse nuk ndjek ligjin pasi ka përqindje minoriteti më të madhe se 15 përqind mbi nivelin e minoritetit në shkollat e qytetit.
 3. Të gjithë studentët, si ata të minoriteteve ashtu dhe ata të mazhorancës, kanë të drejtën të ndjekin shkollat "magnet" të qytetit dhe shkollat 8 Vjecare "magnet" të qytetit. Në mënyrë që të zbatohet ky kriter, shkollat "magnet" duhet të zbatojnë kriteret.
- c) Shkollat fillore, 8-vjecare dhe të mesme që kanë përqindje minoriteti më të vogël se mesatarja e tërë qytetit më 1 tetor të çdo viti do të ndjekin kufizimet e mëposhtme:
 1. Nxënësit nga mazhoranca nuk do të lejohen të transferohen në një shkollë e cila ka përqindje minoritetesh më të vogël se mesatarja e shkollave në tërë qytetin më 1 tetor të çdo viti.
 2. Nxënësit e minoriteteve do të lejohen të transferohen nga shkolla përveç rasteve kur shkolla dërguese plotëson kriteret dhe shkolla marrëse nuk plotëson kriteret pasi ka përqindje minoriteti më të vogël se 15 përqind nën nivelin e minoritetit në shkollat për tërë qytetin.

3. Të gjithë nxënësit, si ata të minoriteteve ashtu dhe ata të mazhorancës, do të kenë të drejtën të ndjekin shkollat "magnet" për tërë qytetin dhe shkollat e 8-vjecare "magnet" për tërë qytetin. Në mënyrë që të zbatohet ky kriter, shkollat "magnet" duhet të plotësojnë kriteret.
 - d) Kërkesat për transferimet vullnetare do të shqyrtohen për të parë nëse kanë paaftësi shëndetësore të dokumentuara plotësisht dhe rrethana të tjera unike.
 - e) Në disa shkolla ofrohen leksione në dy gjuhë, spanjisht e anglisht dhe programe të posaçme për edukim. Çdo nxënësi që i nevojiten këto shërbime do të regjistrohet në shkollën që plotëson nevojat e vlerësuara të tij/të saj.
 - f) Një nxënës që ndërron banesë dhe hyn në klasën e 6-të, 8-të ose 12-të mund ta përfundojë vitin në shkollën ekzistuese nëse banon përsëri në Worcester dhe ka marrë lejë nga drejtori i shkollës jashtë distriktit që të qëndrojë në shkollën ku ka qenë.
 - g) Nxënësit që regjistrohen në një program "magnet" jashtë distriktit ose që regjistrohen në Shkollën e Mesme Teknike Worcester duhet ta përfundojnë vitin në shkollën jashtë distriktit.

II. Procedurat e Aplikimit për "Transferim Vullnetar"

Formularët e aplikimit dhe deklaratën e rregullave mund ta merrni në Qendrën e Informimit të Prindërve ose në Zyrën e Menaxherit të Zonës:

Qendra e Informimit të Prindërve: (508) 7993194
 Burncoat/South Quadrants (508) 799-3264
 Doherty/North Quadrants: (508) 799-3221
 * Technical Quadrant: (508) 799-3499

*Aplikimet për Shkollën e Mesme Teknike të Worcester-it mund të merren në të gjitha zyrat udhëzuese 8-vjecare ose në Zyrën e Pranimeve të Shkollës Teknike.

- a) Aplikimi duhet të plotësohet dhe të kthehet në zyrën e duhur.
- b) (K-6) Qendra e Informimit të Prindërve për nivelin elementar (7-12) Kordinatori i Ndihmes për Shkollën dhe Komunikimin në Zyrën e Menaxherit të Zonës.
- c) Miratimi apo refuzimi do t'i dërgohen me shkrim në shtëpi prindit/kujdestarit dhe një kopje e shkresës do t'i dërgohet drejtorit/eshës të shkollës dërguese dhe marrëse.
- d) Një kopje e aplikimit dhe letra e miratimit apo refuzimit do të mbahet në dosje në Zyrën Menaxherit të Zonës.

III. Procesi i Apelit për Raste të Vështira

Nëse prindi/kujdestari nuk është dakord me vendimin e Menaxherit të Zonës, duhet të apelojë përpara ditës së parë të vitit shkollor. Do të lejohet një periudhë maksimale prej dy javësh për të apeluar vendimin me shkrim tek Kryetari i Bordit të Apeleve për Rastet e Vështira në Qendra e Informimit të Prindërve, 768 Main Street, Worcester, MA 01610.

Bordi do të shqyrtojë secilin rast që i është paraqitur dhe do të marrë vendime në kohë në lidhje me apelin. Një kopje e vendimit do t'i dërgohet prindit/kujdestarit dhe Menaxherit përkatës të Zonës. Procedimet e Bordit të Apeleve për Rastet e Vështira do të regjistrohen dhe do të arkivohen nga personeli i Zyrës së Menaxherit të Zonës.

Rregullat për Studentët e Huaj që nuk janë Banorë, por kanë vizë të tipit J-1

J-1 Nxënësit e huaj që nuk janë rezidentë

Pranimi:

- Deri në javën e parë të janarit çdo drejtor i Shkollave të Mesme Worcester, do të përcaktojë se sa vende ka (jo më pak se tre) në shkollën e tij/të saj për të pranuar nxënës të huaj që nuk janë banore, por që familjet mikpritese të tyre jetojnë në distriktin e tyre (ose të cilët përndryshe marrin leje të posaçme nga Menaxheri i Sektorit mbi baza të vende të disponueshme) për vitin shkollor pasardhës. Asnjë drejtor/eshë shkolle nuk do të pranojë më shumë se tre nxënës të huaj që nuk janë banore deri sa ky përcaktim është bërë dhe dërguar tek Menaxheri i Sektorit.

Kriteri për ndjekjen:

- Studentët e huaj në programe shkëmbimi duhet të paraqesin prova të vërtetuara të ecurisë akademike të mëparshme nga shkolla(t) e mesme në vendin e tij/të saj të lindjes.
- Transkriptimet nga agjencitë ndërmjetëse apo sponsorizuese nuk do të pranohen si dokumenta të përshtatshme për përcaktimin e ecurisë së mëparshme akademike përveç rasteve kur ato kanë vullën e shkollës dhe/ose dorëzohen në një zarf të mbyllur nga shkolla.
- Pranimi në Shkollat Publike Worcester do të bëhet në baza (1) një vjeçare me organizatën sponsorizuese ose kujdestarin dhe duhet të aplikohet përsëri për të vazhduar studimet.
- Pasi të jetë pranuar, nxënësi i huaj do t'i nënshtrohet të gjitha rregullave, politikave, rregulloreve dhe procedurave ashtu sikurse aplikohen për të gjithë studentët në sistem.
- Sistemi do t'i japë një dëftesë të rezultateve akademike për kohën që nxënësi i huaj ka ndjekur shkollën e sistemit organizatës sponsorizuese ose prindit/kujdestarit, sipas kërkesës.
- Nxënësit e huaj që kanë një vizë të tipit J-1 dhe marrin pjesë në këtë program përjashtohen nga detyrimi i pagesës së shkollës.
- Të japë diplomë qyteti (të përgjithshme) përkatëse dhe/ose diplomë të shkollës nëse nxënësit mund të demonstrojnë nëpërmjet dokumentacionit dhe verifikimit të duhur se ata kanë përbushur kërkesat e duhura të Shkollave Publike Worcester.

Zgjedhja E Shkollës

Shkollat Publike të Worcesterit bëjnë pjesë në programin e Zgjedhjes së Shkollës së Massachusetts. Programi i zgjedhjes së shkollës lejon prindërit të dërgojnë fëmijët e tyre në shkollat e komuniteteve përveç qytetit dhe qytezës në të cilët ata banojnë. Rregjistrimi në programin e Zgjedhjes së shkollës bazohet në disponueshmërinë e hapësirës dhe në aprovimin vjetor të Komitetit të Shkollës. Prindi/kujdestari është përgjegjës për transportin në shkollën e distriktit.

Për të marrë informacion në lidhje me programin e Zgjedhjes së Shkollës, ju lutemi kontaktoni Qendrën e Informimit të Prindërve (508) 799-3194 ose Zyrën e Quadrantit (508) 799-3499.

RREGULLAT LIGJORE

Procesi i Caktuar

Kodi i Sjelljes i Shkollave Publike të Worcesterit administrohet brenda strukturës së Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara, ligjeve të shtetit dhe federalit, dhe rregullave të lidhura me porcesin e caktuar për nxënësit. Kodi i Sjelljes ka për qëllim të administrohet për thyerje disipline që ndodhin në teritorin e shkollës ose në aktivitetet e sponsorizuara nga shkolla (në dhe jashtë teritorit të shkollës) OSE për thyerje disipline që ndodhin jashtë teritorit të shkollës por që thelbësisht prishin ambientin edukativ dhe krijojnë një mjedis armiqësor në shkollë.

Shkollat Publike të Worcesterit i përmbahen Ligjeve dhe Rregulloreve Disiplinore të Nxënësve të përcaktuara në Ligjin e Përgjithshëm të Massachusetts Kapitulli 37H, 37 H1/2 dhe 37 H ¾ dhe 603 CMR 53.00

Pjesa I

PROCEDURAT E PROCESIT TE CAKTUAR PER PEZULLIM BRENDA SHKOLLES

Një nxënës mund të zhvendoset nga aktivitetet e klasës së rregullt, por jo nga ambientet e shkollës, për deri në dhjetë (10) ditë ditë rresht ose deri në dhjetë (10) shkollore kumulative për shkelje të shumta gjatë vitit shkollor. Nxënësit të cilët janë pezulluar brenda mjedisit të shkollës do të kenë mundësinë të fitojnë kredite, të kryejnë detyra, teste, projekte, dhe të tjera detyra shkolle të nevojshme për përparim akademik gjatë pezullimit brenda shkollës.

Një nxënës i cili nuk është në gjëndje që vazhdimisht tu përmbahet standarteve të pranueshme të një klase të veçantë mund të zhvendoset nga klasa përgjithmonë dhe të caktohet në një klasë tjetër sipas diskrecionit të drejtorit dhe/ose mëkëmbisit të tij/saj.

Njoftim për Pezullim brenda Shkollës:

Drejtori ose mëkëmbisi i tij/saj duhet të informojë nxënësin e akuzuar për shkeljen disiplinore dhe bazën e akuzës, dhe ti sigurojë nxënësit mundësinë të kundërshtojë akuzat dhe të spjegojë rrethanat që rrethojnë incidentin e pretenduar. Nëse drejtori ose mëkëmbisi i tij/saj

përcaktojnë që nxënësi ka kryer një shkelje disiplinore, drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj do të informojë nxënësin për periudhën e zgjatjes të pezullimit brenda shkollës, i cili nuk duhet të kalojë dhjetë (10) ditët, kumulative ose të vazhdueshme, në një vit shkollor.

Në të njëjtën ditë që vendoste pezullimi brenda shkollës, drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj duhet të bëjë përpjekje të arësyeshme të njoftojë prindin/kujdestarin gojarisht për shkeljen disiplinore, arësyet që konkluduan që nxënësi kreu shkeljen, dhe periudhën e zgjatjes së pezullimit brenda shkollës.

Në ditën e pezullimit, drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj duhet të dërgojë një njoftim me shkrim (dorazi, me postë të certifikuar, me postë ose postë elektronike të klasit të parë) tek nxënësi dhe prindi/kujdestari duke përfshirë arësytet dhe kohëzgjatjen e pezullimit brenda shkollës, dhe duke ftuar prindin/kujdestarin në një takim nëse takimi tashmë nuk ka ndodhur. Njoftimi duhet të jetë në Anglisht dhe në gjuhën primare të familjes nëse një gjuhë tjetër është identifikuar në anketën e gjuhës familjare, ose me fjalë të tjera, ashtu si është e nevojshme.

Takimi me Prindin/Kujdestarin:

Drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj duhet të ftojë prindin/kujdestarin në një takim ku do të diskutojë ecurinë akademike të nxënësit dhe sjelljen e tij, strategjitë për angazhimin e nxënësit, dhe përgjigjet e mundshme mbi sjelljen. Takime të tilla duhet të planifikohen në ditën e pezullimit, po të jetë e mundur dhe nëse jo, menjëherë pas tij. Nëse drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj nuk është në gjendje të kontaktojë prindin/kujdestarin pasi ka dokumentuar dhe bërë të paktën (dy) përpjekje, përpjekje të cilat do të shërbejnë për qëllimin e informimit gojarisht të prindit/kujdestarit për pezullimin brenda shkollës.

Heqja e së Drejtës për Apelim

Vendimi i Drejtorit ose i mëkëmbësit të tij/saj është vendimi i fundit për pezullimet brenda shkollës të cilët nuk tejkalojnë dhjetë (10) ditë, kumulative ose të vazhdueshme përgjatë vitit shkollor.

Pjesa II

PROCEDURAT E PROCESIT TE CAKTUAR MBI PEZULLIMET JASHTË SHKOLLES PER SHKELJET NEN MGL c. 37H ¾:

Procedurat e Procesit të Caktuar për Pezullimet Jashtë Shkollës:

Eksistojnë dy tipe të Pezullimit jashtë shkollës, Pezullime Afat-shkurtër dhe Pezullime Afatgjatë. Drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj duhet të përcaktojë shtrirjen e të drejtave për ti dhënë nxënësit një seancë dëgjimore disiplinore të bazuar në pasojat e parashikuara për shkeljen disiplinore. Nëse pasoja mund të jetë pezullim afatgjatë nga shkolla, drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj duhet ti japë nxënësit të drejta shtesë ashtu siç përshkruhen më poshtë, përveç atyre të drejtave të dhëna një nxënësi i cili mund të ballafaqohet me një pezullim afatshkurtër nga shkolla. Të gjithë nxënësit që ballafaqohen me një pezullim jashtë shkollës duhet të kenë të drejtën e një njoftimi me gojë dhe me shkrim, ashtu siç përshkruhet më poshtë.

Njoftim për Cdo Pezullim Jashtë Shkollë:

Para pezullimit të nxënësit, Drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj do të pajisë nxënësin dhe Prindin/Kujdestarin me njoftim me gojë dhe shkrim mbi pezullimin e mundshëm, me një mundësi për nxënësin për të patur një seancë dëgjimore dhe me një mundësi për Prindin/Kujdestarin (ët) të marrë pjesë në seancë. Njoftimi do të jetë në gjuhën Angleze dhe në gjuhën primare të familjes nëse është e ndryshme nga Anglishtja ashtu siç është identifikuar në anketën e gjuhës familjare, ose me të tjera mjete komunikimi ku është e nevojshme. Njoftimi do të jetë i shkruar në gjuhë të thjeshtë:

- (a) shkelja disiplinore
- (b) baza e akuzës
- (c) pasojat potenciale, ku përfshihet periudha potenciale e pezullimit të nxënësit;
- (d) mundësia për nxënësin për të patur një seancë dëgjimore me drejtorin ose mëkëmbësin e tij/saj në lidhje me pezullimin e propozuar, ku përfshihet mundësia për të kundërshtuar akuzat dhe për të paraqitur spjegimin e nxënësit rreth incidentit të pretenduar, dhe për prindin që të marrë pjesë në seancë;
- (e) data, koha, dhe vendi i seancës;
- (f) e drejta e nxënësit dhe e prindit/kujdestarit të nxënësit për shërbime interprete në seancën dëgjimore nëse nevojitet të marrë pjesë;
- (g) nëse një nxënës mund të vendoset në pezullim afatgjatë pas seancës dëgjimore me drejtorin:
 1. të drejtat e paraqitura në 603 CMR 53.08 (3) (b); dhe
 2. të drejtën për të apeluar vendimin e drejtorit dhe të kryeinspektorit.

Drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj duhet të bëjë përpjekje të arësyeshme që të njoftojë prindin/kujdestarin gojarisht për mundësinë e paraqitjes në seancën dëgjimore. Para kryerjes së një seance pa qënë i pranishëm prindi/kujdestari, drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj do të dokumentojë përpjekjet e tij ku përfshihet prindi/kujdestari. Drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj supozohet të ketë bërë përpjekje të arësyeshme nëse drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj ka dërguar njoftim me shkrim dhe ka dokumentuar të paktën dy (2) herë përpjekjet për të kontaktuar prindin/kujdestarin në mënyrën e përcaktuar nga prindi/kujdesatri për njoftimet emergjente.

Njoftimi me shkrim drejtuar prindit/kujdestarit mund të bëhet dorazi, me postë të klasit të parë, postë të certifikuar, postë elektronike tek një adresë e dhënë nga prindi/kujdestari për komunikim me shkollën, ose me anë të çdo metode tjetër me të cilën drejtori dhe prindi/kujdestari kanë rënë dakord.

Largimi Emergjent i Nxënësit

Nën disa rrethana emergjente, nuk mund të jetë praktike për drejtorin ose mëkëmbësin e tij/saj të japë njoftim paraprak me gojë dhe shkrim para largimit të nxënësit nga shkolla. Drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj mund të largojë një nxënës nga shkolla përkohësisht kur një nxënës akuzohet me një shkelje disiplinore dhe prezenca e vazhdueshme e nxënësit paraqet rrezik për njerëzit dhe pronat, ose materialisht dhe thelbësisht prish rendin e shkollës, dhe, në gjykimin e drejtorit (ose mëkëmbësit të tij/saj) nuk ka asnjë alternativë në dispozicion që të lehtësojë rrezikun ose përçarjen. Drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj do të njoftojë me shkrim

menjëherë kryeinspektorin për largimin dhe arësytën për të, dhe të përshkruajë rrezikun e paraqitur nga nxënësi. Largimi i përkohshëm nuk do të tejkalohet më shumë se dy (2) ditë shkollë pas ditës së largimit emergjent, gjatë kësaj kohe drejtori do të:

- (a) Bëjë përpjekje imediate dhe të arësytshme që të njoftojë gojarisht nxënësin dhe prindin/kujdestarin për largimin emergjent, arësytën për nevojën e largimit emergjent, shkeljen disiplinore, bazën e akuzës, pasojat potenciale, ku përfshihet periudha potenciale e pezullimit, mundësia për një seancë dëgjimore ku përfshihet data/koha/vëndi i seancës, e drejta për shërbime interprete, dhe të tjera të drejta të lejuara për nxënësit të cilët mund të vendosen në pezullim afatgjatë ashtu si shkruhet në 603 CMR. 53.08(3)(b);
- (b) Jepë njoftim me shkrim nxënësit dhe prindit/kujdestarit, ku përfshihet informacioni i përshkruar në 603 CMR 53.06(2);
- (c) Jepë nxënësit një mundësi për një seancë dëgjimore me drejtorin ose mëkëmbësin e tij/saj e cila përputhet me 603 CMR 53.08(2) ose 53.08(3), sipas rastit, dhe ti japë prindit/kujdestarit një mundësi të marrë pjesë në seancë dëgjimore, para skadimit të dy (2) ditëve të shkollës, përveç rasteve kur drejtori, nxënësi, dhe prindi/kujdestari kanë rënë dakord për një zgjatje të kohës për seancën dëgjimore.
- (d) Marrë vendim gojarisht në ditën e seancës dëgjimore, dhe me shkrim jo më vonë se dita shkollë e mëpasshme, që plotëson kushtet e 603 CMR 53.08(2)(c) dhe 53.08(2)(d) ose 603 CMR 53.08(3)(c) dhe 53.08(3)(d), sipas rastit.

Një drejtor nuk mund ta largojë në nxënësi nga shkolla në rast emergjence për një shkelje disiplinore derisa të jenë ndërmarrë dispozita adekuate për nxënësin për sigurinë dhe transportin e tij.

PROCEDURAT PËR PEZULLIM AFATSHKURTER NEN MGL c. 37H ¼:

Një Pezullim Afatshkurtër është largimi i nxënësit nga mjediset e shkollës dhe nga aktivitetet e rregullta të shkollës për dhjetë (10) ditë rresht ose më pak. Çdo nxënësi që përballet me një pezullim potencial afatshkurtër ka të drejtën e një seance dëgjimore me drejtorin ose me mëkëmbësin e tij/saj sipas procesit të mëposhtëm:

Seanca Dëgjimore me Drejtorin- Pezullimi Afatshkurtër:

- (a) Qëllimi i seancës dëgjimore me drejtorin ose me mëkëmbësin e tij/saj është të dëgjojë dhe të marrë parasysh informacionin në lidhje me incidentin e pretenduar për të cilin nxënësi mund të pezullohet, ti japë nxënësit mundësinë të kundërshtojë akuzat dhe të spjegojë rrethanat në të cilat ndodhi incidenti i pretenduar, të përcaktojë nëse nxënësi ka kryer shkeljen disiplinore, dhe nëse është ashtu, të përcaktojë pasojat për shkeljen. Si minimum, drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj do të diskutojë shkeljen disiplinore, bazën e akuzës, dhe çdo informatë tjetër përkatëse. Nxënësi gjithashtu duhet të ketë mundësinë të paraqesë informata, duke përfshirë këtu fakte lehtësuese të cilët drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj ti marrë në konsideratë për të përcaktuar nëse mjete të tjera juridike dhe pasoja të tjera mund të jenë të përshtatshme si alternativë për pezullimin. Drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj duhet ti japë prindit/kujdestarit, nëse i pranishëm, një mundësi të diskutojë sjelljen dhe ti

ofrojë informacion, ku përfshihen rrethanat lehtësuese, të cilat drejtori duhet ti marrë në konsideratë në përcaktimin e pasojave për nxënësin.

- (b) Duke u bazuar në informatat në dispozicion, përfshirë rrethanat lehtësuese, drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj duhet të vendosë nëse nxënësi ka kryer shkeljen disiplinore, dhe, nëse po, çfarë mjete juridik ose pasojë do të vendoset.
- (c) Drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj duhet të njoftojë nxënësin dhe prindin/kujdestarin për caktimin e masës dhe arësyen për të, dhe nëse nxënësi pezullohet, llojin dhe periudhën e zgjatjes së pezullimit dhe mundësinë për të bërë detyrat dhe të tjera detyra të shkollës të nevojshme këto për përparimin akademik gjatë kohës së largimit, siç parashikohet në 603 CMR 53.13(1). Vendimi duhet të jetë me shkrim dhe mund të përdoret si formë e rinovuar e njoftimit me shkrim origjinal.
- (d) Nëse nxënësi ndjek një program parashkollor publik ose nga kopshti deri në klasën e 3-të, drejtori duhet të dërgojë një kopje me shkrim të vendimit krueinspektorit dhe të spjegojë arësyet për imponimin e një pezullimi jashtë shkollës, para se pezullimi afatshkurtër të hyjë në fuqi.

Heqja e së drejtës për Apelim:

Vendimi i Drejtorit ose mëkëmbësit të tij/saj është vendimi përfundimtar për pezullimet afatshkurtra jashtë shkolle që nuk tejkalojnë më shumë se dhjetë (10) ditë rresht ose ditë kumulative përgjatë vitit shkollor.

PROCEDURAT PER PEZULLIMIN AFATGJATE NEN MGL c. 37H ¾:

Një Pezullim Afatgjatë është largimi i nxënësit nga mjediset e shkollës dhe nga aktivitetet e rregullta të klasës për më shumë se dhjetë (10) ditë shkolle rresht, ose për më shumë se dhjetë (10) ditë shkolle kumulative për shumë shkelje disiplinore në çdo vit shkollor. Përveç nxënësve që janë akuzuar për shkelje disiplinore në përputhje me Ligjin e Përgjithshëm të Massachusetts Kapitulli 71, §37 H, ose Ligjin e Përgjithshëm të Massachusetts Kapitulli 71 § 37H ½, asnjë nxënës nuk mund të vendoset në pezullim afatgjatë për një ose më shumë shkelje disiplinore për më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë shkolle brenda një viti shkollor duke filluar largimin e nxënësit nga shkolla që në ditën e parë. Asnjë pezullim afatgjatë nuk mund shtrihet përtej fundit të vitit shkollor në të cilin pezullimi është vendosur. Çdo nxënës që përballet me pezullim afatgjatë ka të drejtën e një seance dëgjimore me Drejtorin ose me mëkëmbësin e tij/saj sipas procesit të mëposhtëm:

Seanca Dëgjimore me Drejtorin-Pezullimi Afatgjatë:

- (a) Qëllimi i seancës dëgjimore me drejtorin ose mëkëmbësin e tij/saj është të dëgjojë dhe të marrë në konsideratë informata në lidhje me incidentin për të cilin nxënësi mund të pezullohet, ti japë nxënësit një mundësi të kundërshtojë akuzat dhe të spjegojë rrethanat në të cilat ndodhi incidenti i pretenduar, të përcaktojë nëse nxënësi ka kryer shkelje disiplinore, po të jetë kështu, pasojat për shkeljen. Si minimum, drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj do të diskutojë shkeljet disiplinore, bazën e akuzës, dhe çdo informatë tjetër përkatëse. Nxënësi gjithashtu duhet të ketë mundësinë të paraqesë informata, duke përfshirë këtu fakte lehtësuese të cilët drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj ti marrë në konsideratë për të përcaktuar nëse mjete

të tjera juridike dhe pasoja të tjera mund të jenë të përshtatshme si alternativë për pezullimin. Drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj duhet ti japë prindit/kujdestarit, nëse i pranishëm, një mundësi të diskutojë sjelljen dhe ti ofrojë informacion, ku përfshihen rrethanat lehtësuese, të cilat drejtori duhet ti marrë në konsideratë në përcaktimin e pasojave për nxënësin.

- (b) Përveç të drejtave që i jepen nxënësit në një seancë dëgjimore për pezullim afatshkurtër, nxënësi do të ketë dhe të drejta shtesë si më poshtë:
1. para seancës dëgjimore, drejtori do të ketë mundësinë të rishikojë rekordet dhe dokumentacionin e nxënësit mbi të cilat ai do të mbështetet për të marrë ose jo vendimin e pezullimit të nxënësit;
 2. të drejtën të përfaqësohet nga një avokat ose person ligjor që zgjidhet nga nxënësi, dhe që mbulohet me shpenzimet e prindit/kujdestarit të nxënësit.
 3. të drejtën të ketë dëshmitarë në emër të tij ose të saj dhe të paraqesë spejgimn e nxënësit mbi shkeljen e pretenduar, por nxënësi nuk duhet të detyrohet ta bëjë këtë.
 4. të drejtën për të marrë në pyetje dëshmitarët të paraqitur nga distrikti i shkollës.;
 5. të drejtën të kërkojë që seanca dëgjimore të regjistrohet nga drejtori, dhe të marrë një kopje të audio-inçizim sipas kërkesës. Nëse nxënësi ose prindi/kujdestari kërkojnë një audio-inçizim, drejtori duhet të informojë të gjithë pjesëmarrësit para seancës dëgjimore që një audio-inçizim do të kryhet dhe një kopje do ti jepet nxënësit dhe prindit/kujdestarit sipas kërkesës.
- (c) Drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj do ti japë prindit/kujdestarit, nëse të pranishëm, një mundësi të diskutojë sjelljen e nxënësit dhe të ofrojë informata që përfshijnë rrethana lehtësuese, që drejtori duhet ti marrë në konsideratë për të përcaktuar pasojat për nxënësin.
- (d) Bazuar në evidencën, drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj do të përcaktojë nëse nxënësi ka kryer shkeljen disiplinore, dhe, nëse është kështu, pasi ka marrë në konsideratë rrethanat lehtësuese dhe alternativat e pezullimit, çfarë mjete lehtësuese ose pasoja do të vendosen, në vënd të ose përveç pezullimit afatgjatë. Drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj do t'i dërgojë vendimin me shkrim nxënësit dhe prindit/kujdestarit dorazi, me postë të certifikuar, postë të klasit të parë, me postë elektronike në një adresë të dhënë nga prindi/kujdestari për komunikim me shkollën, ose do të dërgohet me çdo lloj metode tjetër në bazë të marrëveshjes së drejtorit dhe prindit/kujdestarit. Nëse drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj vendos të pezullojë nxënësin, vendimi me shkrim duhet:
1. të identifikojë shkeljen disiplinore, datën në të cilën seanca dëgjimore u zhvillua, dhe pjesëmarrësit në seancë;
 2. njerrë faktet dhe koluionet e ariturnga drjtori;
 3. Të identfkojë kohëzgjatjen dhe datën efikase të pezullimit, ashtu si dhe kthimin në shkollë;
 4. Të përfshijë njoftimin e dhënies së mundësisë së nxënësit për të marrë shërbime edukative dhe të bëjë përparim akademik gjatë periudhës së largimit nga shkolla;

5. Të informojë nxënësin për të drejtën e apelimit të vendimit të drejtorit tek kryeinspektori ose mëkëmbësi i tij, vetëm nëse drejtori ka dhënë një pezullim afatgjatë. Njoftimi i të drejtës së apelit duhet të jetë në Anglisht dhe në gjuhën primare të familjes nëse është e ndryshme nga Anglishtja ashtu siç është e përcaktuar në anketën e gjuhës së familjes, ose me mënyra të tjera komunikimi ku është e përshtatshme, dhe duhet të përfshijë informacionin e deklaruar në një gjuhë të thjeshtë:
 - a. Procesi i apelimit të vendimit, duke përfshirë këtu që nxënësi ose prindi/kujdestari do të paraqesë një ankesë me shkrim tek kryeinspektori brenda pesë (5) ditëve kalendarikenga data efikase e pezullimit afatgjatë; me kusht që brenda pesë (5) ditëve kalendarike, nxënësi ose prindi/kujdestari mund të kërkojë dhe të marrë nga kryeinspektori një kohë shtesë për të plotësuar njoftimin me shkrim deri në shtatë (7) ditë kalendarike shtesë; dhe pezullimi afatgjatë do të ngelet në fuqi derisa kryeinspektori të vendosë ta përmbysë vendimin e drejtorit në apelim.
 - b. Nëse nxënësi ndjek një program parashkollor publik ose nga kopshti deri në klasën e 3-të, drejtori duhet të dërgojë një kopje me shkrim të vendimit krueinspektorit dhe të spjegojë arësyet për imponimin e një pezullimi jashtë shkollës, para se pezullimi afatshkurtër të hyjë në fuqi.

Seanca Dëgjimore e Kryeinspektorit:

- (1) Një nxënës të cilit i është dhënë një pezullim afatgjatë pas seancës dëgjimore me drejtorin duhet të ketë të drejtën të apalojë vendimin e drejtorit tek kryeinspektori ose mëkëmbësi i tij/saj.
- (2) Nxënësi ose prindi/kujdestari duhet të plotësojë një njoftim ankese drejtuar kryeinspektorit brenda pesë (5) ditëve kalendarike që nga dita efikase e pezullimit; me kusht që brenda pesë (5) ditëve kalendarike, nxënësi ose prindi/kujdestari të kërkojë dhe marrë nga kryeinspektori një zgjatje të kohës për të plotësuar njoftimin me shkrim deri në shtatë (7) ditë kalendarike shtesë. Nëse ankesa nuk plotësohet në kohë, kryeinspektori mund ta refuzojë atë, ose mund ta lejojë ankesën dhe ka liri veprimi, por për cauzë të mirë.
- (3) Kryeinspektori se mëkëmbësi i tij/saj duhet të mbajë seancën dëgjimore brenda tre (3) ditëve shkollore nga kërkesa e nxënësit, nëse nxënësi ose prindi/kujdestari kërkojnë një zgjatje kohe deri në shtatë (7) ditë kalendarike shtesë, në secilin rast kryeinspektori do të lejojë kohëzgjatjen.
- (4) Kryeinspektori duhet të bëjë një përpjekje me mirëbesim që të përfshijë dhe prindin në seancën dëgjimore. Kryeinspektori supozohet të ketë bërë një përpjekje mirëbesuese nëse ai ose ajo është përpjekur të gjejë ditën dhe kohën për seancën dëgjimore që mund të lejojë prindin/kujdestarin dhe kryeinspektorin të marrë pjesë. Kryeinspektori duhet të dërgojë njoftim me shkrim prindit/kujdestarit për ditën, kohën, dhe vendin e seancës dëgjimore.
- (5) Kryeinspektori duhet të zhvillojë një seancë dëgjimore që të përcaktojë nëse nxënësi ka kryer shkelje disiplinore për të cilën ai akuzohet dhe nëse është kështu, çfarë do të jetë pasoja. Kryeinspektori duhet të organizojë një audio regjistrim të seancës

dëgjimore, një kopje të të cilit duhet t'ja shpërndajë nxënësit ose prindit/kujdestarit sipas kërkesës. Kryeinspektori duhet të informojë të gjithë pjesëmarrësit para seancës dëgjimore që një audio regjistrim i seancës do të kryhet dhe një kopje e seancës do ti shpërndahet nxënësit dhe prindit/kujdestarit sipas kërkesës.

- (6) Nxënësi duhet të ketë të gjitha të drejtat që i janë dhënë nxënësit në seancën dëgjimore të drejtorit për pezullim afatgjatë.
- (7) Kryeinspektori duhet të lëshojë një vendim me shkrim brenda pesë (5) ditëve kalendarike nga dita e seancës dëgjimore që plotëson kushtet e 603 CMR 53.03(3)(c)nga 1 deri tek 5. Nëse kryeinspektori përcakton që nxënësi ka kryer një shkelje disiplinore, kryeinspektori mund të imponojë të njëjtat pasoja ose më të vogla nga ato të drejtorit, por nuk duhet të impnojë një pezullim më të madh se ai i dhënë nga vendimi i drejtorit.
- (8) Vendimi i kryeinspektorit duhet të jetë vendimi përfundimtar i distriktit të shkollës, në lidhje me pezullimin.

Një konferencë midis prindit/kujdestarit (takim fillestar) dhe Drejtorit ose mëkëmbësit të tij/saj inkurajohet fuqimisht para se nxënësit që janë të pezulluar të kthehen në shkollë. Kjo konferencë do të përdoret për të promovuar angazhimin e prindit/kujdestarit ose kujdestarëve në diskutimin e sjelljes së keqe të nxënësit dhe për të përkrahur nxënësin në ri-angazhimin e tij me komunitetin e shkollës.

Pjesa III

PEZULLIMI /DEBIMI AFATGJATE PER RRETHANA TE POSACME NEN MGL c. 37H:

Pezullimi afatgjatë ose dëbimi i nxënësit nga shkolla do të bëhet në përputhje me Ligjet e Përgjithshme të Massachusetts, Kapitulli 71, Seksioni, 37H. Bazat për pezullim afatgjatë ose dëbim përfshijnë por nuk kufizohen në ato që përmenden më poshtë:

- I. Çdo nxënësi që gjendet në mjediset e shkollës ose në aktivitetet e sponsorizuara dhe të organizuara nga shkolla, duke përfshirë lojërat atletike, që posedon një armë të rrezikshme, ku përfshihet, por nuk kufizohet në, armë, thikë, ose faksimilet e tyre, ose çdo gjë e përdorur për kryerjen e një sulmi; ose një substancë e kontrolluar ashtu siç përcaktohet në Kapitullin 94 C, duke përfshirë, por jo që kufizohet në, marihuanë, kokainë, dhe heroinë, mund të jetë subjekt i pezullimit afatgjatë ose dëbimit nga shkolla nga drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj.
- II. Çdo nxënësi që sulmon drejtorin, nën-drejtorin, mësuesin, ndihmës-mësuesin, ose këdo tjetër nga personeli arsimor në mjedisin e shkollës ose në aktivitetet e sponsorizuara dhe të organizuara nga shkolla, duke përfshirë lojërat atletike, mund të bëhet subjekt i një pezullimi afatgjatë ose i një dëbimi nga shkolla ose nga distrikti i shkollës nga drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj.
- III. Procesi i caktuar për një nxënësi që është subjekt i një dëbimi ose i një pezullimi afatgjatë si rezultat i posedimit të drogave/armëve ose sulmit kundrejt personelit të shkollës përfshin:

- (a) Një nxënës duhet të marrë njoftim me shkrim para se dëbimi ose pezullimi afatgjatë të kryhet dhe njoftim me shkrim për të drejtën e apelimit.
- (b) Nxënësit duhet ti jepet mundësia për një seancë dëgjimore dhe mundësia për të paraqitur dëshmitarë dhe evidencë. Nxënësi duhet të ketë një avokat dhe do të mbulojë shpenzimet e veta.
- (c) Menjëherë pas seancës dëgjimore, drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj mund të veprojë i lirë dhe të vendosë ta pezullojë nxënësin në vend që ta përjashtojë.
- (d) Nxënësi mund të apelojë dëbimin ose pezullimin afatgjatë tek kryeinspektori me kusht që apelimi të jetë kërkuar me shkrim, brenda dhjetë (10) ditëve kalendarike menjëherë pas dhënies së pezullimit afatgjatë ose dëbimit.
- (e) Në seancën dëgjimore të apelimit nxënësi mund të përfaqësohet nga një avokat dhe mund të paraqesë dëshmi me gojë dhe shkrim.
- (f) Përmbajtja e apelimit nuk duhet të kufizohet vetëm në një përcaktim faktesh nëse nxënësi ka shkelur ndonjë dispozitë të MGL c. 71 Seksioni 37H.
- (g) Vendimi i Kryeinspektroit është përfundimtar.
- (h) Çdo nxënësi i cili pezullohet ose përjashtohet për më shumë se dhjetë (10) ditë rresht duhet ti jepet mundësia të marrë shërbime edukative dhe të bëjë përparim akademik drejt arritjes së kërkesave shtetërore dhe lokale, nëpërmjet planit të gjërë të shërbimit arsimor shkollor.

PROCEDURAT PER NXENESIT ME ANKESE KRMINALE OSE DENIME NEN MGL c. 37H ½ :

Në përputhje Kapatullin 71 (§37 H ½) të Ligjeve të Përgjithshme të Massachusetts-it, drejtorët kanë të drejtën t'i pezullojnë nxënësit e akuzuar për krime dhe t'i përjashtojnë ose t'u japin pezullim afatgjatë nxënësve të dënuar apo të gjykuar për shkak se kanë kryer një krim nëse drejtori ka përcaktuar se prezenca e vazhdueshme e nxënësit do të ketë një ndikim të ndjeshëm të dëmshëm mbi mbarëvajtjen e shkollës.

Procesi i caktuar për një nxënës i cili është subjekt i pezullimit për shkak të akuzave për kryerje krimi përfshin:

- a. Nxënësi merr njoftim me shkrim para se pezullimi të hyjë në fuqi dhe një njoftim me shkrim për të drejtën e apelimit.
- b. Nxënësit mund t'i jepet mundësia të përgjigjet akuzave para se pezullimi të hyjë në fuqi.
- c. Nxënësi mund të apelojë pezullimin tek Kryeinspektori, me kusht që apelimi të jetë kërkuar me shkrim brenda pesë (5) ditëve kalendarike menjëherë pas pezullimit.
- d. Kryeinspektori duhet të mbajë seancën dëgjimore të apelimit brenda tre (3) ditëve nga dita e kërkesës.

- e. Në seancën dëgjimore të apelimit nxënësi mund të përfaqësohet nga një avokat. Nxënësi ka të drejtën të paraqesë dëshmi me gojë apo me shkrim për veten e tij/të saj.
- f. Kryeinspektori duhet të marrë vendim brenda pesë (5) ditëve kalendarike.
- g. Vendimi i Kryeinspektorit është përfundimtar.
- h. Çdo nxënësi i cili pezullohet ose dëbohet në përputhje me këtë seksion do ti jepet mundësia të fitojë kreditet, sipas rastit, të kryejë detyrat, testet, dhe mësimet e shkollëes sipas nevojës për të bërë përparim akademik gjatë periudhës së largimit.
- i. Çdo nxënësi i cili pezullohet ose dëbohet për më shumë se dhjetë (10) ditë rresht do ti jepet mundësia të marrë shërbime edukative dhe të bëjë përparim akademik drejt arritjes së kërkesave shtetërore dhe lokale, nëpërmjet planit të gjërë të shërbimit arsimor shkollor.

Procesi i caktuar për një nxënës i cili është subjekt i një dëbimi ose i një pezullimi afatgjatë si rezultat i dënimit për krim përfshin:

- a. Një nxënës duhet të marrë njoftim me shkrim para se dëbimi ose pezullimi afatgjatë të fillojë dhe një njoftim me shkrim për të drejtën e apelimit.
- b. Nxënësit duhet ti jepet mundësia tu përgjigjet akuzave.
- c. Nxënësi mund të apelojë dëbimin ose pezullimin afatgjatë tek Kryeinspektori me kusht që apelimi të jetë kërkuar me shkrim, brenda pesë (5) ditëve kalendarike menjëherë pas dëbimit.
- d. Kryeinspektori duhet të mbajë një seancë dëgjimore apelimi brenda tre (3) ditëve kalendarike nga dita e kërkesës.
- e. Në seancën dëgjimore të apelimit nxënësi mund të përfaqësohet nga një avokat dhe mund të paraqesë dëshmi me shkrim dhe me gojë.
- f. Kryeinspektori duhet të marrë një vendim brenda pesë (5) ditëve kalendarike.
- g. Vendimi i kryeinspektorit është përfundimtar.
- h. Çdo nxënës i cili është pezulluar ose përjashtuar për më shumë se dhjetë (10) ditë rresht do të ketë mundësinë të marrë shërbime edukative dhe të bëjë përparim akademik drejt arritjes së kërkesave shtetërore dhe lokale, nëpërmjet planit të gjërë të shërbimit arsimor shkollor.

Pjesa IV

SHERBIMET ARSIMORE DHE PERPARIME AKADEMIKE SIPAS SEKSIONIT MGL 37H, 37H1/2 DHE 37H3/4:

Çdo nxënës të cilit i jepet një pezullim brenda shkollës, pezullim afatshkurtër, pezullim afatgjatë, ose dëbim duhet të ketë mundësinë të fitojë kredite, sipas rastit, të kryejë detyrat, testet, dhe mësimet e tjera të shkollës sipas nevojës dhe të bëjë përparim akademik gjatë periudhës së largimit të tij/saj nga klasa ose shkolla. Drejtori duhet të informojë nxënësin dhe prindin/kujdestarin për këtë mundësi me shkrim kur një pezullim ose dëbim i tillë i jepet.

Çdo nxënës i cili perjashtohet ose pezullohet nga shkolla për më shumë se dhjetë (10) ditë rresht, brenda shkollës apo jashtë shkollës, duhet të ketë mundësinë të marrë shërbime edukative dhe të bëjë përparim akademik drejt arritjes së kërkesave shtetërore dhe lokale, nëpërmjet planit të gjërë të shërbimit arsimor shkollor.

Mosdiskriminimi

Mundësitë e barabarta/Veprime pohuese/Titulli IX

Titulli ADA Pjesa I 504/Kapitulli 622 Procedura për Ankesat

Shkollat Publike Worcester janë nje Mundësi i Barabarte/Punedhenes i Drejte i Konfirmuar/Institucion Edukimi, dhe nuk diskriminon pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, besimi fetar, identiteti gjinor, origjina kombëtare, statusi civil, orientimi seksual, paaftësitë fizike e mendore apo statusi të pastrehut. Shkollat Publike Worcester ofrojnë barazi në punësim dhe një gamë të plotë të programeve edukative të përgjithshme, teknike e profesionale. Për më shumë informacion në lidhje me Mundësitë e barabarta/Veprimet me , kontaktoni Menaxhere e Burimeve Njerëzore, 20 Irving Street, Worcester, MA 01609 (508) 799-3020.

Shkollat Publike Worcester premtojnë të inkurajojnë barazi dhe të nxisin zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të cilat mund të vijnë nga çdo punonjësi apo aplikant për një ankesë diskriminimi bazuar tek raca, ngjyra, gjinia, moshë, besimi fetar, identiteti gjinor, origjina kombëtare, gjendja civile, orientimi seksual, paaftësia fizike e mendore, dosja penale, statusi ushtarak aktiv, trashëgimia/gjenetika, përkatësia prindërore apo statusi i të pastrehë, nëse ankesa është e justifikueshme.

Procedimi do të mbahet i fshehtë në secilin nivel të kësaj procedure. Asnjë dokument që ka të bëjë me ankesat nuk do të përfshihet në dosjet personale të punonjësit përveç rasteve kur punonjësi e kërkon këtë gjë me shkrim. Procedurat e ankesave ofrohen për të ndrequr diskriminimin e paligjshëm të marrjes në punë, punësimin, trajnimin, rritjes në detyrë, transferimit apo disiplinimit të çdo person

Vini re faktin se Shkollat Publike të Worcester-it, në përputhje me ligjet federale dhe ato shtetërore, ndalojnë diskriminimin në punën e saj. Kjo politikë, ofron punësim dhe mundësi edukimi të barabarta për të gjithë personat pavarësisht racës, ngjyrës, gjinisë, moshës, besimit fetar, identitetit gjinor, origjinës kombëtare, statusit civil, orientimit seksual, paaftësisë fizike apo mendore, dosjes kriminale, statusit ushtarak aktiv, gjenetikës, përkatësisë prindërore ose statusit të të pastrehit, do të zbatohet për të gjithë personat të lidhur me Shkollat Publike të Worcester-it duke përfshirë nxënësit, personelin e ardhshëm dhe aktual, kontraktorët dhe furnizuesit e mallrave apo shërbimeve.

Menaxheria i Burimeve Njerëzore me adresë 20 Irving Street, Worcester, Massachusetts 01609 e numër telefoni (508) 799-3020, është përgjegjëse për koordinimin e Titullit IX, Pjesës 504 ADA Titullit I dhe Kapitullit 622 në Shkollat Publike të Worcester-it dhe do të jetë përgjegjëse për koordinimin e procedurave të mëposhtme të ankimit:

Ankesa është një ankesë nga një nxënës, prind/kujdestar, punonjësi i ardhshëm apo anëtar i personelit që pretendon se është diskriminuar mbi baza race, ngjyre, gjinie, moshe,

besimi fetar, identiteti gjinor, origjine kombëtare, statusi civil, orientimi seksual, paaftësie fizike apo mendore, apo status të pastrehut, e cila paraqitet jo më shumë se 30 ditë pune pas veprimit të pretenduar dhe/ose deklaratës.

Pala ankuese duhet të fillojë procedimin brenda tridhjetë (30) ditësh pune nga dita e ndodhjes së ngjarjes ose ngjarjeve ose brenda tridhjetë (30) ditë pune nga data që kur pala ankuese ka qenë në dijeni ose duhet të ketë patur njohuri të arsyeshme të ngjarjet ose ngjarjeve që kanë çuar në ankesë. Katër nivelet e procesit të ankimit për ankesat përfshijnë:

Niveli I

- a) Një anëtar i personelit, nxënës apo punonjës i ardhëm që ka një problem do të paraqesë ankesën e tij/të saj tek mbikëqyrsi i tij/i saj ose tek drejtori, cilido është personi i përshtatshëm.
- b) Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë do të vendosë, dhe ky vendim do të jetë përfundimtar përveç rasteve kur pala ankuese zgjedh të apelojë në nivelin tjetër ose në Menaxherin e Sektorit, sikurse është përcaktuar në germën "c" më poshtë. Vendimi do të merret brenda pesë (5) ditësh pune pas marrjes së ankesës zyrtare nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.
- c) Në rastet kur nuk është marrë një vendim brenda pesë (5) ditëve të punës pas paraqitjes së ankesës, pala ankuese mund ta ulë ankesën me shkrim dhe ta paraqesë brenda dhjetë (10) ditësh pune tek Menaxheri i Sektorit.
- d) Ky nivel është një nivel i alternuar dhe ankesa lejohen me lejen e tij/të saj që të fillojë veprimin në Nivelin II.

Niveli II

- a) Nëse ankesat nuk janë zgjidhur në Nivelin I pas pesë (5) ditësh pune, ose nëse pala ankuese ushtron të drejtën e tij/të saj për të filluar ankesën në Nivelin II, ankuesit duhet ta paraqesë ankesën me shkrim dhe t'ia dërgojë Menaxherit të Burimeve Njerëzore.
- b) Menaxheri i Burimeve Njerëzore do të takohet me palët përkatëse që të përpiqet të zgjidhë ankesën. Vendimi do të merret brenda pesë (5) ditësh pune pas marrjes së ankesës zyrtare nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore.
- c) Në rastet kur nuk është marrë një vendim brenda pesë (5) ditëve të punës pas paraqitjes së ankesës, pala ankuese mund ta ulë ankesën me shkrim dhe ta paraqesë brenda dhjetë (10) ditësh pune tek Kryeinspektori.

Niveli III

- a) Kryeinspektori, ose mëkëmbësi i tij/i saj, do të takohen brenda pesë (5) ditësh pune pas ankesës me personin që është ankuar dhe do të përpiqen që ta zgjidhin ankesën.
- b) Ankesës do t'i përgjigjet me shkrim. Nëse pala ankuese mendon se ankesa nuk është zgjidhur në mënyrë të kënaqshme në Nivelin III, ose në rastet kur nuk i është dhënë një përgjigje me shkrim brenda dhjetë (10) ditësh pune pas takimit me ankuesin, personi ankues mund ta dërgojë ankesën me një kopje të përgjigjes, nëse ka një të tillë, tek Sekretari i Komitetit të Shkollës brenda dhjetë (10) ditësh pune.

Niveli IV

- a) Komiteti i Shkollës do të mbajë një seancë dëgjimore mbi problemin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pune. Seanca dëgjimore e përmendur më lartë duhet të hapet vetëm me miratimin e dyanëshëm të palëve.
- b) Komiteti i Shkollës do t'i japë ankuesit vendimin me shkrim dhe arsyet për të brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pune nga data e seancës në fjalë.

Heqja dorë

Nëse akuzuesi nuk pajtohet me ndonjë nga dispozitat e ankimit të përmendur, procedura do të konsiderohet si e hequr dore në zbatim të kushteve të kësaj politike. Nëse Zyrtari i Mundësive të Barabarta/Vepimeve të pohuese, Drejtori, Shefi, Mbikëqyrësi, etj., nuk pajtohen me afatet kohore të përcaktuara në këtë procedurë do të bëjë që ankesa në mënyrë automatike të apelohe në Nivelin tjetër të procedurës së ankesës. Megjithatë kufiri kohor i specifikuar në procedurën e ankimit, mundet të zgjatet në çdo rast specifik me anë të nje marrëveshje të përbashkët me shkrim të palëve.

SHËNIM: Individëve që ankohen nuk ju kërkohet të përdorin dhe/ose të zbatojnë të gjitha procedurat e ankimit të Shkollave Publike të Worcester-it. Ankesat me shkrim, të firmosura nga ankuesi ose nga një përfaqësues i autorizuar, mund të paraqiten brenda 300 ditëve si më poshtë:

Komisioni për Mundësi të Barabartë Punësimi (E.E.O.C.) Zyra për zonën e Boston-it John F. Kennedy - Federal Office Building 475 Government Center Boston, MA 02203 1-800-669-4000	Komisioni i Massachusetts-it Kundra Diskriminimit (M.C.A.D.) 484 Main Street - Room 320 Boston, MA 02108 617-994-6000 Zyra në Worcester 484 Main Street Worcester, MA 01608 (508) 453-9630
--	--

Agjencitë e tjera përfshijnë:

Departamenti i Edukimit të Massachusetts-it 75 Pleasant Street Malden, MA 02148 781-388-3300	Departamenti i Edukimit të Shteteve të Bashkuara POCH Building 5 Post Office Square 9th Floor (kati i nëntë) - Room 24 Boston, MA 02110 617-289-0100
--	---

Veprimet Hakmarrëse

Komiteti i Shkollës, nëpërmjet Kryeinspektorit të tij, siguron që të mos ndërmerren veprime hakmarrëse ndaj atyre personave të cilët kanë paraqitur ankesë për diskriminim bazuar në racë, gjini, moshë, besimin fetar, identitetin gjinor, origjinën kombëtare, statusin

civil, orientimin seksual, paaftësinë fizike e mendore, dosjen penale, statusin aktiv ushtarak, gjenetikën, përkatësinë prindërore ose statusin e të pastrehut.

Konkluzionet e Diskriminimit

Nëse do të konstatohet se ekziston diskriminim në çdo lloj vendimi, veprimi apo praktike të punësimit brenda Shkollave Publike Worcester, do të ndërmerren të gjitha masat për të ndërprerë këtë lloj diskriminimi. Për më tepër, nëse konstatohet diskriminim i qëllimshëm nga ana e çdo punonjësi, masa të përshtatshme disiplinore deri në ndërprerjen e plotë do të merren nën drejtimin e Kryeinspektorit dhe/ose Komitetit të Shkollave.

Ruajtja e Dokumentacionit

Konfidencialiteti do të mbahet gjatë gjithë procesit investigativ derisa të arrihet në veprim. Të gjitha dokumentacionet që përfshijnë çdo ankesë të paraqitur në përputhje me Procedurat e Ankesave të Shkollave Publike Worcester, do të ruhen nga Zyrtari i Mundësive të Barabarta/Veprimeve Pohuese; dokumentacione dhe informacione të tilla do të konsiderohen të fshehta dhe do të përdoren vetëm në përputhje me procedurën e ankesave, përveç rasteve kur kërkohet ndryshe nga ligji.

Rregullat e Ngacmimeve Seksuale

Është politikë e Shkollave Publike të Worcester-it, si dhe ligj i shtetit dhe ligj federal, që ngacmimet seksuale të një nxënësi, punonjësi të ardhshëm ose aktual, apo të vizitorëve nuk do të tolerohen.

Përcaktimi

Ngacmimi seksual përcaktohet si ngacmime që nuk mirëpritin, kërkesa për favore seksuale dhe sjellje të tjera verbale apo fizike të natyrës seksuale kur:

1. Nënshtrimi ndaj një sjellje të tillë është bërë në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar si kusht apo konditë e studimit, punës apo punësimit të një individi, në Shkollat Publike të Worcester-it.
2. Nënshtrimi ndaj ose refuzimi i kushteve të tilla nga një individ përdoret si baza për vendimet mbi edukimin apo punësimin që prek një individ të tillë.
3. Një sjellje e tillë ka si qëllim ose si efekt të nderhyje kryesisht në ecurinë në arsim, apo punë të një individi me ndjeshmëri të arsyeshme.

Çfarë konsiderohet

Ngacmimi seksual nuk kufizohet me sjelljet e ndaluara nga një mashkull ndaj një femre, nga një punonjës mbikëqyrës ndaj një punonjësi jo-mbikëqyrës ose nga një mësues ndaj një nxënësi, nga një nxënës ndaj një mësuesi, ose nga një nxënës ndaj një nxënësi. Pikëpamja e Shkollave Publike të Worcester-it mbi ngacmimet seksuale përfshin, por nuk kufizohet në çka më poshtë:

- a) Një mashkull, sikurse një femër, mund të jenë viktimë të ngacmimeve seksuale dhe një femër, sikurse një mashkull mund të jenë ngacmuesit.
- b) Ngacmuesi(ja) nuk do të thotë që është viktimë e eprorit(es).
- c) Viktimë mund të jetë e seksit të njëjtë ose e seksit të kundër me ngacmuesin.
- d) Viktimë nuk do të jetë vetëm personi ndaj të /cilës janë bërë ngacmimet seksuale jo të mirëpritura. Viktimë mund të jetë edhe dikush që ndikohet nga një sjellje e tillë kur drejtohet ndaj një personi tjetër. Për shembull, përpjekjet pavarësisht për të bërë humor ose ngacmuar seksualisht një femër/mashkull mund të krijojnë mjedis frikësues, armiqësor ose ofendues për një femër/mashkull tjetër ose mund të ndërhyjnë në mënyrë të paarsyeshme me ecurinë në edukim apo në punë të individit.
- e) Ngacmimi seksual nuk varet nëse viktimë ka vuajtur një pasojë edukim apo ekonomike si rezultat i sjelljes së ngacmuesit.

Shkeljet

Shkeljet e kësaj politike dhe të ligjit, nëse provohen, do të rezultojnë në veprime disiplinore. Çdo person që beson se ai/ajo ka qenë viktimë e ngacmimeve seksuale mund të kërkojë marrjen e masave në zbatim të Procedurave të ankesave për Ngacmimet seksuale të Shkollave Publike Worcester.

Procedurat e Ankimit për Ngacmimet Seksuale

Parathënie

Një ankesë zyrtare mund të paraqitet në çdo kohë nga një nxënës, punonjës, administrator, dhe/ose aplikues(e) që beson se janë shkelur të drejtat e tij/të saja të paraqitura në politikën e ngacmimeve seksuale. Çdo nxënës, anëtar i fakultetit, administrator, apo pjesëtar i personelit e ka për detyrë që të bëjë çdo përpjekje që të zgjidhë problemet thjesht kur ato dalin. Të gjithë pjesëtarëve të komunitetit të Shkollave Publike Worcester ju kërkohet të zgjidhin problemet në mënyrë të drejtë dhe jozyrtare që të mos bëhet burime për ankesa që të ndiqen zyrtarisht nëpërmjet procedurës së ankesave. Nëse nuk mund të arrihet një zgjidhje e përshtatshme me rrugët jozyrtare me mjete të pavarura, të cilat mund të përfshijnë konsultime me Menaxherin e Burimeve Njerëzore, mund të fillohet një ankesë zyrtare.

Përcaktimet

Një "pakënaqesi" do të jetë një ankesë nga një individ, ndaj të cilit pretendohet te ketë patur shkelje të rregullores së ngacmimeve seksuale.

Hapi I (Jozyrtar)

- a) Çdo ankesë dhe të gjitha ankesat duhet të paraqiten me shkrim brenda tridhjetë (30) ditësh pune nga data kur ankuesi(ja) e ka ditur, ose duhet ta ketë ditur, ngjarjen apo ngjarjet që kanë çuar në ankesë. Personi(at) që zgjedhin të ndjekin procedurën jozyrtare të ankimit duhet të njoftojnë personelin përkatës ose anëtarët e institucionit, ose administratorin, dhe t'i paraqesin atij/asaj një përmbledhje me shkrim të ankesave dhe të përcaktojnë një kohë për tu takuar dhe diskutuar problemin.

- b) Megjithatë, për shkak të natyrës private dhe sensitive të ngacmimit seksual, ankuesi mund të zgjedhë ndërhyrjen e një pale të tretë që të ndihmojë në zgjidhjen e ankesës në baza jozyrtare. Aktivitete të tilla pajtuese do të vazhdojnë për një periudhë që nuk zgjat më shumë se njëzet (20) ditë, ose deri sa të arrihet zgjidhja, nëse kjo arrihet në më pak kohë. Nëse përpjekjet për një zgjidhje të tillë dështojnë në adresimin e këtyre çështjeve, ankuesi mund të fillojë procedurat zyrtare të ankimit në Hapin II.
- c) Ky nivel është një nivel alternativ dhe ankuesit i lejohet me dëshirën e tij/të saj të fillojë veprimin në Nivelin II.

Hapi II

- a) Nëse ankuesi beson se një rishikim i mëtejshëm i ankesës është i nevojshëm, ai/ajo brenda pesë (5) ditëve të shkollës/punës pasi të ketë marrë vendimin e Hapit I do të njoftojë palët përkatëse nëse ai/ajo dëshiron të vazhdojë me hapin tjetër. Në rastet kur ky është hapi i parë zyrtar në një akuzë të pretenduar të ngacmimeve seksuale, ankuesi(ja) duhet t'i paraqesë ankesë me shkrim Menaxherit të Burimeve Njerëzore.
- b) Pasi të ketë marrë ankesën Menaxheri i Burimeve Njerëzore, do t'ia dërgojë ankesën individit të përfshirë në ankesë, dhe mbikëqyrësit të tij/të saj.

Në ndjekje të Paragrafit b do të njoftohen individët e mëposhtëm :

1. Nëse një person i akuzuar për ngacmime seksuale është mësues(e), të njoftohet mësuesi(ja) dhe drejtori i shkollës.
 2. Nëse personi i akuzuar për ngacmime seksuale nuk është anëtar mësimdhënës i personelit, të njoftohet personi dhe mbikëqyrësi i tij/i saj i drejtpërdrejtë.
 3. Nëse personi i akuzuar për ngacmime seksuale është drejtues apo administrator, të njoftohet personi dhe mbikëqyrësi i tij/i saj i drejtpërdrejtë.
 4. Nëse personi i akuzuar për ngacmime seksuale është Kryeinspektori, të njoftohet personi dhe Kryetari i Komitetit të Shkollës.
 5. Nëse një person i akuzuar për ngacmime seksuale është nxënës(e), të njoftohet drejtuesi i shkollës së nxënësit.
 6. Në person i akuzuar për ngacmime seksuale nuk është personel i shkollës, të njoftohet personi dhe drejtuesi i shkollës dhe/ose mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i shkollës.
- c) Mbas 10 (dhjetë) ditësh që është marrë ankesa, pala ankuese (si dhe pala e akuzuar) dhe mbikëqyrësi përkatës, sikurse është shënuar më lartë, do të takohen me Menaxherin e Burimeve Njerëzore për të diskutuar ankesën.
 - d) Menaxheri i Burimeve Njerëzore do të përgjigjen me shkrim brenda pesë (5) ditësh pune/shkollë pas diskutimit.

Hapi III

- a) Nëse ankuesi beson se justifikohet një rishikim i mëtejshëm i ankesës, ai/ajo mund t'i paraqesë ankesë Kryeinspektorit brenda pesë (5) ditësh pune/shkollë nga marrja e vendimit të marrë nën Hapin II. Ankesa duhet të shoqërohet me një deklaratë të zgjidhjes që kërkohet dhe kopje të të gjitha dokumentave.

- b) Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga marrja e ankesës, Kryeinspektori do të shqyrtojë të gjitha deklaratat e mëparshme me shkrim, vendimet dhe do të organizojë një seancë dëgjimore. Personat që do të paraqiten në seancën dëgjimore në fjalë do të jene Kryeinspektori, Menaxheri i Burimeve Njerëzore, ankuesi, individi i akuzuar dhe mbikëqyrësi përkatës. Kryeinspektori mund të përfshijë persona të tjerë në procesin e dëgjimit.
- c) Në rastet kur individi i akuzuar është Kryeinspektori, personat që do të jenë prezent në seancën e dëgjimit do të jenë Komiteti i Shkollës, Menaxheri i Burimeve Njerëzore dhe ankuesi. Komiteti i Shkollës, me dëshirën e tij, mund të përfshijë persona të tjerë në seancë bazuar në kërkesën e ankuesit, Kryeinspektorit, ose pjesëmarrësve në këtë nivel.
- d) Pesëmbëdhjetë (15) ditë pas seancës dëgjimore, Kryeinspektori dhe/ose Kryetari i Komitetit të Shkollës do të japin vendimin me shkrim dhe do të marrin masat e përshtatshme.

Hapi IV

- a) Nëse ankuesi përsëri beson se një rishikim tjetër është i justifikueshëm pas Hapit III, ose në rast se nuk ka marrë përgjigje me shkrim brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pune nga seanca e dëgjimit ose nga ankesa, ai/ajo mund t'i paraqesë një peticion Komitetit të Shkollës brenda pesë ditësh pune.
- b) Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pune pas dëgjimit të peticionit në seancë, Komiteti i Shkollës do të marrë një vendim me shkrim dhe do të ndërmarë veprimet e përshtatshme.

Hapi V

- a) Komiteti i Shkollës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pune, do të mbledhë seancën. Personat që do të jenë prezent në seancën dëgjimore në fjalë do të jenë Kryeinspektori, Menaxheri i Burimeve Njerëzore, ankuesi, individi i akuzuar dhe mbikëqyrësi përkatës. Komiteti i Shkollës, me dëshirën e tij, mund të përfshijë persona të tjerë në seancë bazuar në kërkesën e ankuesit, individit të akuzuar ose pjesëmarrësve të tjerë në këtë nivel.
- b) Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pune pas seancës së dëgjimit, Komiteti i Shkollës do të marrë një vendim me shkrim dhe do të ndërmarrë veprimet e përshtatshme.

Dispozita të Ndryshme

1. Procedurat e ankimit për të gjithë punonjësit dhe nxënësit në lidhje me çdo lloj çështjeje ndjekin një proces standard, por mund të ndryshojnë për të akomoduar sensitivitetin e akuzave si dhe ankuesin ose individin, ndaj të cilit po bëhet ankimi.
2. Ankuesit nuk kufizohen vetem me nje procedure zyrtare ankimi, por mund të kërkojnë ndihmë nga agjenci të tjera, përfshi Komisionin e Mundësive të Barabarta për Punësim, Komisionin e Massachusetts-it Kundra Diskriminimit, ose Zyrën e të Drejtave Civile të Departamentit të Edukimit.
3. Çdo lloj veprimi hakmarrës që ndërmerret nga një punonjës apo student i Shkollave Publike të Worcester-it ndaj cilido punonjës apo nxënës tjetër të Shkollave Publike të Worcester-it si rezultat i kërkesës së personit për zbatim nën këto procedura,

bashkëpunim në një hetim, apo pjesëmarrje tjetër në çdo lloj procedimi nën këto procedura, është i ndaluar, dhe do të konsiderohet si një çështje tjetër e veçantë ankimi.

4. Në çdo rast kur ankimi përfshin çështje të ngacmimit seksual të çdo lloji, Menaxheri i Burimeve Njerëzore do të njoftohet me shkrim nga ankuesi, ose nga administratorët ose agjentët e Shkollave Publike të Worcester-it ndaj kujt është drejtuar ankimi.
5. Të gjitha procedimet e ankimeve, si ato zyrtare ashtu dhe ato jozyrtare, në masën më të madhe të mundur do të mbahen të fshehta nga të gjithë personat e përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë.
6. Nëse ankuesi nuk zbaton afatet e specifikuar, d.m.th që ankuesi pranon vendimin nga hapi i mëparshëm. Ai/ajo e humbet të drejtën që ta vazhdojë ankimin më tej.
7. Menaxheri i Burimeve Njerëzore do të veprojë si një burim për nxënësit dhe për Komitetin e Shkollës.

Dënimet në rastet e ngacmimeve seksuale

Veprimet korrektuese do të varen nga niveli i incidentit. Për shkak të natyrës private të incidenteve që përfshijnë ngacmime seksuale dhe kompleksitetet emocionale dhe morale që i rrethojnë këto çështje, do të bëhet çdo përpjekje për të zgjidhur problemet në baza jozyrtare. Kur ankesa zgjidhet në mënyrë jozyrtare vetëm një përmbledhje e shkurtër e incidentit do të mbahet në dosje.

Çdo pranim faj, pranim i paralajmërimit gojor, një premtim se nuk do të bëhen përsëri abuzime të tilla, dhe veprime që ndërmerren për të ofruar zgjidhje të përshtatshme mund të jetë një zgjidhje e mjaftueshme. Në fazën jozyrtare, shpresohet që personat të ndjejnë që kanë bërë faj ndaj pasojave të një sjelljeje të tillë, që të jenë konstruktivë dhe të mos ndëshkohen pa patur nevojë me veprim disiplinor. Nëse individët nuk i përmbahen zgjidhjeve jozyrtare, ose nëse nuk mund të bihet dakord për zgjidhje në fazën zyrtare, Kryeinspektori dhe/ose Komiteti i Shkollës mund ta konsiderojë të nevojshëm marrjen e masave të përshtatshme që mund të përfshijnë letra zyrtare qortimi, pezullime, ose rekomandim për shkarkim.

Toleranca

Një nga shumë pikat e forta të Shkollave Publike të Worcester-it është diversiteti i saj. Ne e festojmë këtë shumëllojshmëri me shumë ngjarje shumë-kulturore gjatë vitit shkollor. Administrata shqetësohet për incidente fatkeq të diskriminimit bazuar në moshën, racën, gjininë, ngjyrën, besimin, origjinën kombëtare, statusin civil, paafërsinë fizike e mendore dhe orientimin seksual. Ne nuk mundemi ta tolerojmë dhe nuk do ta tolerojmë një sjellje të tillë në Shkollat Publike të Worcester-it.

Ligji Kundër Dhunës së Qëllimshme Fizike e Mendore (G.L. c. 269, §§ 17-19)

Pjesa 17. Kushdo që është një organizator kryesor ose merr pjesë në krimin e dhunës fizike e mendore sikurse është përcaktuar këtu më poshtë do të dënohet me gjobë jo më shumë se tre mijë dollarë ose me dënim me burg për jo më shumë se një vit, ose me të dyja një gjobë të tillë dhe burgim.

Termi "dhunë" sikurse është përdorur në këtë pjesë dhe në pjesën tetëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë do të nënkuptojë çdo lloj sjelljeje apo metode të hyrjes në çdo lloj organizate studentore, në teritore publike apo private, e cila me dëshirë ose me pakujdesi rrezikon shëndetin fizik dhe mendor të studentëve apo personave të tjerë. Këto sjellje do të përfshijnë fshikullimin, rrahjen, vringërimin, ushtrimin fizik me detyrim, ekspozimin ndaj kohës, konsumimin me detyrim të çdo lloj ushqimi, likeri, pije, drogave apo substancave të tjera, ose çdo lloj trajtimi tjetër brutal ose aktiviteti fizik të detyruar i cili mund të ndikojë keq në shëndetin fizik dhe sigurinë e këtyre nxënësve ose personave, ose e vënë nxënësin ose personat e tjerë nën një stres mendor ekstrem, përfshi pagjumesine për periudha të gjata ose pushimin, ose izolimin e zgjatur.

Kushdo që e di se një person tjetër është viktimë e dhunës mendore e fizike sikurse është përcaktuar në pjesën shtatëmbëdhjetë dhe ndodhet në vendngjarjen e një krimi të tillë, pa rrezikuar veten apo të tjerët, duhet të raportojë një krim të tillë tek një zyrtar i zbatimit të ligjit sa më shpejt që të jetë e mundur praktikisht. Cilido që nuk e raporton një krim të tillë do të dënohet me gjobë jo më shumë se një mijë dollarë.

Pjesa 18. Kushdo që është në dijeni që një person është viktimë e dhunës së qëllimshme e përcaktuar nga pjesa 17 dhe ndodhet në vëndin ku kryhet dhuna, ky person duhet të raportojë krimin tek organet e zbatimit të ligjit sa më shpejt të jetë e mundur pa vënë në rrezik ose pa dëmtuar veten dhe të tjerët. Kushdo që dështon të raportojë këtë lloj krimi do të dënohet me gjobë jo më shumë \$1,000.00.

Pjesa 19. Çdo institucion i arsimit të mesëm, institucion publik dhe privat i edukimit të lart duhet ti japin çdo grupi studentor, studenti ose organizatë studentore e cila është pjesë e një institucioni të tillë, ose është njohur nga institucioni ose lejohet nga ai institucion te përdori emrin e tij apo objekktet e tij, ose është i njohur nga institucioni të ekzistojë si një grup studentor i panvarur, ekip ose organizate duhet të shpërndajë një kopje të kesaj pjese dhe Pjeses 17 dhe 18, megjithate duhet patur parasysh se bashkepunimi i institucionit duke dhene kopje te kerkesave qe ka kjo pjese, Pjesa 17 dhe Pjesa 18 për secilin prej anetareve të grupeve te pavaruara studentore qe nuk jane te lidhura me institucione, ekipe apo organizata nuk duhet te perdoret si evidence qe institucioni i njeh dhe i mbështet këto grupe të pavarura, ekipe apo organizata.

Këto grupe, ekipe ose organizata duhet të shpërndajne kopje to kesaj pjese dhe Pjesës 17 dhe 18 te çdo anëtar, stazhieri, të betuari apo aplikanti për anëtarësim. Do të jetë detyrë e grupit, ekipit apo organizates, duke vepruar nëpërmjet zyretareve të caktuar, për të paraqitur çdo vit per institucionin dëshmin qe grupi, ekipi apo organizton ka marrë një kopje të kësaj pjese dhe të Pjesës 17 dhe 18 që secili nga anëtarët, stazhieret, të betuarit apo aplikantët e kanë marrë nje kopje të Pjeses 17 të dhe 18 të dhe se grupi, ekipi apo organizata e kupton dhe pajtohet me kushtet e kësaj pjese dhe të pjeses 17 të dhe 18 të.

Çdo institucion i arsimit të mesëm, institucion publik dhe privat i edukimit të lartë duhet, që të paktën një herë në vit, para ose në fillim të regjistrimit, të paraqisë për çdo person

i cili regjistrohet si student me kohë të plotë në këtë institucion nje kopie të kesaj pjese dhe të Pjeses17të dhe18të.

Çdo institucion i arsimit të mesëm, institucion publik dhe privat i edukimit te lart duhet te dorezoj, të paktën nje here ne vit një raport tek drejtorja e arsimit të lartë dhe në rastin e institucioneve te mesme, tek drejtorja e edukimit, te garantoj se institucioni është në pajtueshmëri persa i perket përgjegjesise për të informuar grupet e studentëve, ekipet ose organizatat dhe të njoftojë çdo nxënës me kohë të plotë për kushtet e kësaj pjese dhe të Pjeses 17të dhe 18të dhe gjithashtu të garantojë se institucioni ka miratuar një rregullore disiplinore në lidhje me organizatorët dhe pjesmarresit e dhunes së qëllimshme fizike dhe mendore dhe se kjo rregullore është përcaktuar dhe parashtruar në mënyren e duhur në manualin studentor ose në komunikimet që bën institucioni për rregulloren e tij tek studentët. Drejtorja e arsimit të lartë dhe, në rastin e institucioneve të mesëm, drejtorja e edukimit duhet të nxjerrë rregullore për të drejtuar përmbajtjen dhe frekuencën e raporteve të tilla, dhe menjëherë t'i raportojë prokurorit të përgjithshem për institucione të tilla që nuk arrijne të bëjnë këto raporte.

Mbajtja e armëve-Ndalohet në territorin e shkollës

Ligj që ka të bëjë me mbajtjen e armëve në territorin e shkollës (G.L. c. 269, § 10)

Cilido, që nuk është një punonjës i zbatimit të ligjit dhe nuk ka asnjë liçencë të marrë nga ai/ajo sipas dispozitave të kapitullit njëqind e dyzet, dhe mbart armën e tij/të saj të zjarrit të përcaktuar këtu më poshtë të mbushur ose të pambushur ose armë të tjera të rrezikshme në çdo lloj godine ose në territorin e çdo shkolle tetëvjeçare apo të mesme, kolegji apo universiteti, pa autorizimin me shkrim të bordit ose të punonjësit përgjegjës të shkollës 8-vjecare apo të mesme, kolegjit apo universitetit në fjalë, do të dënohet me një gjobë jo më të shumë se një mijë dollarë ose me burg jo më shumë se dy vjet, ose me të dyja. Për qëllim të këtij paragrafi, "armë zjarri" do të thotë çdo lloj pistolete, revolveri, pushke apo arme nga e cila mund të qëllohet një e shtëënë, plumb, saçme me çdo lloj mënyre.

Çdo oficer përgjegjës i një shkolle 8-vjecare apo të mesme, kolegji apo universiteti, apo çdo anëtar fakulteti apo punonjës administrativ i një shkolle tetëvjeçare apo të mesme, kolegji apo universiteti që nuk raporton shkelje të këtij paragrafi do të jenë fajtorë për keqbjërje dhe do të dënohet me një gjobë prej jo më shumë se pesëqind dollarë.

Ligji që Ndalon Përdorimin e Duhanit në Shkollat Publike

(G.L. c. 71, § 2A)

Do të konsiderohet e paligjshme për çdo nxënës, të regjistruar në shkollat publike 8-vjecare apo të mesme në Commonwealth, që të zotërojnë, përdorin apo të shpërndajnë produkte duhani të çdo lloji tipi në mjediset e shkollës ose në çdo aktivitet të sponsorizuar nga shkolla.

Studentet qe kapen me produkte duhani, duke perfshire e-cigare, cigare pa tym dhe snus, do tju nenshtrohen procedurave disiplinore.

Shperndarja e produkteve qe permbajne nikotine perfshin ato artikuj qe kane prembajte duhani ose permbajne nikotine per perdorim nga njerezit, duke mos perfshire ketu vezendesues duhani qe eshte dhene me rrecete mjeksore nga doktori ose producte qe jane te aprovuara nga Ministria e Ushqimit dhe Ilaceve per tu shitur si ndihmes ne nderprerjen e cigares. Edhe e-cigare jane te prefshira ne kete listen e produkteve me nikotine

Zonat pa Drogë në Shkollë

Çdo person i cili shpërndan ose zotëron me qëllim shpërndarjen e çdo lloji substance të kontrolluar sikurse është përcaktuar nga Ligji i Përgjithshëm i Massachusetts-it Kapitulli 94C brenda një mijë këmbëve nga prona e Shkollave Publike Worcester, si kur shkolla është e hapur ashtu edhe kur shkolla është e mbyllur, do të dënohet me jo më pak se dy dhe jo më shumë se pesëmbëdhjetë vjet burgim. Për më tepër, një gjobë prej jo më pak se një mijë ose jo më shumë se dhjetë mijë dollarësh mund t'i jepet por jo në vend të një dënimi minimal të detyruar me burgim sikurse është caktuar nga ligji.

Abuzimi i Fëmijëve

Ligji i Përgjithshëm i Massachusetts Kapitulli 119, Pjesa 51A and 51B qeveris raportimin e abuzimit dhe neglizhimit të fëmijëve dhe kërkon që të gjithë punonjësit profesionistë të shkollave të raportojnë rastet kur dyshojnë se nxënësit po abuzohen ne Departamentin e Femijeve dhe Familjeve (508-929-2000).

Politika e Shkollave Private Worcester kërkon që personeli të informojë prindërit dhe kujdestarët kur ka një shenjë të sjelljes vetë-shkatërruese te nxënësit. Qëllimi i kësaj është që të njoftohen prindërit/kujdestarët rreth nevojës së mundshme të nxënësit për ndihmë dhe/ose trajtim tjetër.

Në lidhje me këtë kërkesë, autoritetet e shkollës do të paraqesin një raport 51A kur një prind/kujdestar shpërfill përpjekjet e personelit të shkollës për të përfshirë prindin/kujdestarin në një proces që mendohet i nevojshëm kur fëmija kërkon edukim të posaçëm, këshillim apo kujdes mjekësor urgent.

Edukimi i Fëmijëve të Pastrehë

Shkollat Publike Worcester janë në përputhje me të gjitha kërkesat e Ligjit McKinney-Vento për Mbështetjen ndaj të Pastrehëve (Nëntitulli B - Edukimi i Fëmijëve dhe të Rinjve të Pastrehë), riautorizuar përsëri në janar të vitit 200,2 dhe me amendamentet e këtij ligji sipas Ligjit që Cdo Student Arrin Suksesin (ESSA) të vitit 2015. Shkollat Publike të Worcesterit do të:

1. vendosin masa mbrojtëse për nxënësit e pastrehë nga ngacmimet dhe/ose diskriminimi në bazë të statusit të tyre si të pastrehë.
2. të sigurojë që të gjithë fëmijët dhe të rinjtë të marrin edukim falas të posaçëm dhe tu ofrohen mundësi kuptimplote për të patur sukses në shkollat tona.

3. të informojnë prindërit/kujdestarënxënësit për të drejtat e tyre për të apeluar endimet për regjistrim dhe transportin tek Komisioneri i Departamentit të Edukimit të Shkollave të Mesme dhe Filllore ose tek mëkëmbësi i tij/saj, në përputhje me Këshillin Edukativ të të Pastrehëve 2003-7; procesin e Rezolutës mbi Mosmarrëveshjet Edukative për të Pastrehët të McKinney-Vento; dhe
4. të ndjekë kërkesat e Ligjit McKinney-Vento;

Kur një familje regjistron një nxënës apo nxënësit në shkollë ose kur ndryshon adresën, por nuk është në gjendje të japë formularin e zakonshëm për verifikimin e adresës, ose e ndan shtëpinë me të tjerë ose përkohësisht është strehuar në një vend tjetër, anëtarit të familjes do t'i kërkohej të verifikojë situatën aktuale të jetesës në Formularin e Verifikimit të Adresës së Nxënësit për të përcaktuar nëse nxënësi(t) kanë të drejtën, në zbatim të ligjit McKinney-Vento për Ndhimën ndaj të Pastrehëve, të kërkojë shërbime ndihmëse shtesë dhe përjashtime nga disa kërkesa për regjistrime të përcaktuara ligjërish. Te gjithë nxënësit, të cilët banojnë në situata, që përputhen me statusin e të pastrehut kualifikohen për mënjëz dhe drejtë falas. Një aplikim për vaktet falas duhet të jetë në dosjen e çdo nxënësi, dhe ne.q.se nxënësi është klasifikuar si “i pastrehe” në aplikim, atëherë nuk ka nevojë për verifikim të ardhurash. Në pajtim me këto kërkesa:

1. Fëmijët e pastrehe kanë të drejtë të qëndrojnë në shkollën e mëparshme, ose të ndjekin shkollën ku ata banojnë përkohësisht, duke supozuar që marrëveshjet për transportin janë të realizueshme dhe në interesin më të mirë të nxënësit;
2. Nxënësit që zgjedhin të qëndrojnë në shkollën e origjinës kanë të drejtë të qëndrojnë atje deri në fund të vitit shkollor ku ata kanë strehim të përhershëm.
3. Nxënësit të cilët zgjedhin të regjistrohen në shkollën ku ata banojnë përkohësisht duhet të regjistrohen menjëherë, edhe pse nuk sjellin me vete dokumentacionin që kërkohet zakonisht për regjistrim.
4. Nëse një nxënës i pastrehe arrin pa dokumentacion, distrikti i shkollës së caktuar nga Ndërlidhja Edukative e të Pastrehëve duhet të ndihmojë familjen dhe të kontaktojë sistemin e shkollës së ndjekur më parë për të marrë dokumentacionin që kërkohet.
5. Sa më shumë të jetë e mundur, transporti do të ofrohet për nxënësit që ata të ruajnë vazhdimësinë e vijueshmërisë së tyre në një shkollë të vetme gjatë vitit shkollor.
6. Kur një nxënës banon jashtë qytetit për shkak të rrethanave të lidhura me statusin e të pastrehut (në përputhje me përkufizimin ligjor të “të pastrehut”) do të koordinohen përpjekjet me distriktin ku nxënësi banon përkohësisht që të ofrojnë transport tek shkolla e origjinës nëse kjo është preferenca e prindit/kujdestarit të nxënësit.

7. Personat që jetojnë në streha për persona të keqtrajtuar ose në strehë të sigurtë mund ti japin zyrtarëve të shkollës numrin e Kutisë së Postare ose adresën e zyrës së strehës, së bashku me një formular verifikimi nga drejtori i qendrës ku fëmijët banojnë në atë objekt në vënd të adresës dhe rrugës.
8. Pyetjet në lidhje me çështjet që u përkasin nxënësve të pastrehë duhet t'i drejtohen Punonjësës Ndërlidhëse për të Pastrehët për Shkollat Publike të Worcester-it, Bertha Elena Rojas në (508) 799-3623.

Shërbimi Përzgjedhës

Kërkesa për regjistrim në kohë paqeje për Shërbimin e Sistemit Selektiv

Pjesa 3 e Ligjit për Shërbimin Selektiv Ushtarak përcakton se qytetarët meshkuj të SHBA-së dhe të huajt që banojnë në SHBA, që janë ndërmjet moshave 18 dhe 26 vjeç duhet të regjistrohen siç përshkruhet nga deklarata e Presidentit. Deklarata sipas të cilës kërkohet aktualisht regjistrimi është firmosur në 2 korrik 1980. Ajo përcakton se meshkujt e lindur më ose pas 1 janarit 1960, duhet të regjistrohen në Shërbimin Selektiv brenda 30 ditëve pas të kenë mbushur 18 vjeç.

Ligji "Asnjë fëmijë të mos lihet mbrapa" i vitit 2001 thekson se degë të ndryshme të forcave të armatosura të Shteteve të Bashkuara mund të kenë mundësinë të përdorin numërorin e informacionit për klasat e 11-ta dhe të 12-ta të nxënësve të shkollës së mesme. Megjithatë, Ligji për të Drejtat e Familjes dhe Fshehtësinë deklaroi se prindërit dhe kujdestarët mund ta refuzojnë këtë mundësi nëse dëshirojnë. Informacioni në numëror përfshin emrin e djalit/vajzës tuaj, adresën, numrin e telefonit, dhe moshën e tij/të saj. Nëse dëshironi që Shkollat Publike të Worcester-it të MOS e publikojnë informacionin e fëmijës tuaj, duhet që këtë kërkesë t'ia drejtoni me shkrim drejtorit të fëmijës tuaj.

Regjistri i Personave që Kryejnë Shkelje Seksuale

Informacioni për publikun

Massachusetts ka krijuar një regjistër për personat që kryejnë krime seksuale të ligjëruar nga Kapitulli 239 i Ligjit të vitit 1996. Sipas këtij ligji personave të dënuar për disa krime seksuale ju kërkohet të regjistrohen në drejtorinë e policisë se ku jetojnë dhe punojnë. Përcaktimi për çdo shkelje të veçantë jepet nga Bordi Shtetëror i Sistemeve Historike të Krimeve. Ligji kërkon që çdo person që kërkon informacion mbi shkelësit seksuale duhet të paraqitet vetë në zyrat qendrore të policisë për të marrë informacionin nga regjistri i shkelësve. Për më shumë informacion kontaktoni Drejtorinë e Policisë në Worcester (508) 799-8651.

Rregulli i Betimit për Besnikëri dhe "Momenti i Heshtjes"

Është në rregulloren e Shkollave Publike Worcester që të recitohet Betimi për Besnikëri dhe të mbahet një "Moment Heshtje" në të gjitha nivelet çdo ditë.

Të Dhënat e Regjistruara të Nxënësve Të Drejtat Edukative të Familjes dhe Ligji mbi Intimitetin Personal

Të Drejtat Edukative të Familjes dhe Ligji mbi Intimitetin Personal (FERPA) (20 U.S.C. § 1232g; 34 CFR Part 99) është një ligj Federal i cili mbron intimitetin e të dhënave edukative të nxënësve. Ligji përfshin të gjitha ato shkolla që marrin fonde federale.

FERPA u jep prindërve disa të drejta lidhur me të dhënat edukative të fëmijës së tyre. Këto të drejta i kalojnë nxënësit kur ai ose ajo mbush moshën 18 vjet. Nxënësve të cilëve do tu kalojnë këto të drejta janë “nxënëit të cilëve u takojnë ato.”

FERPA u jep prindërve dhe nxënësve të pranuar të drejtat e mëposhtme:

- Të inspektojnë dhe rishikojnë të dhënat edukative të nxënësit të mbajtura nga shkolla. Shkollave nuk u kërkohet të lëshojnë kopjet e të dhënave përveç rastit kur është e pamundur për prindërit ose nxënësit e pranuar të rishikojnë ato. Shkollat mund të kërkojnë pagesën e një tarrife nëse u kërkohet të lëshojnë kopje.
- Të kërkojnë që shkolla të korrigjojë të dhënat të cilat ata mendojnë që janë të pasakta ose të gabuara. Nëse shkolla vendos të mos ndryshojë të dhënat, atëhere prindi ose nxënësi i pranuar ka të drejtën e një seance dëgjimore formale. Pas seancës dëgjimore, nëse shkolla vazhdon të vendosë të mos ndryshojë të dhënat, prindi ose nxënësi i pranuar ka të drejtën të lëshojë një deklaratë për vendosjen e të dhënave me mendimin e tij ose saj mbi informacionin e diskutuar.
- Të kenë kontroll mbi zbulimin e informacionit personal të identifikuar nga të dhënat edukative. Në përgjithësi, shkollat duhet të jenë të pajisura me autorizim nga prindi dhe nga nxënësi i pranuar që të japin çdo informacion nga të dhënat edukative të nxënësit. Megjithatë, FERPA lejon shkollat të zbulojnë këto të dhëna, pa miratim, grupeve të mëposhtme ose nën kushtet e mëposhtme (34 CFR § 99.31):
 - Zyrtarëve të shkollës me interes edukativ ligjor
 - Shkollave të tjera në të cilat transferohet nxënësi
 - Zyrtarëve të caktuar për kontroll ose për qëllime vlerësimi
 - Grupeve të përshtatshme të lidhura me ndihmat financiare të nxënësit
 - Organizatave që kryejnë disa studime për ose në emër të shkollës
 - Organizatave akredituese
 - Ti binden urdhrat gjyqësor ose fletëthirrjes së ligjshme të lëshuar nga gjyqi
 - Zyrtarëve të përshtatshëm të lidhur me çështjet urgjente të shëndetit dhe sigurisë dhe
 - Shtetit dhe autoriteteve lokale, përbrenda sistemit gjyqësor të të miturve, që ndjekin ligjin e veçantë të Shtetit

FERPA lejon shkollat të zbulojnë, pa miratim, informacion mbi “regjistrin”, i cili përfshin: Emrin e Nxënësit, Nderet dhe çmimet e marra; Pjesëmarrjen në aktivitetet dhe sportet e organizuara zyrtarisht; Peshën dhe gjatësinë e anëtarëve të ekipeve sportive.; Shkollën ose programin ku merr pjesë; Statusin e regjistrimit; Nivelin e klasës; dhe Datat e vijueshmërisë në shkollë.

Prindërit dhe nxënësit e pranuar mund të kërkojnë që Shkollat Publike Worcester të mos zbulojnë informacion mbi regjistrin duke kontaktuar David Perda, Shefi i Kërkimeve dhe Inspektori i Përgjegjshmërisë, Shkollat Publike Worcester me email: perdad@worc.k12.ma.us ose nëpërmjet postës së U.S. me adresën, Durkin Administration Building, Room 202, 20 Irving Street, Worcester, MA, 01609.

Informacion shtesë mbi FERPA-n mund të merret nga Departamenti i Edukimit të U.S. në adresën e mëposhtme:

Family Policy Compliance Office
U.S. Department of Education
400 Maryland Avenue, SW
Washington, D.C. 20202-8520

Rregulloret

Në përputhje me Kapitullin 71, Pjesën 34D të Ligjit të Përgjithshëm të Commonwealth të Massachusetts, Departamenti i Shkollave Worcester njofton prindërit/kujdestarët e nxënësve të shkollës publike për planet e tij, në lidhje me grumbullimin e informacionit për nxënësit dhe të kaluarat e tyre, prirjeve dhe arritjeve në mënyrë që të plotësohen më mirë nevojat e tyre individuale.

Në nivelin sekondar, nxënësve do t'ju kërkohej të plotësojnë një pyetësor i cili ka të bëjë me identifikimin e informacionit, historikun e familjes, interesat, dhe planet për të ardhmen. Çdo pyetje që nxënësit dhe/ose prindërit/kujdestarët mendojnë se nuk duhet t'i përgjigjen mund të lihet pa përgjigje. Ky informacion është i nevojshëm në mënyrë që të dhënat e shkollës të jene sa me të freskta.

Çdo ndryshim nga plani i paraqitur do të njoftohet me shkrim përpara se të zbatohet.

Të dhënat të tjera që i përkasin Kapitullit 71, Pjesës 34D janë paraqitur këtu më poshtë. Në shkurt të vitit 1976, Bordi i Edukimit të Massachusetts-it rishikoi rregulloret në lidhje me të dhënat e nxënësve. Këto rregulla sigurojnë të drejtën e prindërve/kujdestarëve dhe nxënësve për fshehtësi, inspektim, korrigjimin dhe shkatërrimin e të dhënave.

Komiteti i Shkollave Worcester i ka adoptuar këto rregulla dhe ka miratuar procedurat e sugjeruara për zbatimin e tyre.

Ky njoftim paraqet të drejtat përkatëse të prindërve/kujdestarëve dhe studentëve, të moshës 14 vjeç ose më të mëdhenj, në lidhje me fshehtësinë, inspektimin, korrigjimet dhe shkatërrimin e të dhënave të nxënësit.

Llojet e të dhënave të nxënësve

Drejtori i shkollës ose mëkëmbësi i tij/i saj është përgjegjës për fshehtësinë dhe sigurinë e të gjithë të dhënave të regjistruara të nxënësve të mbajtura në shkollë. Kryeinspektori i shkollave ose mëkëmbësi i tij/i saj janë përgjegjës për të gjithë të dhënat e regjistruara të nxënësve që nuk janë në mbikqyrjen e drejtorit të shkollës.

Të dhënat e regjistruara të nxënësve konsistojnë në transkriptin dhe të dhënat e regjistruara të përkohshme, sipas Kodit të Massachusetts për Rregullimet, Kapitulli 23.00. Ato përfshijnë të gjithë informacionin, pavarësisht nga forma apo karakteristikat, që kanë të bëjnë me një nxënës, dhe është organizuar mbi baze të emrit të nxënësit ose në mënyrë të tillë që nxënësi mund të identifikohet individualisht.

1. **Dëftesat**- Të dhënat administrative minimale të nevojshme për të reflektuar ecurinë arsimore të nxënësit dhe për të operuar sistemin arsimor. Të dhënat janë të kufizuara në:

- Emrin (i nxënësit dhe prindit/kujdestarit)
- Adresën (e nxënësit dhe prindit/kujdestarit)
- Numrin e telefonit (të nxënësit dhe prindit/kujdestarit)
- Datën e lindjes:
- Emrat e lëndëve
- Notat ose ekuivalentët
- Kreditet e kurseve
- Nivelin e klasës së përfunduar
- Vitin e përfunduar

Transkriptimi mund të shkatërrohet gjashtëdhjetë (60) vjet pasi nxënësi të jetë diplomuar, transferuar, ose larguar nga sistemi shkollor.

2. **Rekordet e përkohshme**: I gjithë informacioni në të dhënat e regjistruara të nxënësit që nuk përfshihet në transkriptim i cili duket qartë se është i rëndësishëm për procesin arsimor. Ky informacion mund të përfshijë:

- Rezultatet e testeve standarde (përfshi rezultatet MCAS)*
- Nivelin e klasës
- Aktivitete jashtëshkollore
- Vlerësimet
- Planet e edukimit
- IEP, 504, Adaptim në Edukimin e Rregullt , Plane Ndihmes të Sjelljes dhe Plane Ndihmes të Sigurisë
- Raportet e procesit të mbështetjes së nxënësit
- Planet e suksesit individual të nxënësve
- Dokumentat mbi shëndetin
- Frekuentimi i shkollës
- Raportet e incidenteve që përfshijnë pezullimin e nxënësve ose kryerjen e akteve kriminale
- Të dhënat e disiplinimit në shkollë

* Në përputhje me Ligjin Gjeneral të Massachusetts-it, Kapitulli 71, Pjesën 87, rezultati i çdo testi inteligjence për grupe do të fshihet nga të dhënat e regjistruara të nxënësit në fund të vitit shkollor në të cilin është bërë testi.

Pjesa 37L e Ligjit të Reformës në Arsim të vitit 1993 kërkon që çdo raport incidenti që përfshin pezullimin e nxënësit për kryerjen e akteve kriminale duhet të përfshihet në të

dhënat e regjistruara të nxënësit. Kjo përfshin raporte në të cilat "nxënësi" është akuzuar për një shkelje që rezultoi në pezullim. çdo lloj akti të pezulluar. Nëse një nxënës transferohet në një sistem shkolle të ri, ky informacion duhet të përfshihet si pjesë e të dhënave të nxënësit, pasi sistemi të ri duhet t'i jepet ky informacion.

Shënimet e mësuesve dhe informacioni i ngjashëm që nuk mund të merret nga personeli i autorizuar i shkollës ose nga palë të treta nuk përfshihen në të dhënat e regjistruara të nxënësit. Ky informacion mund t'i jepet nxënësve, prindërve/kujdestarëve, ose personave zëvendësues të përkohshëm pa e bërë dosjen pjesë të të dhënave të regjistruara të nxënësve. Megjithatë, nëse ky informacion i jepet personelit të autorizuar të shkollës, atëherë bëhet pjesë e të dhënave të regjistruara të nxënësit. Çdo informacion i shtuar në të dhënat e përkohshme do të përfshijë emrin, firmën dhe pozicionin e personit që regjistron informacionin, datën e hyrjes, dhe do të kufizohet në atë që ka të bëjë me nevojat arsimore të nxënësit.

Të dhënat e përkohshme të çdo nxënësi të regjistruar më ose pas qershorit të 2002-it do të shkatërrohen jo më vonë se shtatë (7) vjet pas transferimit, diplomimit ose tërheqjes së nxënësit nga shkolla e distriktit. Nxënësi përkatës dhe prindi/kujdestari i tij/i saj do të njoftohen me shkrim për datën e përafërt të shkatërrimit të të dhënave të regjistruara të përkohshme dhe të drejtën e tyre për ta marrë informacionin e plotë apo të pjesshëm, në kohën e transferimit, diplomimit dhe largimit.

Gjatë kohës që nxënësi është regjistruar në shkollë, drejtori ose mëkëmbësi i tij/i saj do të rishikojë periodikisht dhe do të shkatërrojë informacionet çorientuese, të vjetruara ose pa lidhje që mund të jenë në të dhënat e përkohshme. Shkollat Publike të Worcester-it njoftojnë çdo vit se të dhënat e përkohshme fo të rishikohen ose shkatërrohen në fund të çdo viti shkollor, si të mendohet e përshtatshme. Në rast se prindërit/kujdestarët dëshirojnë të marrin informacion ose një kopje përpara se të dhënat të shkatërrohen duhet të kontaktojnë drejtorin deri më 1 qershor të çdo viti shkollor.

3. Kush mund t'i përdorë të dhënat e nxënësve

Personeli i mëposhtëm mund të përdorë të dhënat e nxënësve gjatë kryerjes së detyrës së tyre:

- a) Administratorët e shkollës, mësuesit, këshilltarët dhe profesionistët e tjerë të cilat janë punësuar nga Komiteti i Shkollës ose të cilët i ofrojnë shërbime nxënësve sipas një marrëveshje ndërmjet Komitetit të Shkollës dhe ofruesit të shërbimit i cili punon direkt me nxënësit.
- b) Personeli administrativ i zyrave dhe personeli i administratës, përfshi operatorët e pajisjeve të përpunimit të të dhënave ose pajisjeve që prodhojnë mikrofilma/mikrofisha të cilët përpunojnë informacionin për të dhënat e nxënësve. Ky personel do të ketë të drejtën të përdorë vetëm informacionin e regjistruar për nxënësit që ju duhet për të kryer detyrën e tyre.
- c) Ekipi i Vlerësimit i cili vlerëson fëmijët në zbatim të Kapitullit 71B të Ligjit të Përgjithshëm të Massachusetts-it.
- d) Personeli shëndetësor i shkollës dhe ai lokal, si dhe departamenti i shtetit për shëndetin gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

- e) Personat e meposhtem qe kryejne rolin e prindit do te kene mundesine te perdorin te dhenat e nxenesit:
- Prindërit kujdestarë (prind që ka të drejtën ligjore të kujdeset)
 - Kujdestari i nxënësit
 - Një person ose agjenci e autorizuar ligjërisht për të vepruar në emër apo në lidhje me babain, nënën apo kujdestarin e nxënësit, duke supozuar se ky baba, nënë apo kujdestar kanë të drejtën ligjore të kujdestarisë.
- f) Prindërit që nuk kanë të drejtën ligjore të kujdesjes **nuk do të** kenë të drejtën të përdorin të dhënat e regjistruara të nxënësit nëse:
- Prindit, te cilit i është ndaluar kujdestaria ligjore për shkak të rrezikut te sigurisë të fëmijës ose të prindit kujdestar.
 - Prindit i është ndaluar e drejta që të vizitojë ose është urdhëruar të bëjë vizita të mbikëqyrura.
 - Takimi i prindit me fëmijën ose prindërit kujdestarë është kufizuar nga një urdhër mbrojtës i përkohshëm ose i përhershëm, përveç ras-teve kur urdhri i mbrojtjes (ose çdo lloj urdhri tjetër i mëpasëm që modifikon urdhrin mbrojtës) specifikisht lejon përdorimin e informacionit të nxënësit në statut.
Ligji i Përgjithshëm i Massachusetts-it, Kapitulli 71 § 34H kërkon që prindërit jo-kujdestarë t'i paraqesin kërkesë me shkrim drejtorit të shkollës për të marrë të dhënat e regjistruara të nxënësit. Për më shumë informacion kontaktoni drejtorin e fëmijës tuaj.
- g) Nxënësi, nëse është katërmbëdhjetë (14) vjeç ose kur hyn në klasën e nëntë (9).
- h) Personeli i autorizuar administrativ i shkollës mund të ekzaminojë të dhënat e regjistruara për arsye administrative edhe nëse ata nuk ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta për nxënësin.
- i) Zyrtarët federalë, shtetërorë dhe vendorë të edukimit dhe agjentët e tyre të autorizuar, nëse është e nevojshme, në zbatim të ligjeve federale dhe të shtetit për edukimin. Është e detyrueshme që të dhënat personale të identifikueshme të mbrohen dhe shkatërrohen kur nuk nevojiten më.
- j) Shkollat Publike të Worcester-it do t'ia dërgojë të dhënat e regjistruara të nxënësit personelit të autorizuar të shkollës në të cilën nxënësi është transferuar apo kërkon të regjistrohet [603 CMR 23.07 (4)(f)].
- k) Pas marrjes së urdhrin nga gjykata ose thirrjeje të lëshuar në bazë të ligjit, nëse nxënësi ose prindi/kujdestari njoftohen në një periudhë kohe të arsyeshme se ai/ajo mund të kërkojë të anulojë procesin, sikurse kër-kohet nga Ligji i Përgjithshëm i Masachusetts-it, Kapitulli 66A, § 2(k).
- l) Departamenti i Fëmijëve dhe Familjeve (DCF).
- m) Një oficer i lirit me kusht.
- n) Një gjykatës i çdo gjykate.
- o) Departamenti i Shërbimeve për të Rinjtë (DYS).
- p) Byroja e Posaçme për Hetimet mbi Mashttrimet mbi Ndihmën Sociale mund të kontrollojë regjistrimet dhe të dhënat e ndjekjes së shkollë për çdo nxënësi i cili po hetohet për mashttime ndaj ndihmës sociale ose çdo nxënësi që është fëmija, i mituri

apo në vartësi të dikujt i cili po hetohet për mashtrime ndaj ndihmave sociale. Ligji e ndalon Byronë të marrë të dhënat akademike, mjekësore apo të vlerësimeve.

- q) Palët përkatëse, përfshi departamentin lokal të policisë dhe Departamentin e Fëmijëve dhe të Familjeve (DCF), në lidhje me një emergjencë për shëndetin apo sigurinë, përfshi raporte mbi armët, nëse njohja e informacionit është e nevojshme për të mbrojtur shëndetin apo sigurinë e nxënësve apo individëve të tjerë.
- r) Shkollave ju kërkohet me ligj shtetëror të venë shënim në të dhënat e regjistruara të një nxënësi që është raportuar i humbur, dhe duhet të njoftojnë policinë sa herë që mund të ketë një kërkesë për të dhënat.
- s) Në përputhje me rregulloret federale një shkollë mund të japë emrin, adresën, numrin e telefonit, datën dhe vendin e lindjes, fushën kryesore të studimeve, datat e ndjekjes së shkollës, peshën dhe gjatësinë e anëtarëve të skuadrës atletike, klasën, pjesëmarrjen në aktivitete të njohura dhe aktivitete sportive, diplomat, çmimet dhe shpërblimet, planet pas shkollës së mesme pa miratimin e mëparshëm të nxënësit apo prindit/kujdestarit përkatës. Kjo shërben si njoftim publik i llojeve të informacionit që Shkollat Publike Worcester mund të japin. **Nxënësit dhe prindërit/kujdestarët që nuk dëshirojnë që informacion t'i jepet palëve të treta duhet t'i paraqesin kërkesë me shkrim drejtorit të shkollës.**

Përdorimi nga palët e tjera të treta kërkon miratimin me shkrim të nxënësit prindit/kujdestarit përkatës përveç rasteve të dispozitave të specifikuar nën pikën 23.07(4) rregulloreve. Kur jepet miratimi, nxënësi ose prindi/kujdestari përkatës do të ketë të drejtën të caktojë se cila pjesë e të dhënave të regjistruara të nxënësit do t'i jepet palës së tretë. Një kopje e këtij miratimi do të mbahet nga nxënësi ose prindi/kujdestari përkatës dhe një kopje tjetër do të ruhet në të dhënat e regjistruara të përkohshme. Përveç informacionit të përshkruar në 603 CMR 23.07(4)(a), informacion personal i identifikueshëm nga të dhënat e nxënësit do t'i jepet një palë të tretë me kushtin se ai/ajo nuk do të lejojë një palë të tretë tjetër që t'i përdorë këto informacione pa miratimin e shkruar të nxënësit ose prindit/kujdestarit përkatës.

Korrigjimi i të Dhënave të Regjistruara të Nxënësit

Nxënësi dhe/ose prindi/kujdestari i tij do të kenë të drejtën të shtojnë informacione, komente, të dhëna dhe çdo lloj material të përshtatëm me shkrim në të dhënat e regjistruara të nxënësit.

Personat e mësipërm do të kenë të drejtën të kërkojnë fshirjen ose korrigjimin e çdo lloj informacioni që ruhet në të dhënat e regjistruara të nxënësit. Ata do të kenë edhe të drejtën e një mbledhjeje me drejtorin për të paraqitur kundërshtimet në lidhje me materialet e përfshira tek të dhënat.

Në rast se nxënësi ose prindi/kujdestari i tij nuk janë të kënaqur me vendimin e drejtorit atëherë ata do të kenë të drejtën të apelojnë me shkrim tek Kryeinspektori që të bëhet një rishikim i kundërshtimeve. Nëse përgjigja e kryeinspektorit nuk është e kënaqshme mund të bëhet një apel i mëtejshëm tek Komiteti i Shkollës. Komiteti i Shkollës do të mbajë një seancë dëgjimore brenda katër javësh nga njoftimi me shkrim për apel. Nxënësi dhe/ose prindi/kujdestari mund të përfaqësohen nga një avokat i tij/saj, për të pyetur përsëri

dëshmitarët dhe për të paraqitur dëshmitë. Vendimi do t'i jepet nxënësit dhe/ose prindit/kujdestarit të nxënësit me shkrim.

Rregulli për Njoftimin e Prindërve mbi Edukimin Seksual

Në përputhje me Pjesën 32A, Kapitullin 71 të Ligjit të Përgjithshëm të Massachusetts-it, Komiteti i Shkollës ka adoptuar politikën e mëposhtme:

Në fillim të çdo viti shkollor, të gjithë prindërit/kujdestarët e nxënësve në Shkollat Publike të Worcester-it do të njoftohen me shkrim për kurset dhe programin e ofruar që kryesisht përfshin edukimin seksuale tek njerëzit ose çështje të seksualitetit tek njerëzit. Drejtori i çdo shkolle do të jetë përgjegjës për dërgimin e njoftimit(eve) te prindit/kujdestarit të nxënësit. Njoftimi për prindërit do të përmbajë datën dhe kohën e një takimi me prindin/kujdestarin i cili do të mbahet në shkollë. Në takimin me prindin/kujdestarin, mësuesi i shkollës për lëndën e shëndetit dhe biologjisë do të përshkruajë kursin në hollësi dhe do t'ju përgjigjet pyetjeve dhe shqetësimeve që mund të kenë prindërit/kujdestarët rreth përmbajtjes dhe ofrimit të kursit.

Drejtorët do t'ia japin këtë njoftim me shkrim prindërve/kujdestarëve të atyre nxënësve të cilët regjistrohen në shkollë pas fillimit të shkollës në momentin e regjistrimit.

Nëse programi shkollor ndërrohet gjatë vitit shkollor, deri në masën e mundshme, prindërit/kujdestarët do të njoftohen për këtë fakt me kohë përpara se të zbatohen ndryshimet.

Secili njoftim që ju dërgohet prindërve/kujdestarëve do të përfshijë një përshkrim të shkurtër të programit që mbulohet nga kjo politikë dhe do të informojë prindërit/kujdestarët që ata mund të:

1. mos e lejojnë fëmijën në asnjë pjesë të programit që kryesisht përfshin çështje të seksualitetit të njerëzve, pa ndikuar në notat e nxënësit dhe formimin akademik. Prindërit/kujdestarët që kërkojnë që fëmijët e tyre të përjashtohen nga ky program mund t'i dërgojnë drejtorit të fëmijës një letër ose t'i dërgojnë formularin bashkangjitur në njoftimin e prindit/kujdestarit. Prindi/kujdestari duhet të specifikojë kursin, klasën ose aktivitetin shkollor nga i cili fëmija duhet të përjashtohet. Çdo nxënës i cili është përjashtuar me kërkesën e prindit/kujdestarit në përputhje me këtë politikë do t'i jepet një detyrë alternative ose një periudhë studimi e udhëzuar gjatë kohës së përjashtimit.
2. të shqyrtojnë dhe rishikojnë materiale mësimore të programit për këto programe, të cilat do t'ju ofrohen për tu parë prindërve/kujdestarëve dhe të tjerëve në masën e mundshme praktike. Prindërit/kujdestarët mund të organizojnë me drejtorin që t'i shikojnë materialet në shkollë, ose në Zyrën e Edukimit mbi Shëndetin të Shkollave Publike Worcester, 20 Irving Street, Worcester, MA (508) 799-3075 dhe/ose në Zyrën e Shkencës dhe Teknologjisë/Inxhinierisë, 20 Irving Street, Worcester, MA (508) 799-3479.

Një prind/kujdestar, i pakënaqur me procesin e njoftimit, mundësinë për të parë materialet, dhe përjashtimin e një nxënësi sipas kësaj politike do të ndjekë Procedurat për

Zgjidhjen e Problemeve që kanë të bëjnë me shkollën sikurse janë përshkruar në këtë Manual të Politikave.

Pasi të ndiqet procesi i shkollës së distriktit për zgjidhjen e problemeve, një prind/kujdestar i cili përsëri nuk është i kënaqur mund t'i shkruajë Komisionerit të Edukimit në adresën 75 Pleasant Street, Malden, Massachusetts 02148 për të kërkuar një rishikim të çështjes(eve) në diskutim.

Njoftimi Vjetor për Prindërit/Kujdestarët mbi Mbrojtjen e Amendamentit të të Drejtave të Nxënësit (PPRA)

Shkollat Publike Worcester do të informojnë prindërit/kujdestarët për çdo ekzaminim të nxënësve, ku fëmijëve të tyre mund t'i kërkohet të marrin pjesë dhe që përfshin pyetje mbi përdorimin e droges, aktivitetin seksual, përkatësiwe poli-tike/fetare, ose informacioneve të tjera personale. Të gjitha këto anketa janë mbi baza vullnetare dhe anonime. Nje kopje e anketes do te jete ne dispozicion per rishikim nepermjet drejtorit dhe ne website te Shkollave Publike Worcester.

Rregulli Vullnetar i Uniformës së Shkollës

Komiteti i Shkollës ka miratuar Rregullin Vullnetar të mëposhtme për Uniformën:

1. Rregulli i uniformave vullnetare duhet të pajtohet me rregullat ekzistuese të Komitetit të Shkollës për veshjen e nxënësit.
2. Përpara se të kërkohet aprovimi nga Komiteti i Shkollës, shumica e anëtarëve të këshillit të shkollës dhe drejtori i shkollës duhet të miratojnë rregullin vullnetar të uniformës së shkollës.

Drejtori e dërgon kërkesën tek Nënpunësi i Komitetit të Shkollës i/e cili(a) e vendos në axhendën e Komitetit të Shkollës për aprovim, gjë e cila pastaj do ta lejojë shkollën që ta implementojë këtë rregullore.

3. Nuk do të ndërmerren masa disiplinore nëse një nxënës nuk i përmbahet rregulli vullnetar të uniformës.

Rregulli i Kodit të Veshjes së Nxënësve

Veshjet e nxënësve nuk duhet të ndërpresin apo të shkëpusin vëmendjen nga procesi arsimor i shkollës. Ndërkohë që janë në shkollë, nxënësit do të mbajnë veshje që përmbushin standardet e mëposhtme:

- Nuk do të mbajnë kapele, shami koke, shalle ose fasha për djerstjen
- Nuk do të zbulojnë kurrizin
- nuk do të veshin blua/këmisha shume te hapura, që ekspozojnë gjoksin
- Nuk do të zbulojnë barkun dhe mesin (duhet që gjatësia këmishës/bluzës të jetë e mjaftueshme për tu futur brenda)
- Nuk do të jenë zbathur, ose me këpucë/sandale që nuk janë të sigurta
- Nuk do të mbajnë veshje që janë të tejdukshme

- Nuk do të mbajnë veshje që kanë të shkruara fjalët (në çdo lloj gjuhe)/grafik që janë të turpshme dhe vulgare, të dhunshme, seksi, raciste dhe/ose ndihmojnë përdorimin e drogës së paligjshme/alkoolit/duhanit.
- nuk do të mbajnë veshje që janë të lidhura me banda, dhunë ose kulte (refe-rojuni Rregullit 17, Politika për veshjet e bandave dhe veshjet e pahijshme)
- Nuk do të mbajnë pantallona që bien ose veshje që lejojnë të duken veshjet e brendshme
- Gjatësia e pantallonave të shkurtra dhe fundeve duhet të jetë më e gjatë se maja e gishtave të nxënësit/es kur ajo zgjat krahun poshtë
- nuk do të mbajnë veshje të sipërme Shembull: xhaketa/xhupa/pardesy

Drejtori i shkollës, ka të drejtën të vendosë se çfarë konsiderohet të jetë veshje e përshtatshme dhe e papërshtatshme, dhe nëse është e nevojshme mund të mos i marrë parasysh këto kufizime në situata fetare dhe/ose mjekësore. Drejtori mund të përcaktojë se çfarë pasojash do të vijnë nëse një nxënëse nuk pajtohet me këtë politikë.

Punishtja e Shkollës së Mesme Teknike Worcester dhe Rregulli i Uniformës

Instrukturët e punishtes, së bashku me shefat përkatës së departamenteve, kanë përgjegjësinë të ofrojnë një mjedis të sigurt në dyqan për të gjithë nxënësit. Të gjitha zanatet kërkojnë uniformë ose veshje specifike, dhe pajtimin me standardet e vendit të punës për paraqitjen përtej kërkesave të shkollës për veshjen përshkruar në Manualin e Shkollës së Mesme Teknike të Worcester-it. Instrukturët e punishtes së bashku me shefat e departamenteve përkatëse të profesioneve identifikojnë veshjet e nevojshme siç janë përshkruar në shtojcën e Shkollës së Mesme Teknike të Worcester-it. Administrata zbaton këto kërkesa.

Ligji i vitit 2001 Asnjë Fëmijë të Mos Mbetet Mbrapa

Shkollat Publike të Worcester-it bëjnë çdo përpjekje për t'u pajtuar me rregullat dhe kërkesat e legjislacionit Federal të Ligjit të vitit 2001 Asnjë Fëmijë të Mos Mbetet Mbrapa (NCLBA). Ky legjislacion kërkon që personeli i shkollës së distriktit të njoftojë prindin/kujdestarin mbi probleme të ndryshme që kanë të bëjnë me edukimin e fëmijës së tyre. Ndër të tjera ata duhet të njoftojnë prindërit/kujdestarët e nxënësve që ndjekin shkollat nën Titullin I për të drejtat e tyre për të njohur kualifikimet e mësuesve dhe ndihmës mësuesve të cilët punojnë me fëmijët e tyre.

Në një shkollë të Titullit I, prindërit/kujdestarët kanë të drejtën të njohin kualifikimet profesionale të mësuesve klasës që ju jep mësim fëmijës së tyre. Ligji "Asnjë Fëmijë të Mos Ngelet Mbrapa" i lejon prindërit/kujdestarët të kërkojnë informacione të caktuara rreth mësuesve të klasës së nxënësit dhe kërkon që distrikti t'i ofrojë prindërve/kujdestarëve informacionin e kërkuar në kohë nëse prindi/kujdestari e kërkon atë. Prindërit/kujdestarët

kanë të drejtën të kërkojnë informacionin e mëposhtëm për çdonjërin nga mësuesit e klasës së fëmijës së tyre në një shkollë të Titullit I:

- Nëse Departamenti i Edukimit të Massachusetts ka licencuar, kualifikuar, ose miratuar mësuesen për klasat dhe lëndët që ai ose ajo jep mësim.
- Degën kryesore për të cilin mësuesi/ja ka studiuar në Universitet, nëse mësuesi(ja) ka kualifikime pas-universitare dhe nëse ka, cfare lënde dhe kualifikim.
- Nëse asistentë mësimdhënës ose paraprofesionistë të tjerë i ofrojnë shërbime fëmijës tuaj, dhe nëse po, kualifikimet e tyre.

Nëse prindërit/kujdestarët dëshirojnë të marrin çdo pjesë të këtyre informacione, ata duhet të kontaktojnë drejtorin e shkollës së fëmijës së tyre nën Titullin I. Gjithashtu, distriktet janë të detyruar të informojnë prindërit/kujdestarët në kohën e duhur kur fëmijet e tyre janë caktuar, ose i është dhënë mesim për me shume se kater jave në vazhdim nga një mësues që nuk është shumë i kualifikuar.

KODI I SJELLJES

Filozofia

Është në politikën e Shkollave Publike të Worcester-it të sigurohen praktika disiplinore të drejta dhe efikase. Çdo nxënës ka të drejtë të marrë një edukim në një mjedis të sigurtë, të siguruar dhe përkrahës, dhe çdo mësues ka të drejtë të presë nxënës të respektuar dhe të përgatitur në klasën e tij/saj.

Një aspekt kyç në edukimin e nxënësit është përvetësimi i aftësive shoqërore dhe i aftësive të sjelljes, pasi që mësimi efikas mund të ndodhë vetëm kur nxënësit u binden rregullave bazë të sjelljes. Kjo do të thotë që:

- Nxënësit kanë përgjegjësi të sillen në mënyrë të tillë që të jetë në interesin më të mirë të shkollës dhe të nxënësve të saj.
- Prindërit/kujdestarët kanë përgjegjësi të zhvillojnë qëndrime pozitive drejt studimit dhe sjelljes.
- Mësuesit kanë përgjegjësi të vazhdojnë zhvillimin e sjelljes nëpërmjet mësimdhënies dhe disiplinës në klasë.
- Administrata dhe Komiteti i Shkollës kanë përgjegjësi të përkrahin dhe ruajnë zbatimin e disiplinës brenda godinave të shkollës.

Te gjithë nxënësit pritet që të përmbushin kërkesat e sjelljes sikurse është përcaktuar në këtë manual. Kapitulli 71B i Ligjit të Përgjithshëm të Massachusetts, i njohur si Kapitulli 766, kërkon që të vendosen dispozita shtesë për nxënësit që janë konstatuar nga një ekip vlerësimi të kenë nevoja të posaçme dhe programi i të cilëve përshkruhet si një Plan Edukimi i Individualizuar. (IEP). Këto dispozita do të ofrohen, kur janë të përshtatshme, edhe për nxënësit me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike të cilëve u ofrohen akomodime ose marrin shërbime përkatëse nën planin 504.

Kodi i Sjelljes bazohet në një sistem disipline progresiv me qëllimin e kufizimit të përdorimit të pezullimit afatgjatë si pasojë e sjelljes së keqe të nxënësit derisa të merren në konsideratë pasoja të tjera, sipas rastit. Administratori do të ushtrojë liri veprimi për të përcaktuar pasojat disiplinore.

Administratori mund të përdorë lirinë e veprimit për të rritur ndëshkimet në rastet e shkeljeve të bëra për të dytën dhe të tretën herë ose për arësye të tjera. Në përcaktimin e ashpërsisë së ndëshkimit ose të pezullimit, administratori i përshtatshëm mund të marrë në konsideratë faktet, ku përfshihen por që nuk kufizohen në: 1) rekordin e mëparshëm disiplinor, 2) ashpërsinë e prishjes së procesit edukativ, 3) shkallën e rrezikut për veten dhe/ose për të tjerët, 4) shkallën në të cilën nxënësi dëshiron të ndryshojë sjelljen e papërshtatshme dhe 5) nëse pasoja alternative janë të përshtatshme për të riangazhuar nxënësin në mësim.

Disiplina e vendosur nga shkolla

Përfshijmë do të thotë largimi i nxënësit nga mjediset e shkollës, nga aktivitetet e rregullta të klasës, dhe aktivitetet shkollore për më shumë se nëntëdhjetë ditë (90) shkolle, pa afat, ose përgjithmonë, të lejuara sipas MGL c. 71, § § 37H ose 37H1/2 për: a) posedimin e një arme të rrezikshme; b) posedimin e një substance të kontrolluar; c) sulm mbi një anëtar të personelit edukativ; ose d) akuzë për krim ose ankesë për shkelje ose krim, nëse drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj përcakton se prezenca e vazhdueshme e nxënësit në shkollë mund të ketë efekte të konsiderueshme të dëmshme në mirëqenien e përgjithshme të shkollës, siç parashikohet në MGL c. 71, § § 37H ose 37H1/2

Pezullim brenda shkollës do të thotë largim i nxënësit nga aktivitetet e rregullta të klasës, por jo nga mjediset e shkollës, për jo më shumë se dhjetë (10) ditë shkolle rresht, ose jo më shumë se dhjetë (10) ditë shkolle kumulative për shkelje të shumta gjatë vitit shkollor. Largim vetëm nga pjesmarrja në aktivitetet jashtëshkollore ose në aktivitetet e sponsorizuara nga shkolla, ose nga të dyja këto, nuk duhet të quhet si largim nga ditët e numuruara të shkollës. Pezullimi brenda shkollës për dhjetë (10) ose më pak ditë rresht ose kumulative gjatë vitit shkollor, nuk duhet të konsiderohet pezullim afatshkurtër sipas këtyre rregullave. Nëse një nxënës është vendosur në një pezullim brenda shkollës për më shumë se dhjetë (10) ditë, rresht ose kumulative gjatë vitit shkollor, një pezullim i tillë duhet të konsiderohet një pezullim afatgjatë për procesin e caktuar, apelimit, dhe qëllimet e raportuara në 603 CMR 53.00.

Pezullim afatshkurtër do të thotë largim i nxënësit nga mjediset e shkollës dhe nga aktivitetet e rregullta të klasës për dhjetë (10) ose më pak ditë shkolle rresht. Largimi vetëm nga pjesmarrja në aktivitetet jashtëshkollore ose në aktivitetet e sponsorizuara nga shkolla, ose nga të dyja këto, nuk duhet të konsiderohet si largim nga ditët e numuruara të shkollës.

Pezullim afatgjatë do të thotë largim i nxënësit nga mjediset e shkollës dhe nga aktivitetet e rregullta të klasës për më shumë se dhjetë (10) ditë shkolle rresht, ose për më shumë se dhjetë (10) ditë shkolle kumulative për shkelje disiplinore të shumta në çdo vit shkollor. Largimi vetëm nga pjesmarrja në aktivitetet jashtëshkollore ose nga aktivitetet e

sponsorizuara nga shkolla, ose nga të dyja, nuk duhet të quhet si largim nga ditët e mumuruara të shkollës. Përveç nxënësve të cilët janë akuzuar me një shkelje siç është e përcaktuar në paragrafët (a) ose (b) të MGL c. 71, § § 37H, ose pjesa 37H ½ e G.L. c. 71, asnjë nxënësi nuk duhet ti jepet një pezullim afatgjatë për një ose më shumë shkelje disiplinore për më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë shkollë në një vit shkollor duke filluar ditën e parë të shkollës me largimin e nxënësit nga shkolla. Asnjë pezullim afatgjatë sipas pjesës MGL 37H ¾ nuk duhet të zgjatë përtej fundit të vitit shkollor në të cilin është dhënë ky pezullim.

Disiplinime të tjera: Zhveshje nga meritat apo dënimet mund të jepen për shkeljet e këtyre rregullave në nivelin e shkollës. Pasoja alternative mund të përdoren sipas rastit, dhe të përfshijnë përdorimin e strategjive të bazuara në evidencë dhe programe si ndërmjetësime, zgjidhje konfliktesh, drejtësi restorative, dhe ndërhyrje për sjellje pozitive dhe përkrahje.

Pjesëmarrja në klubet dhe aktivitetet e Shkollave Publike Worcester dhe ndjekja e aktiviteteve të sponsorizuara dhe të lidhura me shkollën është një privilegj që u është dhënë nxënësve dhe vazhdon të jetë në pozitë të mirë. Kur marrin pjesë në aktivitetet, ngjarjet dhe klubet e shkollës, nxënësit priten të kenë një vijueshmëri të mirë dhe të demonstronjë sjellje dhe qytetari të mirë gjatë shkollës dhe në aktivitetet e sponsorizuara nga shkolla.

E drejta për pjesëmarrjen në aktivitetet, ngjarjet, klubet, ndarjen e çmimeve, bursat dhe pozicionet e nderit në Shkollat Publike të Worcester-it kufizohet për nxënësit që janë aktualisht të regjistruar dhe që ndjekin Shkollat Publike të Worcester-it dhe që janë në pozita të mira. Nxënësit që nuk plotësojnë këto kërkesa mund të përjashtohen nga diskrecioni i Drejtorit ose mëkëmbësit të tij/saj. Nëse një nxënës pezullohet nga një aktivitet jashtëshkollor, sipas vendimit të drejtorit, në të cilin përfshihet shkolla ku nxënësi është i regjistruar, ai nxënës mund të përjashtohet nga ai lloj aktiviteti për pjesën e mbetur të vitit shkollor. Largimi i nxënësit nga aktivitetet jashtëshkollore dhe nga ndjekja e ngjarjeve të sponsorizuara nga shkolla nuk është subjekt i kërkesave procedurale të Ligjit të Massachusetts Kapitulli 37H ¾ (Seanca Dëgjimore e Drejtorit). Largimi nuk është pezullim me qëllim numërimin e ditëve të shkollës gjatë të cilave një nxënës pezullohet. Prindrit/Kujdestarët do të njoftohen kur nxënësi do të largohet ose përjashtohet nga aktivitetet jashtëshkollore.

Disiplina e shkollës nuk duhet të përfshijë të drejtën të shkaktojë ndëshkim fizik përveç rastit kur ajo forcë e arësyeshme mund të përdoret sipas nevojës për të mbrojtur nxënësit e tjerë ose personat e tjerë nga sulmi ose nga kërcënim i pashmangshëm dhe lëndimi trupor.

Zyrtarët e Shkollës mund të kontrollojnë një nxënës dhe dhe ti konfiskojnë pronën me kusht:

- a. Ka baza të arësyeshme për të dyshuar se nga kontrolli do të dalin dëshmi që do tregojnë që nxënësi ka shkelur ose po shkel ligjin ose rregullat e shkollës; dhe
- b. Kontrolli i kryer të jetë i arësyeshëm dhe i lidhur me kuadrin e rrethanave që justifikojnë atë në rradhë të parë.

Sjellja e Pahijshme

Shkllja e secilit prej rregullave tē mēposhtme ēshtē bazē pēr disiplinēn sikurse ēshtē pērcaktuar mē sipēr, dhe ka tē bējē me veprimet si brenda dhe jashtē oborrit tē shkollēs gjatē mēsimit nē shkollē ose situatave tē lidhura me shkollēn.

Rregulli 1. - Dēmtimi ose Shkatērrimi i Pronēs sē Shkollēs

Njē nxēnēs nuk duhet tē vjedhē ose shkaktōjē dēmtime ndaj pronēs sē shkollēs, dhe as nuk do tē bējē pērpjekje tē kryejē njē gjē tē tillē. Administrata ka pēr qēllim tē ngrējē padi penale kundēr çdo nxēnēs i qē shkel kētē rregull dhe do tē kērkōjē çdēmtim.

Rregulli 2. Dēmtimi ose Shkatērrimi i Pronēs Private, Mashtrimi, Falsifikimi, Plagjiatura

Njē nxēnēs nuk duhet tē vjedhē ose shkaktōjē dēme ndaj pronēs private dhe as tē bējē pērpjekje tē kētij lloji gjatē kohēs qē ai ēshtē nē shkollē brenda ose jashtē oborrit tē shkollēs ose nē çdo lloj situatē tē lidhur me shkollēn, por nuk do tē kufizohet nē, vajtje ardhjet nga situata. Nxēnēs i nuk duhet tē mashtrōjē, falsifikōjē ose tē kryejē plagjiaturē pēr asnjē lloj detyre pēr kredite akademike ose dokumentacion.

Rregulli 3. - Sulm Fizik ndaj njē Punonjēs i tē Shkollēs

Njē nxēnēs nuk do tē shkaktōjē ose nuk do tē pērpiket t'i shkaktōjē lēndime fizike njē punonjēs i tē shkollēs brenda apo jashtē oborrit tē shkollēs ose gjatē aktiviteteve shkollore ose aktiviteteve qē kanë tē bējnē me shkollēn, por nuk kufizohen nē futjen dhe largimin nga situata.

Çdo nxēnēs qē sulmon njē punonjēs tē shkollēs ose çdo nxēnēs qē sulmon, drejtorin, mēsuesin, ndihmēs mēsuesin ose personelin tjetēr mēsimsdhēnēs nē territorin e shkollēs ose nē aktivitetet e sponsorizuara apo qē kanë lidhje me shkollēn, pērfshi lojērat atletike, mund tē jetē subjekt i pērjashtimit ose pezullimit afatgjatē nga shkolla dhe nga drejtori i shkollēs.

Rregulli 4. - Sulmet Fizike ndaj njē Nxēnēs i ose njē Personi Tjetēr qē nuk ēshtē i Punēsuar nga Shkolla

Njē nxēnēs nuk do tē shkaktōjē ose nuk do tē pērpiket tē lēndo jē njē nxēnēs tjetēr ose çdo lloj personi tjetēr brenda ose jashtē oborrit tē shkollēs nē çdo lloj situatē qē ka lidhje me shkollēn ku pērfshihet, por nuk kufizohen nē futjen dhe largimin nga situata.

Rregulli 5 – Sulm Verbal ndaj njē Punonjēs i tē Shkollēs

Njē nxēnēs nuk duhet tē sulmojnē verbalisht asnjē punonjēs tē shkollēs brenda apo jashtē oborrit tē shkollēs nē asnjē situatē qē lidhet me shkollēn, duke pērfshirē, por nuk kufizohet nē, futjen dhe largimin nga situata. Sulmet gojore nēnkuptojnē kundērshtimin e hapur, mosbindjen, kryeneçsinē, vrazhdēsinē, paturpēsinē, ngacmimin ose gjuhēn abuzive. Gjuha abuzive pērfshin por nuk kufizohet nē vetēm nē deklarata poshtēruese nē lidhje me racēn, orientimin seksual, ngjyrēn, gjininē, moshēn, besimin fetar, identitetin gjinor, origjinēn kombētare dhe paaftēsitē fizike apo mendore.

Rregulli 5A. - Kërcënimi i punonjësve të shkollës

Një nxënës nuk do të kërcënojë asnjë mësues, administrator ose punonjës tjetër të shkollës ose vullnetar dhe të shkaktojë dëm fizik sa ta vendosë në pozitë atë të kuptojë arësyeshem që forcë do të përdoret për të shkakuar një dëmtim fizik të tillë.

Rregulli 6. - Sulmet me Fjalë ose Kërcënimet ndaj një Nxënësi ose jo-Punonjësi të Shkollës

Një nxënës nuk duhet të sulmojnë verbalisht asnjë person as brenda dhe as jashtë territorit të shkollës në asnjë situatë të lidhur me shkollën, ku përfshihet por që nuk kufizohet vetëm në futjen dhe largimin nga situata. Sulmet verbale nënkuptojnë mosbindjen, paturpësinë, vrazhdësinë, pafytyrësinë, ngacmimin, ose gjuhën abuzive. Gjuha abuzive përfshin por nuk do të kufizohet vetëm në deklarata poshtëruese në lidhje me racën, orientimin seksual, ngjyrën, gjininë, moshën, besimin fetar, identitetin gjinor, origjinën kombëtare dhe paafhtësitë fizike apo mendore.

Rregulli 6A. - Sulmi ose Kërcënimi me Shkrim ndaj një Nxënësi ose jo-Punonjësi të Shkollës

Një nxënës nuk duhet të kërcënojë, frikësojë ose ngacmojë me shkrim asnjë person as brenda as jashtë territorit të shkollës në asnjë situatë që ka të bëjë me shkollën, ku përfshihet por që nuk kufizohet vetëm në futjen dhe largimin nga situata. Kërcënimet me shkrim quhen çdo mesazhet ku përfshihen emaillet, sms-të ose çdo lloj komunikimi cyber; p.sh. dhomat e bisedave.

Rregulli 7. - Politika mbi Posedimin dhe Përdorimin e Armëve

Nëse çdo lloj pajisje e cila mund të konsiderohet si armë sipas kësaj politike shpërndahet nga një mësues, për përdorim në klasë, atëherë asnjë nxënës që merr një pajisje të tillë nuk do të akuzohet për shkelje të Rregullit 7 nëse pajisja mbetet në klasë dhe nëse pajisja përdoret vetëm për qëllime mësimi.

Nxënësi nuk duhet të posedojë, përdorë, ose përpiqet të përdorë, asnjë armë në territorin e shkollës ose në situata që lidhen me shkollën, përfshi futjen dhe largimin nga situata.

Në mënyrë që të mbrohen nxënësit e Shkollave Publike Worcester, çdo nxënës që gjendet në territorin e shkollës ose në aktivitetet e sponsorizuara nga shkolla apo që lidhen me shkollën, përfshi lojërat atletike, dhe që posedon një armë të rrezikshme, ku përfshihet por që nuk kufizohet në një pistoletë, mund të jetë subjekt i përjashtimi ose pezullimi afatgjatë nga shkolla nga drejtori pavarësisht nga madhësia e thikës.

Për qëllime të kësaj politike, një "armë" e rrezikshme përfshin por nuk kufizohet në një pistoletë (përfshi një B.B., me saçe apo pajisje të replikuara), thikë, llastiqe, pipëz, shkop polici, doreza hekuri duke përfshirë një unazë me qëllim që të vihet në më shumë se një gisht ("unaza të bashkuara") ose doreza hekuri ose çdo lloj substance e cila mund të jetë për të njëjtin përdorim ose efekt të ngjashëm me atë të dorezave metalike, nunçaku, të quajtura "klacker-a" ose shkopa kung fu, ose armë të ngjashme që përbëhen nga dy shkopa druri, plastikë apo metali të bashkëlidhura në një cep nga një litar i gjatë, zinxhir ose lëkurë, një

shuriken ose objektet të ngjashme me maja në formën e yllit që kanë si qëllim lëndimin e një personi kur hidhen, ose fasha krahu, të bëra nga lëkurë që ka kunja metalike, pjesëza, koka metalike të mprehta ose materiale të ngjashme që janë ponderuar me metal ose me substanca të tjera dhe mbahen në dorë, ose një manrikigusari (lloj zinxhiri) ose një zinxhir i madhësisë së njëjtë që ka rëndesë në dy cepat. Çdo lloj pajisje ose objekti tjetër i përdorur në përpjekje që të përdoret për të shkaktuar dëmtim trupor ndaj një person mund të konsiderohet armë.

Kjo politikë do të zbatohet në përputhje me dispozitat e procesit të përcaktuar nga Kodi i Disiplinës së Shkollave Publike Worcester, dhe do të zbatohet për të gjithë nxënësit që ndjekin Arsimin e Rregullt ose të Posaçëm.

Rregulli 8. - Politika mbi Posedimin dhe Përdorimin e Drogës ose Alkoolit

- a) Çdo nxënës i cili shpërndan ose posedon, me qëllim shpërndarjen, çdo lloj substance të kontrolluar siç përcaktohet në Kapitullin 94C të Ligjit të Përgjithshëm të Massachusetts-it, ku përfshihet, por nuk kufizohet në mariuanë, kokainë, ose heroinë në territorin e shkollës ose në aktivitetet e sponsorizuara nga shkolla, mund të përjashtohet ose të marrë një pezullim afatgjatë nga Shkollat Publike të Worcester-it dhe nga drejtori i shkollës. Kjo vlen edhe për veglat e drogës siç janë peshoret, mullinjët, çibukët, pajisjet elektronike të pirjes së duhanit si dhe çdo ose të gjithë instrumentat që përdoren për produktet e drogës.
- b) Çdo nxënës i cili përdor ose posedon çdo lloj substance të kontrolluar siç përcaktohet në Kapitullin 94C të Ligjit të Përgjithshëm të Massachusetts-it, ku përfshihet por nuk kufizohet në mariuanë, kokainë, ose heroinë, ose është nën influencën e substancave të tilla në territorin e shkollës ose në aktivitetet e sponsorizuara nga shkolla mund të jetë subjekt i përjashtimit ose pezullimit afatgjatë nga shkolla nga drejtori i shkollës.
- c) Posedimi ose përdorimi i alkoolit në territorin e Shkollave Publike të Worcester-it është e ndaluar. Çdo nxënës i cili përdor ose posedon alkool në territorin e shkollës, ose në aktivitetet e organizuara nga shkolla, ose është nën influencën e alkoolit në territorin e shkollës, ose në një situatë të sponsorizuar nga shkolla, mund të përjashtohet ose të marrë një pezullim afatgjatë që jepet nga Shkollat Publike Worcester.
- d) Kjo politikë do të zbatohet sipas dispozitave të procesit të përcaktuar të Kodit të Disiplinës së Shkollave Publike Worcester të zbatueshëm ndaj nxënësve që ndjekin Arsimin e Rregullt dhe të Posaçëm. Çdo nxënës që akuzohet për shkelje të Rregullit 8 do të ketë të drejtat e procesit të caktuar të përcaktuara në Nenin III të Procesit të Caktuar.
- e) Posedimi ose përdorimi i drogës apo substancave të kontrolluara të cilat janë lëshuar me recetë nga doktori nuk është shkelje e kësaj Politike (Megjithatë, të gjitha barnat e dhëna nga doktori do t'i jepen nxënësit nga personel i autorizuar dhe do të mbahen në një vend të sigurt).

Rregulli 9- Vonesa të Shumta

Një nxënës nuk duhet që të jetë vonë për në shkollë ose klasë pa një shkak të ligjshëm.

Rregulli 10. - Shkeljet e Përsëritura në Shkollë

Një nxënës nuk duhet që në mënyrë të përsëritur të mos ndjekë udhëzimet dhe kërkesat e arsyeshme të çdo personeli të autorizuar të shkollës gjatë çdo periudhe të kohës që ai/ajo është nën mbikqyrjen e shkollës.

Rregulli 11. - Dhuna e Qëllimshme Fizike dhe Mendore (Kap. 536 - Ligji i 1986)

Një nxënës nuk do të organizojë ose marrë pjesë në dhunë të qëllimshme fizike e mendore. Një nxënës që ka dijeni për çdo lloj aktiviteti të dhunës që qëllimshme fizike e mendore duhet ta raportojë incidentin tek administratori i shkollës.

Rregulli 12. - Rënia e Alarmeve të Rremë

Një nxënës nuk duhet, pa një shkak të arsyeshëm, të protestojë me britma, tu bjerë zileve, ose ndryshe të shkaktojë alarm të rremë zjarri, (Veprime të tilla duhet të raportohen në Nenin 13, Kapitullin 269 të Ligjit të Përgjithshëm të Massachusetts). Asnjë nxënës nuk duhet t'i vërë zjarrin një ndërtesë të shkollës ose një vendi që sponsorizohet nga shkolla apo një aktiviteti.

Rregulli 13. - Pirja e Produkteve të Duhanit

Pirja e duhanit, posedimi, përdorimi, ose shpërndarja e duhanit ose produkteve të duhanit brenda ndërtesave, mjediseve, territorit, autobusëve të shkollës ose në një aktivitet të sponsorizuar nga shkolla nga çdo lloj personi është e ndaluar. Çdo nxënës i cili shkel këtë rregull mund të pezullohet.

Rregulli 14. - Telefonat Celularë, Pajisjet Elektronike, dhe Pajisjet me Lazer

Gjatë qëndrimit në shkollë ose një aktivitet të sponsorizuar nga shkolla, një nxënës nuk duhet që të, pa pasur pëlqimin nga personeli i duhur i shkollës, përdorë celularin, telefonin e mençur (smartphone), tabletën, kamerën ose çdo lloj tjetër pajisjeje elektronike e cila potencialisht mund të pengojë një aktivitet shkollor ose mund ti heqë vëmendjen studentëve. Pajisjet elektronike duhet të përfshijnë çdo telefon celular, telefon të mençur, tabletë, ose çdo gjë që furnizohet me elektricitet dhe që është e përshtatshme për të komunikuar një mesazh me gojë, zë, audio ose mesazhe me tekst ose për postim ose për regjistim ose për të komunikuar çdo audio, zë, fotografi, imazh ose video. Nxënësve nuk u lejohet që ti kenë telefonat e tyre celularë ose pajisjet elektronike të hapura gjatë kohës që ata/ato janë në shkollë.

Përdorimi i këtyre pajisjeve në kundërshtim me këtë rregull mund të rezultojë në masë disiplinore përfshirë, por jo limituar në, pezullim jashtë-shkolle. Administrata e Shkollës ka të drejtën që të konfiskojë telefonat celularë ose pajisjet e tjera elektronike kur një nxënës mendohet se po e shkel këtë rregull.

Një nxënës nuk duhet të posedojë asnjë lloj pajisjeje me lazer në mjediset e shkollës ose në aktivitetet e sponsorizuara nga shkolla, përveç rasteve kur pajisje të tilla janë shpërndarë nga një mësues ose përdorimi i tyre është autorizuar nga një mësues në lidhje me detyrat shkollore. Përdorimi i pajisjeve me lazer kundrejt fytyrës, syve, ose kokës të një personi tjetër mund të konsiderohet si armë për qëllime disiplinimi përfshirë, poqë jo limituar në, mundësinë e një përjashtimi afat-gjatë.

Përforsimi dhe Ndërshkimi

Ky rregull për telefonin celular mund të përfocohet nga drejtori, çdo mësues (përfshirë zëvendësuesit), nga çdo zyrtar i shkollës ose çdo person tjetër i caktuar nga drejtori.

Personeli i përforsimit ka të drejtën që të konfiskojë çdo celular ose pajisje elektronike që ndodhet në zotërim ose përdoret në kondërshtim me kodin e sjelljes.

Ndërshkimet për nxënësit që shkelin këtë rregull do të jenë si më poshtë:

- Shkelja e parë: Telefoni celular/pajisja elektronike do të konfiskohet dhe do të kthehet nxënësit në përfundim të asaj dite shkollore.
- Shkelja e dytë dhe ato në vazhdim: Telefoni celular/pajisja elektronike do të konfiskohet dhe do të kthehet vetëm prindërve ose kujdestarëve të . Cdo prind ose kujdestar brenda pesë ditësh nga ky konfiskim, mund të kërkojë një takim për të përcaktuar vlefshmërinë e shkeljes së kodit të sjelljes që rezultoi në konfiskimin e celularit/pajisjes elektronike. Në një rast të tillë drejtori duhet që të caktojë një zyrtar për takimin që duhet: 1) Ti japë mundësinë nxënësit dhe/ose prindit /kujdestarit të tij/saj që të paraqesin anën e tyre të ngjarjes; 2) të dëgjojë ose rishikojë raportin e incidentit nga zyrtari përforsues di dhe nga çdo person tjetër që ka informacion në lidhje me ngjarjen; 3) Ti ofrojë një rekomandim drejtorit nëse ka një bazë të arsyeshme për të arritur në përfundimin se rregulli i celularit në kodin e sjelljes është shkelur nga nxënësi. Pavarësisht nga kërkesa për takim, çdo telefon celular/pajisje elektronike duhet që ti kthehet prindit/kujdestarit në mundësinë e parë, dhe nuk duhet që të jetë në varësi të programimit ose rezultatit të rakimit.
- Nxënësit që kryejnë shkelje të përsëritura të këtij rregulli, mund të jenë subjekt i veprimeve të tjera disiplinore, që janë në përputhje me Kodin e Sjelljes së Shkollave Publike të Worcester, deri në ose përfshirë pezullimin nga shkolla.

Rregulli 15. – Rregulli mbi Bandat dhe Veshjet e Pahijshme

- a) Asnjë nxënës në pronat e shkollës ose në aktivitetet e sponsorizuara nga shkolla nuk do të veshë roba ose artikuj (përfshi kapelet, shiritat, shallet dhe fashat e djersitjes), bizhuteri, emblema, stema, simbole apo shenja të cila përmbajnë fjalë, ose dizeno që konsiderohen të pahijshme, të turpshme, ose vulgare nga Administrata e Shkollës.

- b) Asnjë nxënës në pronat e shkollës ose në asnjë nga aktivitetet e organizuara nga shkolla nuk do të veshë asnjë veshje ose artikull (përfshi kapelet), bizhuteritë, emblemat, stemat, simbolet apo shenjat, të cilat shfaqin, evidenca ose reklama të pijeve alkoolike, produkteve të duhanit, drogave të jashtëligjshme, ose substancave të tjera të kontrolluara të jashtëligjshme sipas ligjit të Massachusetts-it.
- c. Asnjë nxënës nuk do të veshë në pronat e shkollës ose në aktivitetet e sponsorizuara nga shkolla veshje ose artikuj (përfshi kapele), bizhuteri, emblema, stema, simbole ose shenja të cilat Administrata e Shkollës në mënyrë të arsyeshme i konsideron si evidenca të anëtarësisë ose të bashkëpunimit në një bandë. Sikurse është e përcaktuar në këtë politikë "banda" është çdo lloj grupi prej dy apo më shumë persona të lidhur së bashku, zyrtarisht ose jozyrtarisht, qëllimet e të cilëve përfshijnë kryerjen e akteve të paligjshme ose bashkëpunojnë në kryerje e veprimeve të paligjshme.

Rregulli 16. - Nxënësit e Akuzuar ose të Dënuar për Krime

Në përputhje me Kapitullin 71 (§37 H ½) të Ligjeve të Përgjithshme të Massachusetts, drejtorët kanë autoritetin të pezullojnë nxënësit e akuzuar për krime e t'i përjashtojnë ose të vendosin pezullim afatgjatë nxënësve të dënuar apo të gjykuar për shkak se kanë kryer një krim nëse drejtori përcakton se prezenca e vazhdueshme e nxënësit mund të ketë efekt të dëmshëm në mbarëvajtjen e përgjithshme të shkollës.

Çdo nxënës që akuzohet për shkelje të Rregullit 3, 7, 8 dhe 18 duhet të ketë të drejtat e paraqitura në Procesin e caktuar të Nenit III.

Rregulli 17. - Prishja e Rregulli të Shkollës

- a) Përveç pajtimit me Rregullat 1 deri 18 të përcaktuara më lart, çdo nxënës nuk do të përdorë violencë, forcë, kërcënime, frikë, rezistencë pasive ose çdo lloj sjelljeje tjetër në mënyrë që të shkaktojë prishje ose vështirësi të çdo misioni, procesi ose funksioni të ligjshëm në shkollë.
- b) Nxënësit nuk lejohen në zonat e ndërtesave/territoreve të shkollës pa mbikëqyrjen e një personi të personelit të Shkollave Publike të Worcester-it para, gjatë dhe pas orarit normal të shkollës. Nxënësit nuk lejohen të hynë në ndërtesat/territoret e shkollës deri 30 minuta para fillimit zyrtar të ditës së shkollës ose kur personeli i Shkollave Publike të Worcester-it nuk është në dispozicion për mbikëqyrje.

Rregulli 18. - Kërcënimet me Bomba

Asnjë nxënës nuk duhet të komunikojë ose të shkaktojë komunikimin e asnjë lloj informacioni në asnjë lloj forme të çfarë do lloji, se një bombë ose çdo lloj tipi pjijsje eksplozive është vendosur brenda ose pranë ndonjë ndërtese ose prone që është nën kontrollin e Shkollave Publike Worcester ose është në aktivitetet e sponsorizuara nga shkolla, përfshi por jo të kufizuara në transportin e ofruar nga Shkollat Publike Worcester drejtpërsëdrejt, ose nga shërbimet e kontraktuara.

Rregulli 19. - Aktivitetet Jashtëshkollore

Një nxënës mund të përjashtohet nga aktivitetet jashtëshkollore kur sjellja e tij/e saj ka efekt të dëmshëm mbi sigurinë e nxënësve ose personave të tjerë ose pronës ose kur sjellja e tij/e saj ka pasojë të dëmshme mbi reputacionin e Shkollave Publike Worcester.

Shkollat Publike Worcester janë të vetëdijshme se siguria dhe mirëqenia e çdo nxënësi individual dhe ekepeve është prioritet. Për këtë arsye, nxënësit nuk do të angazhohen në asnjë aktivitet kriminal të tillë si, por jo të kufizuar vetëm në, vandalizëm, sulm fizik dhe rrahje, sjellje të pahijshme seksuale, dhunë të qëllimshme fizike dhe mendore, plagjiature, vjedhje ose sjellje të tjera të dëmshme.

Nxënësit pritet të sillen në mënyrë të përshtatshme gjatë të gjitha aktiviteteve që lidhen me shkollën. Aktet dëmtuese që ndalohen me anë të këtij dokumenti, përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në mosbindjen, zënie, përqeshjet, qëndrimet negative, sjelljen jospportive, gënjim, gjuhën ose gjestet e papërshtatshme dhe të gjitha shkeljet dhe mosbindjet ndaj këtyre rregullave të vendosura në Manualin e Politikave të Shkollave Publike Worcester dhe manualet e shkollave.

Rregulli 20. – Zënkat

Një nxënës nuk duhet të angazhohet në grindje fizike me një nxënës tjetër brenda ose jashtë territorit të shkollës në asnjë situatë të lidhur me shkollën ku përfshihet por nuk kufizohet në futjen në dhe largimin nga situata.

Rregulli 21. – Nxitja e Rrëmujës

Një nxënës nuk duhet të nxisë një rrëmujë brenda ose jashtë territorit të shkollës në asnjë aktivitet të lidhur me shkollën. Një nxënës nuk duhet të organizojë, inkurajojë, ose të marrë pjesë në asnjë prishje të rregullit të shkollës. Kjo vlen për atë që kërkon të nxisë të tjerët të prishë parametrat e shkollës ose të aktivitetit të lidhur me ta

Rregulli 22. – Largimi nga Shkolla pa Leje

Një nxënës nuk duhet të largohet nga territori i shkollës ose aktivitetet e lidhura me shkollën pa lejen e administratorit të shkollës.

Rregulli 23. – Laboratori dhe Siguria në Punishte

Një nxënës duhet të veprojë në përputhje me të gjitha standartet e sigurisë në një laborator ose në punishte. Nxënësit pritet të sillen në mënyrë të përshtatshme në këto vende pa shkaktuar situatë të pasigurtë e cila mund të shkaktojë dëm për veten e tyre dhe për të tjerët.

Ngacmimet

Shkollat Publike te Worcester-it ndalojnë veprimet e paligjshme ose shqetësuese, duke përfshirë çdo formë ngacmimi, ngacmime nepremjet internetit, ose hakmarrje ne ndërtesat e Shkollave Publike të Worcester-it, në teritoret e shkollës, si dhe ne aktivitetet e sponsorizuara te shkollës ose te tjera aktivitete te lidhura me shkollën. Ngacmimet, siç janë

përshkruar në M.G.L. c.71,§370, janë veprim i përsëritur nga një ose më shumë nxënës ose personel të bëra me shkrim, me gojë, me menyra electronike, akte fizike, gjeste ose kombinim i tyre që perdoret nga nje ose me shume nxenes drejtuar nje individi tjetër i cili:

- a. shkakton dhimbje fizike dhe emocionale për viktimen ose dëmtuar të sendeve të viktimes;
- b. e ve viktimën në një gjendje frike për të dëmtuar veten ose sendet e veta;
- c. shkakton një ambient armiqësor në shkollë për viktimen;
- d. shkel të drejtat e viktimes në shkollë; ose
- e. materialisht ose në menyre indirekte rrregullon mesazhin ose zhvillimin e zakonshëm të programit shkollor. Ngacmimi duhet të përfshijë edhe ngacmimin nga interneti

Shkollat Publike të Worcester-it janë të vetëdijshme që disa nxënës mund të jenë të prekshëm dhe të kthehen në objektivi i ngacmimit dhe shqetësimit bazuar në karakteristikat e diferencuara aktuale apo të perceptuara, duke përfshirë “racën, ngjyrën, origjinën, origjinën kombëtare, seksin, statusin socio-ekonomik, statusin e të pastrehut, statusin akademik, identitetin gjinor ose shprehinë gjinore, paraqitjen fizike, shtatzaninë apo statusin prindëror, orientimin seksual, mendor, fizik, paaftësinë zhvillimore ose shqisore që lidhen me një person që ka ose perceptohet të ketë 1 ose më shumë nga këto karakteristika.’ Të drejtat civile të të gjithë anëtarëve të komunitetit të shkollës janë të garantuara nga ligji. Mbrojtja e të gjitha këtyre të drejtave është me rëndësi të madhe dhe prioriteti i distriktit të shkollës. Shkollat Publike të Worcester-it gjithashtu ndalojnë ngacmimet e anëtarëve të komunitetit të shkollës për arsye të palidhura me racën, ngjyrën, besimin fetar, origjinën kombëtare, kombësinë, seksin, orientimin seksual, identitetin gjinor, moshën ose paaftësinë

Ngacmimi nepermjet internetit (cyber-bullying) nëpërmjet përdorimit të teknologjisë ose pajisjeve elektronike, si për shembull telefonit, celularit, kompjuterit, dhe Internetit. Përfshin, por nuk kufizohet në, email-in, mesazhet elektronike, mesazhet me tekst, dhe njoftimet në Internet. Hakmarja është çdo formë kërcenimi, reprezalie ose ngacmimi direkt kundrejt një nxënësi që denoncon ngacmimet, jep informacion gjatë një investigimi të një ngacmimi, ose është dëshmitar ose ka informacione të besueshme kundrejt një ngacmimi.

Shkollat Publike Worcester deklarojnë që shkollat e tyre kanë miratuar Planin e Nderhyrjes për të Parandaluar Ngacmimet. Gjithashtu, është vënë në shërbim Një Linjë Anonime për Raportimin e Ngacmimeve me numrin (508)799-3472 I gjithë plani mund të shikohet në faqen e internet: <http://preventbullying.worcesterschools.org>

Në përputhje me kërkesat SB 2404, Nje Akt në Lidhje me Ngacmimet (Neni 1, K. 71, 37 O) në Shkollë, të gjithë nxënësit do të kryejnë aktivitete parandaluese, të cilat janë percaktuar për të krijuar dhe mbajtur siguri, ambient të disiplinuar dhe pa droge, ku përfshihet dhe parandalimi i ngacmimeve.

Bazuar në informacionin e raportuar tek administratori i shkollës, administratori do të investigojë të gjitha raportet dhe ankesat per ngacmime, ngacmime nga interneti, hakmarrjet dhe do të marrë masa të menjehershme të ndalë sjelljet ngacmuese dhe të rivendosë tek viktimat ndjenjën e sigurisë dhe do të angazhojë stafin mbështetës për të përcaktuar hapat e metejshme, ku mund të përfshihen, midis të tjerash, masa disiplinore, një strategji për të siguruar konsultim ose referim tek shërbimet e përshtatshme për autorët dhe viktimat, për anetarët e caktuar të familjes të nxënësit në fjalë. Autori i veprimit mund të paditet.

Aktet e ngacmimit mund të çojnë në një kombinim të akuzave ligjore të mëposhtme:

- Agresion (GL c. 265, § 13A). Akti ose veprimi i një kërcënimi ose përpjekje të paligjshme për të lënduar të tjerët.
- Agresion & Rrahje (GL c. 265, § 13A). Një sulm ndaj një viktime i cili kryhet duke goditur viktimën duke e rrëzuar viktimën poshtë ose duke e nënshtruar viktimën ndaj dhunës.
- Ngacmime Kriminale (GL c. 265, § 43A). Cilido që me dëshirë dhe keqdashje angazhohet në veprime të njohura më parë ose një sërë aktesh në një periudhë kohë të drejtuar ndaj personit specifik, i cili alarmon seriozisht atë person dhe do të shkaktojë një personi të arsyeshem të vuajë stres emocional të konsiderueshem.
- Telefonata ngacmuese/të bezdisshme. (GL c. 269, § 43A). Cilido që telefonon persona të tjerë, ose bën që të telefonohet një person, në mënyrë të vazhdueshme, për qëllimin e vetëm që të ngacmojë, shqetësojë ose ngasë një person ose familjen e tij, si atëherë kur bëhet biseda ashtu edhe atëherë kur nuk bëhen, ose ai që telefonon një person vazhdimisht dhe përdor gjuhë të pahijshme dhe të turpshme ndaj personit.
- Kërcënimet (GL c. 275, § 4) (GL c. 209A, § 7). Shprehja e qëllimit dhe e mundësisë në rrethana që justifikojnë frikën nga pala tjetër.
- Prishja e Asamblesë së Shkollës (GL c. 272, § 40). Cilido që me dëshirë ndërpret ose prish asamblenë e shkollës apo asamblenë e njerëzve të tjerë të mbledhur për qëllime të ligjshme.
- Shkelja e të drejtave civile (GL c. 265, §§ 37, 38). Asnjë person, as kur është punonjës i ligjit, nuk duhet që me forcë ose me kërcënimin për forcë, të lëndojë me dëshirë, frikësorë ose ndërhyjë, ose të përpiqet të ndërhyrje, frikësorë ose të ndërhyjë ose të shtypë ose të kërcënojë asnjë person tjetër në ushtrimin ose gëzimin e të drejtave ose privilegjeve të siguruar nga ligji konstitucional i Commonwealth ose nga ligji konstitucional ose ligji i Shteteve të Bashkuara.
- Prishja me keqdashje e pronës (GL c. 266, § 127). Cilido që shkatërron ose dëmton pronën personale, banesat ose ndërtesën e dikujt tjetër.

Atletët dhe Pjesëmarrësit në Aktivitetet e Shkollës

Të përgjithshme

Atletët dhe pjesëmarrësit në aktivitete që kanë të bëjnë me shkollën do të udhëhiqen nga ligji vendor dhe shtetëror, rregullorja e MIAA-së dhe Manuali i Politikave të Shkollave

Publike Worcester, dhe rregullat e përfshira në Kodin e Sjelljes së Shkollave Publike Worcester për atletët dhe pjesëmarrësit në aktivitete që kanë të bëjnë me shkollën.

Kërkesat akademike

1. Nxënësi duhet të sigurojë gjatë periudhës së fundit të notave përpara provimit, (p.sh. rezultatet e tremujorit të dytë, përcaktojnë pranimin në tremujorin e tretë) një notë 65 ose më të lartë në katër klasa kryesore tradicionale vjetore. Përveç kësaj, nota mesatare e përgjithshme e të gjitha klasave vjetore duhet të jetë C ose më e lartë.
2. Nxënësi nuk mundet në asnjë lloj mënyre të përfaqësojë shkollën nëse nuk ka kryer kurse që do të jenë ekuivalente me katër klasa tradicionale kryesore vjetore.
3. Për tu kualifikuar për periudhën e rezultateve të vjeshtës, nxënësve u kërkohet të kenë kaluar katër klasa vjetore me një notë 65 ose më lart. Përveç kësaj, mesatarja e përgjithshme e të gjitha klasave vjetore duhet të jetë C ose më e lartë. Nxënësve të klasës së 10, 11, ose 12 mund tu falet vetëm një herë gjatë gjithë viteve të shkollës së mesme. Falja do të jepet nëse nxënësi nuk plotëson mesataren C (minimumi 70) në të gjitha klasat vjetore për vitin akademik të mëparshëm. Nxënësit që hyjnë në klasën e 9-të përjashtohen nga këto kërkesa akademike vetëm për tremujorin e parë.
4. Përshtatshmëria akademike e të gjithë nxënësve duhet të konsiderohet si zyrtare dhe e perfunduar në ditën e publikimit, kur kartat e raporteve për atë periudhë gradimi do t'i jepen prindërve/kujdestarëve të të gjithë nxënësve.
5. Nota të paperfunduara mund të mos llogariten ndaj përshtatshmërisë.
6. Nxënësi i cili përsërit punë mbi të cilat ai/ai ajo ka marrë një herë kredite nuk mund ta numërojë për herë të dytë atë lëndë për përshtatshmëri.
7. Nxënësi nuk mund të numërojë për efekt përshtatshmërie asnjë lëndë të bërë gjatë verës, përveç rasteve kur lënda është ndjekur më parë dhe ka ngelur.

Frenkuetimi i Shkollës

1. Një nxënës që mungon në shkollë nuk do të marrë pjesë në asnjë aktivitet që ka të bëjë me shkollën. Kjo perfshin pezullim ne-shtepi.
2. Nxënësi duhet të jetë në shkollë për të paktën tre (3) orë që të ketë mundësinë të marrë pjesë në çdo aktivitet që ka të bëjë me shkollën.
3. Çdo nxënës me pesë (5) ose më shumë mungesa të paarsyeshme do të përjashtohet nga klubi ose skuadra për pjesën e mbetur të sezonit sportiv. Një nxënës me dhjetë (10) ose më shumë mungesa të paarsyeshme nuk do të jetë i përshtatshëm për asnjë klub ose skuadër për pjesën e mbetur të vitit akademik.

Dëmtimet në Kokë ose Humbja e Ndjenjave në Aktivitetet Jashtë shkollore

Ne Perputhje me kaputillin 166 te Aktit te vitit 2010, nje Akt ky qe eshte ne lidhje me Rregulloren e shkolles per Programet Atletike

1. Perpara cdo aktiviteti jashte shkollor cdo student qe merr pjese do te plotesoj dhe tia japi trajnerit ose drejtorit te atletikes, formen e lejes te firmosur nga nxenesi dhe

prinderi duke cilesuar ndonje histori ne humbjes se ndjenjave, demtime te shpines, ose fytyres dhe ndonje histori demtimi te koheve te fundit.

2. Cdo nxense qe gjate lojes peson vrasje te kokes, humb ndjenjat ose ka shenja te humbjes se ndjenjave duhet te iqet nga loja menjeher dhe nuk mund te kthehet ne loje po ate dite.
3. Nxenësi nuk mund te kthehet derisa te paraqisi autorisim nga doctori sipas 105 CMR 201.011.

Të gjitha dëmtimet në kokë duhet të raportohen tek zyra administrative e infermjerisë, duke përfshirë ato që ndodhin jashtë shkollës para fillimit të sezonit sportiv ose aktivitetit fizik. Prindërit duhet gjithashtu të plotësojnë në pjesën përkatëse të **Formularint të Lejës për Pjesëmarrje në Aktivitete Atletike Jashtëshkollore**, historinë e dëmtimit në kokë.

Informacione te tjera ne lidhje me formen "*letter nga doktori per tu kthyer pas nje demtimi te kokes gjate nje loje sportive*" dhe "*form autorizimi*" mund ti gjeni ne faqen elektronite www.worcesterschools.org

Shëndeti Kimik Rregulli 62 9 MIAA-s

Që nga data më e hershme e stërvitjes, deri në fund të vitit akademik ose aktivitetit të fundit atletik (cilado është më e fundit), nxënësi pavarësisht nga sasia nuk do të përdorë, konsumojë, zotërojë, blejë/shesë, ose japë asnjë pije që përmban alkool; produkte duhani, e-cigarettes, marihuanë, steroide; ose asnjë substancë të kontrolluar. kjo politikë përfshin produkte të tilla si "birra jo alkoolike dhe pothuajse si birra". Nuk konsiderohet shkelje zotërimi nga nxënësi i një droge të përcaktuar ligjërisht si e tillë dhënë nxënësit për përdorim vetjak nga doktori i tij/i saj.

Nëse një nxënësi i cili shkel këtë rregull nuk është në gjendje, në kohën përkatëse, të marrë pjesë në sporte ndër-shkollore për shkak të lëndimeve ose rezultateve akademike, çdo gjobitje e vendosur do të hyjë në fuqi vetëm kur nxënësi është në gjendje të marrë pjesë përsëri.

Shiko Librin Blu MIAA për gjobat.

Sjellja e Hijshme

Shkollat Publike Worcester janë të vetëdijshme se siguria dhe mirëqenia e nxënësve individualë dhe skuadrave është një prioritet. Për këtë arsye, nxënësit nuk do të kryejnë asnjë aktivitet kriminal të tillë si, por jo të kufizuar vetëm në, vandalizëm, goditje fizike dhe rrahje, sjellje të keqe seksuale, dhunë të qëllimshme fizike dhe mendore, plagjiature, vjedhje ose sjellje të tjera të dëmshme.

Nxënësit duhet të sillen siç duhet gjatë gjithë aktiviteteve që kanë të bëjnë me shkollën. Veprimet dëmtuese të ndaluara, përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në mosbindjen, zënie, përqeshjet, sjelljet negative, sjelljet që nuk i takojnë një sportisti, gënjimin, gjuhës ose gjesteve të papërshtatshme dhe të gjitha shkeljet dhe mosbindjet ndaj këtyre rregullave të vendosura në Manualin e Politikave të Shkollave Publike Worcester dhe manualet e shkollave.

Duke patur parasysh nivelin e ndryshem të ashpersise, tipit të sjelljes së keqe dhe të kaluarën e sjelljes së nxënësit, çdo situatë do të shqyrtohet në baza individuale. Drejtori që punon me trajnerin/këshilltarin do të përcaktojë pasojat e përshtatshme, të cilat mund të përfshijnë ndalimin e pjesëmarrjes ose largimin nga skuadra/aktiviteti. Në të gjitha rastet nxënësi do të ketë të drejtën të kalojë në procesin e përcaktuar (Procesi i Përcaktuar, faqja 5).

Kuptohet që edhe spektatorët, përfshi prindërit/kujdestarët e të gjithë atletëve/nxënësve të Shkollave Publike Worcester, duhet të sillen siç duhet në të gjitha aktivitetet/konkurrimet atletike, si në vendin e tyre ashtu dhe në vende të tjera. Prindërit/kujdestarët nuk duhet të përqeshin ose të sillen keq ndaj tifozëve të tjerë, zyrtarëve, trajnerëve ose lojtarëve. Sjellja e padenjë mund të çojë në përjashtimin nga aktiviteti.

Akuzat për Krime/Dënimet

1. Çdo nxënës i akuzuar për krime nuk do të ketë të drejtën të marrë pjesë në asnjë aktivitet që ka të bëjë me shkollën deri sa çështja të jetë gjykuar dhe akuza të jetë hedhur poshtë ose të jetë reduktuar në statusin jo-kriminal.
2. Çdo nxënës i dënuar për një krim dhe/ose i përjashtuar ose të cilit i është dhënë një pezullim afatgjatë, nuk do të mund të marrë pjesë në asnjë aktivitet që ka të bëjë me shkollën, gjate kohes së përjashtimit ose pezullimit afatgjatë.

Plani i Menaxhimit të Ekipit

Në takimin para sezonit me Drejtorin e Atletikës, secili trajner do të paraqesë një plan menaxhimi i cili do të parashtrijë rregullat dhe rezultatet e priturshme për sezonin e ardhëm i cili është miratuar nga drejtori. Ky plan do të shpërndahet tek të gjithë kandidatët për skuadrën.

Disiplinimi i Nxënësve sipas Pjesës 504 të ADA-s

Në përputhje me disa nga ligjet federale dhe ligjet e shtetit, nuk mund të diskriminohet ndaj nxënësve me paaftësi mendore e fizike për çështjet e disiplinimit për shkak të paaftësisë apo problemeve të tyre. Përveç të drejtave të paraqitura në Manualin e Politikave të Shkollave Publike të Worcester-it, procedurat e mëposhtme do të zbatohen në pajtim me ligjet dhe rregulloret shtetërore dhe federale për nxënësit me paftësi fizike e mendore. Procedurat për nxënësit që kanë të drejtën të marrin shërbime të posaçëm për edukim edhe/ose akomodime nën planin 504 janë paraqitur nën pjesën "Disiplinimi i nxënësve me nevoja të posaçme" të këtij manuali.

1. Përcaktimi

Një nxënës me paftësi fizike e mendore është një nxënës i cili ka ose ka patur ose mendohet të ketë një problem fizik ose mendor i cili e kufizon praktikisht në një ose disa nga aktivitetet kryesore të jetës. Kjo kategori përfshin nxënësit të cilët janë konkluduar ta kenë këtë problem aktualisht, kanë patur një historik të këtij problemi, ose të cilët mendohet se kanë një problem të tillë

2. Procedura

Në rast se një nxënës ka shkelur rregullat e shkollës pas zbatimit të procedurave të procesit të caktuar (njoftimit dhe seancës dëgjimore) të përcaktuara në këtë manual ose në politikat e tjera të shkollës, drejtori ose mëkëmbësi i tij/i saj do të vendosi, nëse nxënësi është identifikuar si nxënës me paaftësi fizike ose mendore sipas Pjesës 504.

- a) Nëse nxënësi nuk është identifikuar si i paaftë fizik ose mendor, drejtori ose mëkëmbësi i tij/i saj duhet të shqyrtojë nëse rrethanat e incidentit disiplinor sugjerojnë praninë e një paaftësie mendore apo fizike.
- b) Në rast se drejtori ose mëkëmbësi i tij/i saj konkludojnë se nuk ka arsye që të dyshohet për një paaftësi mendore apo fizike, nxënësi mund të disiplinohet sipas sanksioneve disiplinore të rregullta sipas Kodit të Sjelljet së Shkollave Publike Worcester.
- c) Nëse rrethanat sugjerojnë se nxënësi mund të kete paaftësi fizike ose mendore, drejtori ose mëkëmbësi i tij do ta dërgojnë nxënësin në Komitetin 504 për të vlerësuar nëse nxënësi ka paaftësi.
- d) Nëse nxënësi identifikohet ose është identifikuar më parë si një nxënës me paaftësi sipas Pjesës 504, përpara se të merren masat disiplinore të cilit duhet të rezultojnë në një pezullim nga një (1) në dhjetë (10) ditë, drejtori ose mëkëmbësi i tij/i saj duhet të përcaktojë nëse sjellja e keqe e nxënësit është një manifestim i paaftësisë së tij/të saj dhe të sigurohet që të gjitha masat disiplinore të jenë në përputhje me mandatet e Pjesës 504.
- e) Nëse nxënësi identifikohet ose është identifikuar si nxënës me paaftësi sipas Pjesës 504 dhe/ose është identifikuar si i tillë pas një vlerësimi fillestar 504 dhe sanksioni disiplinor, ose sanksionet e grumbulluara disiplinore mund të rezultojnë në një pezullim nga shkolla për më shumë se dhjetë (10) dhe Komiteti 504 vendos se:
 - i. Nxënësi është, ose vazhdon të jetë, i paaftë fizik ose mendor dhe sjellja e tij/e saj është vërtetë e lidhur me paaftësinë e tij/të saj.
 - ii. Shkelja e rregullave të shkollës është rezultat direkt i mungesës së përkujdesjes ndaj paaftësisë mendore dhe fizike të nxënësit ose një plan 504 i pa përshtatshëm ose i pazbatuar.

Nxënësi nuk do të pezullohet nga shkolla; nëse megjithatë Komiteti 504 mund të përcaktojë se plani 504 i nxënësit duhet të përfshijë modifikime për të adresuar sjelljen e keqe të nxënësit përfshi, por jo të kufizuar në dhënien e shërbimeve edukuese në një vend alternativ, plane të modifikimit të sjelljes ose të mbështetjes, apo cdo modifikim tjetër i përshtatshëm, rregullim ose pasoje disiplinimi në përputhje me Pjesën 504.

- f) Në rast se nxënësi më parë është identifikuar si nxënës me paaftësi mendore e fizike sipas Pjesës 504 dhe/ose pas vlerësimit fillestar 504 dhe Komitetit 504 përcakton se nxënësi është, ose vazhdon të jetë i paaftë fizik e mendor por shkeljet e rregullave të shkollës nga ai/ajo nuk kanë të bëjnë me paaftësinë e tij/të saj, mungesën e trajtimit ose një plan të papërshtatshëm ose të pazbatuar 504, do të caktohen sanksionet e rregullta disiplinore sipas Kodit të Sjelljes së Shkollave Publike Worcester.

3. Vlerësimi/Rivlerësimi

Vlerësimet fillestare në pajtim me këtë rregull, dhe rivlerësimet e nxënësve me paaftësi sipas Pjesës 504, të cilët mund të jenë subjekte të pezullimeve ose përjashtimeve për më shumë se dhjetë (10) ditë të grumbulluara, do të bëhen në ndjekje të Pjesës 504D. Përcaktimi i paaftësive dhe lidhjes me paaftësitë nën Nën-pjesën 2 (a), (c), dhe (e) të këtij Rregulli, nga Komiteti 504 në ndjekje të këtij rregulli, do të bëhet përpara caktimit të sanksioneve disiplinore.

Nxënësit me Aftësi të Kufizuara që Marrin Edukim të Posaçëm

1. Drejtori (ose mësuesi) do të njoftojë Zyrën e Edukimit të Posaçëm për pezullimin e shkeljes të një nxënësi me paaftësi dhe do të mbahet një proces-verbal për këto njoftime i cili do të mbahet në sistemin e memaxhimit të nxënësit SAGE.
2. Kur pezullimi i një nxënësi me paaftësi mendore apo fizike akumulohet në më shumë se dhjetë (10) ditë gjatë vitit shkollor, ose duket se ka një historik të pezullimeve, do të mbahet një mbledhje e Manifestimit të Përcaktimit.
 - a) Nëse Komisioni i Planit Individual të Edukimit të Posaçëm në Manifestimin e Përcaktimit konkludon se ka një marrëdhënie të vërtetë të drejtpërdrejtë ndërmjet shkeljeve të kodit të disiplinës dhe paaftësisë së nxënësit ose që sjellja në fjalë ka qenë rezultat i drejtpërdrejtë i dështimit të shkollës për të zbatuar Planin Individual të Edukimit të Posaçëm, nxënësi kthehet në shkollë dhe masa disiplinore hiqet.
 - b) Nëse shkelja e kodit të disiplinës nga nxënësi nuk lidhet direkt apo kryesisht me paaftësinë e tij/të saj, ose me një Plan Edukimi Individual që nuk është vënë akoma në zbatim, mund të jepet pezullim ose një tjetër masë disiplinore. Komisioni do të vendosë një vend në të cilin nxënësi do të marrë shërbime gjatë periudhës së pezullimit për më shumë se dhjetë (10) ditëve, që ofron mundësinë e studimit të programit të përgjithshëm dhe shqyrton qëllimet e Planit të Posaçëm për Edukimin e tij/të saj.
 - c) Nëse një nxënës mban armë në shkollë ose në një aktivitet shkollor, ose nëse nxënësi me dije zotëron ose përdor ose shet drogë të jashtëligjshme ose kërkon shitjen e një substance të kontrolluar ndërkohë që është në shkollë ose në një aktivitet shkollor, ose shkakton plagosje të rënda trupore ndaj një personi në shkollë ose në një aktivitet shkollor, distrikti mund ta dergojë studentin në një vend edukimi tjetër për kohëzgjatë deri në dyzet e pesë (45) ditë shkollë. Vendi do të përcaktohet nga Komisioni i PIE.
 - d) Në rast se shkelja e nxënësit ose disiplina e kodit paraqet rrezik ndaj nxënësve të tjerë, personelit ose nxënësit vetë, dhe kujdestari/prindi nuk e pranon vendin e propozuar, Komiteti i Shkollës do të kërkojë miratim të menjëhershëm të gjyqit ose një urdhër nga Byroja e Apeleve për Edukimin e Posaçëm (BSEA), për të pezulluar ose përjashtuar nxënësit nga mjediset e shkollës së Worcester-it.
 - e) Çdo lloj mosmarrëveshjeje në lidhje me Planin e Posaçëm të Edukimit do të zgjidhet nëpërmjet procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për edukimin e posaçëm. Nëse kërkohet një seancë dëgjimore, nxënësit mund të qëndrojnë në


vendosjen e tyre aktuale përveç rasteve kur BSEA vendos ndryshe ose prindi/kujdestari bie dakord me një vend tjetër alternativ në pritje të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Zgjidhja e Problemeve të Shkollës

Procedura

Në mënyrë që të zgjidhen problemet që kanë të bëjnë me shkollën, prindërit do të ndjekin këtë proces:

Nëse del ndonjë problem, kontaktoni:



Rregulli në lidhje me Raportimin e çdo incidenti të mundshëm ose aktual që mund të ndikojë në sigurinë e fëmijëve.

Drejtori duhet tu japë prindërve/kujdestarëve raporte me gojë ose me shkrim për çdo incident të mundshëm ose aktual që mund të ndikojë mbi sigurinë e nxënësve. Është jashtë mase e vështirë t'i jepen shembuj drejtorit për incidentet të cilat duhet të raportohen. Është e qartë që kjo gjë do të varet në gjykimin e drejtorit.

Kriteri për raportimin do të përfshijë çka më poshtë:

1. Prindërit/kujdestarët duhet të njoftohen menjëherë me telefon për çdo incident i cili mund të ndikojë mbi sigurinë.
2. Çdo raportim verbal do të ndiqet menjëherë me një raport të shkruar i cili ose do të dërgohet me postë ose të t'ju jepet prindërve/kujdestarëve.
3. Drejtorët do të paraqesin një raport të dyfishtë menjëherë tek Menaxheri i Zonës dhe Komiteti i Shkollës.

SHËRBIMET SHËNDETËSORE PËR NXËNËSIT

Rregullorja per Mbarvajtjen e Shendetit

Parathenie

Misioni i Shkollave Publike të Worcesterit(SHPW) persa i përket rregullores së mbarvajtjes shëndetësore është tju mundësojë nxënësve të bëhen të panvarur dhe vetëdrejtues, përgjegjës për plotësimin e nevojave të tyre shëndetsore dhe nevojat ushqyese të duhura. Eshte nje nga qellimet kryesore te kesaj rregullorje te promotoje mbarvajtjen fizike, emotionale dhe sociale te te gjitha nxenesve nepermjet perpjekjeve te kordinuare nga departament dhe sherbimeve qe ofrojne Shkollat Publike te Worcester-it.

Pasqyrim:

Satistikat ndërkombëtare tregojnë se 15.3% e studenteve nga mosha 6 deri në 11 janë obisë (BMI>95th); dhe 15% të kësaj moshe janë mbipeshë (BMI >85th but <95th). Statistikat në Worcester për 2012 janë 17.4% mbipeshë dhe 18.8% janë obisë dhe në total 36.2% e krahasuar me mesataren e shtetit që është 34.3%.

Duke marrë parasysh se obisiteti është bërë një problem i madh si në rang ndërkombtar ashtu edhe lokal, SHPW është angazhuar të krijojë në shkolla një mjedis ku promovohet shëndeti dhe aftësia për të mësuar duke suportuar ushqime të shëndetshme dhe aktivitete fizike. Atëherë, rregullorja e Shkolla Publike te Worcester-it thote:

- Distrikti i shkolla do te vazhdoj te angazhoj nxenesit, prinderit, mesuesit, personelit ushqimore dhe te gjitha anetaret e komunitetit qe jane te interesuar, ne zhvillimin, vendosjen, mbikqyrjen dhe rishikimin per te gjitha distriktet te rregullores per ushqimin me vlere dhe aktivitetin fizik.
- Nxenesit ne klasen K-12 do te kene te gjithat mundesite, mbeshtetjen dhe inkurajimin qe te marrin pjesë në aktivitete fizike te vazhdueshme.
- Ushqimet dhe pijet freskuese qe shiten ne shkollë do te jene te njejta me ato qe rekomanduara nga Rregullorja e Ushqimeve me vlete te Shtete e Bashkuara per Amerikanet.
- Dietologet e femijeve do te ndihmojnë administraten e shkolles per t'ju ofruar nxenesit mundesine per te marre ushqime te lira, te ushqyeshme dhe terheqese por

qe ne te njejtën kohe permbushin kersesat e tyre. Ata do te marrin parasysh diversitetin fetar, etnik dhe kulturor ne planifikimin e ushqimit.

- Ushqimet do te shërbehen ne nje ambient te paster, te sigurt dhe te kendeshem me kohe te mjaftushme per te ngrene.
- Shkolla do te ofrojë edukate ushqimore dhe fizike.
- Nxenesit dhe stafi drejtues do te perfitojne nga keto programe qe do ti japin mundesine te kene lidhje me sherbime per tu consultuar per shendetin.

Shkolla Publike e Worcester-it do te krijoj Keshillin Konsultative te Shendetit te Shkolles qe ka per detyre te vendose, ndjeke, pare dhe kur eshte e nevojshme per te ndyshuar rregulloren e shendetit, te ushqimite dhe te aktivitet fizik. Keshilli do te sherbej per shkollat si personi qe te ndihmoje ne vendosjen ketyre rregulloreve, sepse keshilli beson se nxenesit e shendetshem jane edhe nxenes me rezultate te mira ne mesime.

I. Këshilli Konsultativ Shëndetësor i Shkollës

Anëtarët e Këshillit Konsultativ Shëndetësor i Shkollës përbëhet:

Drejtori i studentëve dhe stafit të shërbimit të mbështetjes

Manageri i Edukimit të Femijeve me Nevoja Specifike dhe Sherbimeve te Nderhyrjes

Anetar i Komisionit Shkollor te Worcester-it

Kordinatorja e Sherbimeve Infermierore

Drejtori i Edukatës Shëndetsore dhe Sigurisë/Shëndeti për Nxënësit

Drejtori i Shkollës Dietologe

Koordinatori i Shendetit dhe Edukimit Fizik të Shkolles

Koordinatori i Sigurisë së Shkollës

Drejtori i Shkolles se Mesme

Drejtori i Shkollës Tetëvjeçare

Drejtori i Shkollës Fillore

Nxënësi së Shkollës së Mesme

Prinderit/Kujdestaret

Infermjerja Lidhese per shkollat private

Mjeku konsultant per Shkollat Publike te Worcester-it

Perfaqesuesi i qendres per shendet e basuar ne shkolle

Departamenti i Shendetit Publik per Qytetin e Worcesterit: Komisioneri ose Anëtarë të tjerë

Perfaqesues: Qyteti i Worcester-it EMS

Perfaqesues: Qendra shendetsor Edward M. Kennedy Health Center

Perfaqesues: Qendra Familjare Shendetsore

Perfaqesues: UMass/Memorial Hospital

Perfaqesues: Y.O.U., Inc.

Perfaqesues: Agencia për të rinjtë

Perfaqesues: Organizata për Familjen

II. Cilësia Dietologe e Ushqimit dhe e Pijeve Freskuese qe Shiten ne Mjedisin e Shkollës

Ushqimi në shkollë

Ushqimet qe serviren nga Dreka ne shkolla Nderkombtare dhe Programet e mengjesit do te ndjekin parametrat dietologe te Planifikime te Menuse Standarte Ushqese, ku do te arrihet niveli minimal per kalorite, proteinat, kalciumin, hekurin, vitamin A, vitamin C dhe niveli maksimal te mos i kaloj yndyrnat me shume se 30% dhe yndyrnat e ngopura mos ta kalojne me shume se 10%

Drejtori i shkolles do te konsultohet me Zyren e Dietologeve te Shkolles per te reguluar orarin e drekes ne menyre qe te jete ne perputhje me numrin e kerkuar te te serviruri dreke duke siguruar keshtu qe te gjithe nxenesit te kene mundesi per te marre ushqim.

Ne shkolle, menzat do te fokusohen qe te promovojne ushqimet kompesuese dhe "whole-food" komoditete sic jane qumeshti, frutat e fresketa dhe zarzavatet.

Shkolla do te blejë fruta te rritura neper ferma lokale, zarzavate te stines dhe do te vazhdoj te punoj me Departamentin e Bujqesise te rrisi mundesite.

Ne perputhje me Aktin Te Shendetshem dhe Femije te pa Uritur te 2010, uji do te jete falas ne mjediset ku do te shërbehesh ushqimi.

Te gjitha ushqimet e shkolles do te vazhdojne te jene pa yndyrna artificiale.

Ushqimet Konkurente

Në përputhje me rregulat lokale, federale dhe shtetërore, menza e shkollës nuk do të tregtojnë kurrë ushqim të autorizuar dhe/ose në konkurim me ushqimet kompesuese të ofruara nga Programi Nacional për Mengjesin dhe Drekën në Shkolla.

Legjistacioni i 2010 perfshin këto rregulla të reja:

Ne perputhje me Ligjin e Ushqimit per Shkollat e Massachussets te gjitha ushqimet qe shiten ne dyqane, ne baret e shkolles, ne makinat me pagese ose ne ndonje vend tjetër ne teritorin e shkolles do te pajtohet me standartet ushqimore qe ka vendosur Departamenti i Shendetesise, duke marre marasysh se keto standarte nuk do te jene te njejta per ushqimet ose pijet konkuresuese qe shiten ne teritorin e shkolles 30 minuta pare se te filloi mesimi dhe 30 pas mbarimit te mesimit, me perjashtim te ushqimeve dhe pijeve qe shiten ne makinat me pagese, ne te tille raste standartet ushqimore duhet zbatohen te tere kohen.

III. Promovimi i Ushqimit me Vlera dhe AKtiviteti Fizik dhe Marketimi i Ushqimit

Edukimi per Ushqimin me Vlera dhe Promotimi: Distikti i Shkollave Publike te Worcester-it synon to mesoj, inkurajoje, dhe suportoj nxenesit e tij te zhvillojne zakone te mira ne te ngrene. Shkolla do te jap edukate nen ushqimin me vlera dhe do te angazhohet ne promotimin e ushqimit me vlera qe:

- ofrohet ne te gjitha klasat si pjese e nje programi te vazhduhem, te kuptuhem dhe ne baze te standarteve , i ndertuar qe te jape nxenesve njohurite dhe aftesite e duhura te promovojne dhe te mbrojne shendetin e tyre
- eshte pjese jo vetem e klasave per edukimin e shendetit, por edhe instruktive per lende te tjera si shkenca, gjuhe dhe shkenca mbi familjen dhe konsumatorin
- perfshin aktivite te kenshme, zhvilluese aq sa duhet, te ngjashme me kulturen, argetuese si per shembull, konkurse, promovime, prova gatimi, vizita neper farma dhe oborrin e shkolles;
- promovim i frutave, zarzavateve, prodhimeve te grurit, prodhimet e qumeshtit me pak ose pa yndyre fare, menyre gatimi te shendetshme dhe praktika qe inkurajojne ushqimin me vlere
- Thekson balancen e kalorive midis ushqimit qe merr dhe energjise qe harxhohet (aktivitetet fizike);
- lidhje me programet shkollore per ushqimin e vleshem, ose programe te tjera qe organizon komuniteti;
- thekson ne mesimin e medias leximin per marketimin e ushqimit; dhe
- perfshine training e mesuesve dhe stafit te ushqimit te vleshem

Marketimi i Ushqimit në Shkolla: Reklama nëper shkolla do të jetë në përputhje me rregulloren për edukimin e ushqimit me vlere dhe shendetit. Ndalohet reklama e firmave qe promovojne ushqime dhe pije me pak vlere ushqimore. Inkurajohet promotimi i ushqimeve te shendetshme perfshin ujin, frutat, zarzavatet, prodhimet e grurit dhe prodhime e qumeshtit pa yndyre.

Shendeti i Personelit: Te gjithë punonjesit jane anetar te kompanise per Asistencen e Punetorit , e cila ka infermiere te gatshme to mesojne dhe edukojne pesonelin ne drejtim te parandalimit dhe shendetin.

IV. Mundësi për aktivitete fizike dhe Edukim Fizik

Edukimi Fizik

MGL kapitulli 71, pjesa 3 shtetet:

Edukimi fizik duhet te jepet si lende e detyruar ne te gjitha klasat per te gjitha shkollat publike qe te promovoj gjendej e mire fizike te te gjithë nxenesve.

Si arsye:

- Shollat Publike te Worcesterit (WPS)do tju mesojne edukate fizike te gjithë studenteve nga klasat K-12 duke perfshire ketu edhe nxenesit me aftesi te kufizuara, me nevoja speciale, dhe ne grupe te tjera shkollore
- Nxenesit do te marring rregullisht orarin e udhezimeve te edukates fizike qe jane me perputhje me rregulloren e shtetit te Massachusetts
- Të gjithë nxënësit e klasave 7-12 do të marrin mësim në klasat e edukimit fizik për reanimin kardiovaskular (CPR) vetëm-me duar dhe në përdorimin e defibrilatorit të jashtëm automatik (AED)

Mesues qe jane te certifikuar ne edukaten fizike do te japin mesim per kete klase.

Pushimi: Shkollat fillore do te kene pushim nen mbikqyerje, e preferuara do te ishte perjashta, nje ose me shume gjate dites ku do te inkurajohen aktivite fizike te lehta dhe te fuqishme

Shume nga ndretesat ne SHPW, brenda dhe jashte paraqisin veshtiresi, per te bere aktivitet ne pushim, por aktivitet qe zhvillohen ulur nuk duhet te zevendesohen. Shkollat vete duhet te mendojne per variante te tjera qe ti japin mundesi nxenesve te kene aktivite ne pushim. Variantet e tjera mund te gjehen ne praktikat lokale dhe rreth e perqark vendit dhe mund te perfshin edhe dalje si jashte dhe brenda neper qendrat e argetimit

Aktivitet Fizike para dhe pas shkolle

- Nxenesve u jepet mundesia te marrin pjese ne aktivite fizike nepermjet programeve qe jane para, ne midis dhe pas shkolle, po jo vetem kaq, gjithashtu klubeve te aktiviteve fizike (per shembull Fit Math, klube per ecje etj.)
- Pas mesimit do te inkurajohen programe per pasurimin dhe per kujdesin e femijes qe te krijone mundesi e per hapesire e duhur, veglat dhe aktivitetet qe suportojne kohen per ushtime te lehta dhe te fuqishme per te gjitha pjesmarresit

Transporti Aktiv për në dhe nga Shkolla

- Shkollat Publike të Worcester mbështesin transportin aktiv për në dhe nga shkolla, siç është ecja ose ecja me biçikletë. Distrikti do ta inkurajojë kë sjellje duke u angazhuar në aktivite siç janë: përcaktimin e rrugëve të preferuara që janë të sigurta për në shkollë, aktiviteve promovuese siç janë pjesëmarrja Java Ndërkombëtare e Ecjes për në Shkollë, Jave Kombëtare e Ecjes ose Ecjes me Biçikletë për në Shkollë, vend të sigurtë për vendosjen e biçikletave dhe helmetave, udhëzime për ecjen/ecjen me biçikletë e sigurtë, promovim tek nxënësit të programit për rrugët e sigurta, stafi dhe prindërit, si dhe dokumentimi i nxënësve që ecin ose ecin me biçikletë për në dhe nga shkolla.

V. Mjedisi i Shkolles

Festat/mbledhje fondesh ne shkolle

SHPW inkurajon festimet e kulturave te ndryshme te gatimeve dhe ndarjen e traditave te gatimeve midis nxenesve, familjeve, mesuesve dhe personelit. Ne e pranojme se ushqimi eshte nje nga komponentat kryesor te kulturave te ndryshme dhe e inkurajojme festat qe kane si qellim "ushqim te shendetshem"

Shkollat duhet ti limitizojne festat ku perdoret ushqim me pak-i shendetshem dhe po ashtu te suportoj argetime ku mos te serviret ushqim. (shiko http://cspinet.org/new/pdf/healthy_school_celebrations.pdf).

Organizimet per mbledhe fondesh qe kane ushqime jo me vlere ushqimore (si per shembull biskota dhe kek) duhet te jene te limitizuara dhe duhet perpjekur qe keto organizime

te mos jene me ushqim (per shembull hec-per-thons, larje makinash, llotari per dreke me drejtorin):

<http://www.cspinet.org/nutritionpolicy/fundraiserfactsheet.pdf>

<http://www.cspinet.org/new/pdf/schoolfundraising.pdf>

<http://www.extension.iastate.edu/Publications/PM2039.pdf>

Perdorimi i ujit: Perdorimi i ujit duhet te inkurajohet per te gjithë nxenesit, dhe te gjithë nxenesit duhet te kene mundesit e kene uje te pijshem gjate gjithë dites. Perdorimi i ujit te masen e duhur jo vetem qe ndalon obisitetin, por eshte edhe element kryesor per te mbajtur trupin e fresket. Freskia e papeshatshme lidhet me dhimbjet e kokes, te berit kaps dhe me funksione mendore.

Perdorimi i banjos: Nxenesit duhet te kene mundesi per te vajtur ne banjo sa here qe kane nevojë. Kufizimi i vajtjes ne banjo mund te kete pasoja ne shendetit e nxenseve (si pershembull infeksione te kanalave urinare), qe mund te sjelli siklet, jo higjene te mire dhe mund te pengoj mesimin nga mos vemendja. Per te shkuar edhe me tutje, m.q.s larja e duarve eshte kryesore ne parandalimin e shperdarjes se mikrobeve, perdorimi i banjos (qe jane te pastra dhe kane mjaftueshem sapun dhe leter higjenike) eshe kryesore.

VI. Shërbimet Shëndetsore/Mjeksore në Shkollë

Një program i koordinuar i shërbimeve mjeksore ndihmëse do tu ofrohet nxënësve dhe personelit nëpërmjet departamentit të infermierisë së shkollës, ne bashkpunim me këshilltarin e mjekut të shkollës, departamenteve të ndryshme brenda sistemit të shkollës dhe agjensive të tjera jashtë shkollës, i cili do të bejë të mundur që nxënësit dhe personeli të kenë mundësi për të përdorur programe shëndetsore të kordinuara. Ky program do të përfshijë ndalimin dhe raportimin e sëmundjeve ngjitesë, vaksinimin, edukimin shëndetsor dhe promovimin e mirëqënies shëndetsore, vlerësimet shendetsore dhe ekzaminimet, menaxhimin e situatave kronike, konsultimet, referimet nga komuniteti shëndetsor, ndihmën e shpejte dhe emergjencat.

Infermierja e shkollës do të vazhdojë të ekzaminojë shikimin, degjimin, skoliosis, gjatësinë, peshën, dhe BMI. Për nxënësit të cilët kanë nevojë të mbahen nën kontroll të mëtejshëm nga doktori në bazë të rezultateve të këtyre ekzaminimeve ,do tju dërgohet një letër prindërve të tyre për të diskutuar me Mjekun Parësor të Kujdesit familjar. Infermierja e shkollës do të përpiqet të mbajë kontakt me doktroin familjar në rastet kur familja nuk ka gene ne gjendje.

Kur nxenesi ka një semundje kronike (si azëm, diabet, alergji me rrezik per jetën, obisiti, ADHD, por jo vetem kaq) ka Plan Individual i Kujdesit Shëndetsor, dhe prinderit/kujdestaret kane pranuar, infermierja e shkollës do te tranojne dhe edukojne, aq sa duhet te dine the gjithë personelin qe ka lidhje me kete nxenes, duke perfshire trajnerin dhe personelin e edukates fizike, qe te sigurojne parrezikshmeire e nxenesit ne shkolle. Infermierja e shkollës jete pesoni ku personeli do te drejtohet per ndonje pyetje per semundjen kronike dhe do te punoj me familjen dhe doktorin e nxenesit. Infermierja do te edukoj nxenes

te caktuar per limited or akomodimet qe jane te nevojshme perpa ndonje activite fizik. Departamenti i infermierise per Shkollat Publike Worcester do të vazhdojë të punojë me keshillaret e mjekut dhe organizata te tjera mjeksore per problemet e lidhura me nxënësit .

Alergjité me rrezik për jetën: Alergi me rrezik per jeten: Infermierja per Shkolla Publike te Worcester-it do te japi mesim per te educuar punetoret e SHPW mbi alergjite me rrezik per jeten dhe Epi-en sipas rekomandimeve te Departamentit te Shendetsise dhe Departamentit te Shkollave Filllore dhe Mesme, gjithashtu;

- Rendesine e alergjive me rrezik per jeten dhe diskutime ne rastet te perhapura te ketyre alergjive (ushimi , insektet, qumeshti, alergite nga ilacet)
- Krimi i nje ambienti te sigurt per nxenesit me keto lloj allergies
- Percaktimi, kur duket qe eshte e nevojshme, e nje tavoline ne menzen e shkollës ku nuk ka kurre kikirike ose ushqime te tjera te specifikuara.
- Implimitimi i praktikës "AS USHQIMI OSE MJETEVE PER USHQIM" te mos ndarhen midis nxenesve , kur duket e asyeshme, duke u fokusuar me shume tek shkollat fillore;
- Trajnimi i personelit te menzave mbi kujdesin e nevojshem per te siguruar parrezikshmerine e nxenseve/personelit nga infektimi i ushqimit ose mjeteve ngrënëse;
- Udhëzimet e prinderve persa i perket vakteve te vogla;
- Shenjatdh e sptomat e epilepsise;
- Perdorimi i Epi-pen
- Aktivizimi i Sistemit te Shërbimit Urgent, per shembull infermierja dhe 911 urgencia, te dish te sillesh kur nje reagim epileptik po ndodh, pritet te ndodhi ose mund te ndodhi.

Asma: Infermierja Shkolla do të ofrojë edukim dhe udhëzime për të gjithë personelin e përfshirë me studentët, në një nevojë të dini bazat, duke përfshirë:

- Udhëzimet e vendosura per nxenesin që të ketë me vete dhe të administrojë aparatit per thithjen e ilacit te tij/saj, me lejen e prindit/mjekut dhe te miratuar nga infermierja e shkollës.
- Nje plan mjeksor për nxënësin mbi përdorimin e ilaçeve do të zhvillohet dhe implementohet. Infermierja e shkollës do të instruktojë pesonelin dhe nxënësit të dallojnë shenjat dhe simptomat e nje përkeqësimi të azmës; ndryshimin midis aparatit për thithjen e ilaçit nga trajtimi me nebulizer dhe të rishikojë administrimin e përshtatshëm.
- Aktivizimi i Sistemit të Shërbimit Urgjent kur nxenesi vazhdon të ketë vështirësi në marrje frume edhe pasi ka përdorur aparatit për thithjen e ilaçit ose trajtimin me nebulizer.

Diabeti: Për të patur njohuri, në rast nevoje, infermierja e shkollës do të ofrojë edukim dhe insrtuktim për të gjithë pesonelin mbi çështjet në të cilat përfshihen .

- Udhëzime për nxënësit që të mbajnë me vete testin dhe të administrojnë vetë insulinën e tyre me lejë nga prindi/mjeku dhe me miratim nga infermierja e shkollës. Një plan mjeksor për nxënësin do të zhvillohet dhe do të implementohet.
- Shenjat dhe simptomat në rast të nivelit të ulët të sheqerit në gjak dhe mjekimi që është vendosur nga mjeku i nxënësit;
- Dieta dhe nevojat për karbohidrate të nxenesit të vendosura nga konsultimi me dietologun e shkollës;
- Aktivizimi i Sistemit të Shërbimit Urgjent kur nxënësi nuk ka përmirësim nga trajtimi i parë.

Infermierja e shkollës do të punojë së bashku me nxënësin, familjen, PCP, dhe specialistin për të ndihmuar në menaxhimin e diabetit, të mësojë dhe të përforcojë tek nxënësit mësimin për vetë-menaxhim sipas rastit.

Çrregullime Difiçitare Hiperaktive të Vëmendjes (ADHD)

ADHD është një nga sëmundjet kronike me të perhapura neper shkolla, dhe bashkepunimi mjekeve, familjes dhe shkolles është celsi kryesor ne diagnostikimin dhe menaxhimin e kesaj semudjeje qe te sigurohet sukses ne shkolle. Kur është e nevojshme, infermierja e shkolles do te administroj mjekimin dhe do te sherbej si burim per personelin dhe mesusin per pyetje qe kane te bejne me mjekimin dhe efektet anesore qe kane ato. Infermierja e shkolles do te asistoj me komunikimet midis familjarve, doktoreve dhe shkolle ne mardhenie me evaluimin dhe menagimin e ADHD.

Shendeti Mendor dhe Sherbimet konsultative

Shendeti mendor dhe një jete sociale pozitive dhe sjellja jane te domosdoshme ne ecurine e mire te nxenesve.

Si ne shkollat fillore ashtu edhe ne ato te mesme, anetaret e Sherbimeve Konsultative dhe Psikologjike japin sherbime suportive qe te adresojne nevojat e identifikuar sociale, emocionale, dhe pershtatje te nxenesit ne bashkepunim me prinderit ose kujdestaret, edhe me mesuesis dhe administratoret.

Persa i perket kesaj rregullorje, ne nivelin fillore, Keshilltare e Peshtatjes ne Shkolle and Psikologjistet e Shkolles punojn afer me administratoret, mesuesit dhe infermieren e shkolles kur nje femije shfaq veshtiresi ne sjellje ose ne pershtatje qe mund te lidhet me gjendjen e tyre emocionale dhe mund te ndikoj per keq ne aftesite e tyre per te mesuar. Ne klasat e me vonshme dhe shkollat e mesme, cdo nxenesi i eshte caktuar nje keshilltar udhezues qe ka njohuri te plota persa i perket zhvillimit te adoleshenteve ne lidhje me probleme qe mund te vijne nga mos plotesimi i nevojave emotionale. Keshilltari udhezues do ti rekomandoj prinderit dhe nxenesit tek keshilltari i pershtatjes i shkolles ose tek psikologu i shkolles qe te asistojne ne nje rruezidhje kur eshte identifikuar nevoja per te nderhyre.

Personeli suportive mund te asistoj familjen per te gjetur sherbime ne komunitet duke ndjekur qendra shendetsore ose nepermjet protokollit te rekomandimeve me profesionista lokal per sherbime per sjellje te shendetshme kur perdorimi i vazhdushem duket i domosdoshem.

Nëse nxënësi nuk është në gjëndje të funksionojë si pasojë e gjëndjes mendore ai/ajo mund të rekomandohet tek Procesi Suportiv i Nxënsëve në mënyrë që nxënësi të ketë mundësi të marrë sherbime shtesë të nevojshme.

VII. Komunikimi

Rregullorja mbi mbarvajtjen e shëndetit do të jetë e publikuar në faqen elektronike të SHPW dhe do të shpërndahet në të gjithë partnerët e komunitetit.

Komunikimi me Prindërit:

- The SHPW do ta shperndaj rreguloren mbi mbarevatjen e shendetit tek CPPAC, Keshilltari i zones dhe PTOs dhe do te angazhoj familjet me qellimin qe te krijoje nje ambient neper shkolla ku te suportohet shendetit.
- Cdo vit SHPW do te dergoj neper shtepe leter qe do te perfshije infomacion dhe kerkime shkencore, statistika mbi shendetin qe jane bere ne rang lokal ose national, shembuj te ushqimeve te ushqeshme, festa dhe mbledhje fondesh, programe shkolloer dhe rregullore qe jane pergjaritut to drejtojne femijet qe te vendimi te mira ne drejtim te zgjedhjes se ushqimit. Distrikti/shkolla do ti japi familjeve informacione per edukaten fizike dhe aktivitetet fizike te tjera shkollore perpara, midis dhe ne fund te dites shkollore dhe do te suportoj prinderit ne deshiren per ti bere te mundur femijeve qe te jene aktive ne aktivitetet jashte shkollore duke i dhene atyre information per agjensite rinore.
- SHPW po ashtu do te perdori edhe gazeten e shkolles, faqen elektonike shendetsore te shkolles, faqe elektonike individuale dhe partneret ne komunit te informoj prinderit mbi mbarvajtejn e shendetit dhe te nenvizoj priktika premtuese.

Komunikimi me drejtorët dhe personelin -Rregullorja mbi Mbarvajtjen e shendetit do te shperndahet te gjithe sistemin shkollor duke perfshire edhe drejtoret, te cilet do ta ndajne ate me personelin e tyre.

VIII. Monitorimi

Sipas Rregullores Federale persa i perket zbatimin dhe monitorimit te Rregullores te Mbarvajtjes Shendetsore, kjo rregullore do te vendoset ne nivel distrikti dhe ne nivel shkollor dhe monitorimi i aktiviteteteve do te tregoj strategine e vendosjes.

Inspectori do te takohet cdo vere, nje here ne vit, me Keshillin Konsultativ te shendetit te kontrolloj, rekomandoj dhe aprovoj ndryshimet qe mund te duhen per ti bere Rregullores per Mbarvatjen e Shendetit.

Keshilli Shendetsor i Shkolles do te ofrojë templeta per keto sektore:

- Ambienti general i shkolles: Kjo pjese e zbatimit do te monitorohet ne nivel shkollor. Drejtori do te punoj me keshilltarin e Zones dhe PTO to zbattoj dhe monitoroj aktivitetet.
- Infermiera e shkolles: Kjo pjese zbatimi do te monitorohet ne nivel distrikti nga Koordinatorin e Infermierise se Shkolles me rekomandime nga infermieret e shkollave
- Edukimi Fizik dhe Edukimi mbi ushqimet me vlere: Kjo pjese e zbatimit do te monitorohet ne nivel distrikti nga Drejtori i Atletikes ne bashkpunime me mesuesit dhe shkollat .
- Zyra e Ushqimit te Vleshem te Shkolles: Kjo pjese e zbatimit do te monitorohet ne nivel e distriktit nga Drejtori i Zyres se Ushqimeve te Vleshme ne bashkpunim me shkollat

Te dhenat per zbatimin do te mblidhen cdo vit nga Keshilli Shendetesor i Shkolles dhe pervit, per te gjithë distriktin do te pergatitet nje raport qe do te permbledhi te gjithë aktivitetet per zbatimin e Rregullores per Mbarvajtjen e shendetit. Ky raport to ti paraqitet Komisionit te Shkolles, Komisionit per Mesimindhenien, te Mesuarit dhe Suportimit te Nxenesve. Po ashtu do te ndahet edhe me pesoneline e ShPW, nxenesit dhe komunitetin.

Rregullorja e Departamentit të Shëndetit Publik

1. Vaksinimi - Të gjithë nxënësit e shkollave publike të Massachusetts duhet të vaksinohen për difteri, kollën e mirë, poliomielin, fruthin, shytat, rubeolën, hepatitin B dhe varicelën. Vaksina Hib kërkohet për ndjekjen e kujdesit të fëmijëve dhe klasat parashkollore. Numri i dozave primare përcaktohet nga produkti dhe mosha e vaksinës kur fillon seria. (102 CMR 7.07 dhe 105 CMR 220.00). Nxënësit që nuk e kanë dokumentacionin e duhur për vaksinimin duhen përjashtuar deri sa të paraqiten prova për vaksinimet. Nëse një prind/kujdestar refuzon të vaksinojë fëmijën për arsye fetare ose mjekësore, sikurse kërkohet nga Departamenti i Shëndetit Publik të Massachusetts-it dhe Ligji i Përgjithshëm i Massachusetts, Kapitulli 111, pjesët 3, 6, 7, 109, 110, 111, 112 dhe 105 CMR 300.000, nxënësi i pavaksinuar do të përjashtohet nga shkolla gjatë epidemive të sëmundjeve për të cilat nxënësi nuk është vaksinuar.
2. Helmimi nga plumbi - Fëmijët duhet të paraqesin prova të dokumentuara për helmimin nga plumbi përpara se të hyjnë në Ciklin Parashkollor-PreK dhe/ose në kopsht (105 CMR 460).
3. Ekzaminimi fizik - kërkohet për nxënësit e kopshteve dhe klasave 4, 7 dhe 9. Rekomandohet që ky ekzaminim të bëhet nga mjeku parësor i shëndetit ose klinika e kujdesjes në shtëpi.

4. Ekzaminimet Fizike- Kërkohe **çdo vit** për të gjithë nxënësit atketë.
5. Programet e kontrolleve - 105 CMR 200.500 përcakton kontrollin e gjatësisë, peshës dhe treguesin e masës së trupit (BMI) në klasat 1, 4, 7 dhe 10.
 - a) Departamenti duhet të marrë të dhëna mbi BMI-në e nxënësit çdo vit, nga shkolla ose distrikti i shkollës, sikurse është specifikuar në direktivat e Departamentit.
 - b) Një kopje e rezultatit të BMI-së së nxënësit duhet të mbahet në të dhënat e regjistruara të shëndetit në shkollë.
 - c) Prindërit dhe kujdestarët ligjorë do të kenë mundësinë të kërkojnë me shkrim që fëmija të mos marrë pjesë në program.
 - d) Prindërit mund të kërkojnë një kopje të raportit të BMI-së për fëmijën e tyre nga infermierja e shkollës.
6. Protokoli për morrat - Bazuar mbi faktet se morrat nuk shkaktojnë ndonjë lloj sëmundjeje, që politikat pa-thërija nuk kanë treguar të jenë efikase në parandalimin e përhapjes së morrave, dhe që fëmijët humbasin kohë edukimi të vlefshme çdo vit për shkak të politikave pa-thërija, Shkollat Publike Worcester e kanë ndërruar praktikën tonë nga "pa-thërija" në "pa morra të gjalla". Kjo është një praktikë e re e bazuar mbi evidencë e kërkime, dhe fëmijët si dhe shkollat do të përfitojnë shume prej saj në komunitetin tone. Nëse gjenden morra të gjalla, nxënësi do të përjashtohet deri sa ai/ajo të jetë trajtuar dhe morrat të jenë pastruar. Është përgjegjësia e prindërve që të kontrollojnë, trajtojnë dhe të pastrojnë rregullisht morrat/thërijat. Nxënësit duhet të kontrollohen nga infermierja e shkollës përpara se të kthehen në klasë.
7. Largimi - Nxënësit që rezultojnë të jenë sëmurë do të largohen nga infermierja e shkollës. Prindërit/kujdestarët janë përgjegjës që të ofrojnë mjete transporti për në shtëpi. Prindërve/kujdestarëve ju kërkohe t'i japin shkollës një numër telefoni, ose një numër alternativ në rast emergjence.

Administrimi i Barnave

Departamenti i Shëndetit Publik të Massachusetts rregullon administrimin e barnave me recetë dhe ka shpallur "Rregulla të detajuara për qeverisjen dhe administrimin e barnave mjekësore me recetë në shkollat publike dhe private" (105 CMR 210.000). Rregullat kërkojnë të sigurojnë, që nxënësi i cili duhet të marrë barna me recetë gjatë ditës së shkollës duhet të jetë në gjendje të ndjekë shkollën dhe barnat me recetë të administrohen në mënyrë të sigurte. Shkollat Publike Worcester ofrojnë shërbime infermierie për nxënësit e Shkollave Publike Worcester. Vetëm infermieret e licencuara mund të administrojnë ligjërisht barnat me recetë tek nxënësit, me përjashtim kur kjo detyrë delegohet për ekskursione ose aktivitete të tjera afat-shkurtra të shkollës.

Procedura e "Administrimit të barnave" identifikon barnat që duhen dhënë gjatë ditës së shkollës kur është teper e nevojshme nga ana mjekësore që ato të jepen gjatë këtij orari. Në mënyrë që nxënësit t'i jepet çdo lloj ilaçi në shkollë duhet të ndiqen hapat e mëposhtëm:

- Mjeku Parësor për Kujdesit Shëndetsor të nxënësit duhet të plotësojë Formularin Administrimit të Barnave dhe Formularin e Miratimit të Prindit.
- Prindi/kujdestari duhet të firmosë formularin e lejes nga prindi.
- Formulari i plotësuar duhet t'i jepet infermieres së shkollës.
- Një prind/kujdestar, ose i rritur i caktuar duhet të sjellë barnat në shishen e recetës dhe t'ia japë infermieres së shkollës, dhe nëse nuk ka infermiere, drejtorit. Kërkohet vetëm 30 ditë furnizim.
- Departamenti i Infermierisë së Shkollave Publike Worcester do të mbajë një kopje të formularit të plotësuar dhe origjinali do ruhet në dokumentat e nxënësit.
- Infermierja e shkollës do të regjistrojë të gjitha barnat e administruara në EHR të nxënësit.
- Si formulari i recetës së doktorit ashtu dhe leja e prindit/kujdestarit duhet të rinovohen çdo vit në fillim të çdo viti shkollor.
- Barnat do të mbahen në një dollap të kyçur ose në frigerifer.

Procedura për delegimin e barnave gjatë ekskursioneve dhe aktiviteteve të tjera afatshkurtra përfshin çka më poshtë:

- Plotësimi i Formularit për Mosmarrëpjesë në Ekskursion – “Plani i Administrimit të Barnave” i firmosur nga prindi/Kujdestari
- Të pakën dy javë para të lajmërohet infermierja me qëllim që ajo të ketë mundësi të trainojë personin e caktuar për të administruar barnat por edhe për efektet anësore që kërkojnë ndërhyrje.
- Nëse një nxënës ka diabet, infermierja e shkollës do të kërkojë prindit të shkojë në ekskursion me të, dhe nëse nuk mundet, infermierja e shkollës do të shkojë në të.

Formularët mjekësorë dhe ato të Shëndetit Fizik gjenden në faqen elektronike www.worcesterschools.org/administration/nursing

Rregulli për HIV-in-AIDS-in

Rregullat e Shkollave Publike Worcester reflektojnë Rregulloren e Edukimit të Bordit të Massachusetts, për AIDS-in të (sindroma e marrë e imunodeficiencës) dhe HIV-it (virusi human i imunodeficiencës) të prillit të 1990-s dhe është në përputhje me ligjin e shtetit për fshehtësinë e informacionit mjekësor.

Nxënësit me injeksonin AIDS/HIV kanë të njëjtat të drejta që të ndjekin mësimet dhe të marrin pjesë në programet dhe aktivitetet shkollore si çdo nxënës tjetër.

Udhëzime:

- Asnjë përveç nxënësit dhe/ose prindit(ërve) ose kujdestarit(ëve) të nxënësit nuk ka nevojë të dijë domosdoshmërisht diagnozën AIDS apo infeksionin HIV të nxënësit.

Ka disa arsye mjekësore që një nxënës dhe/ose prindi/kujdestari i tij mund të kenë për t'ia thënë diagnozën infermieres ose doktorit të shkollës, edhe pse ata nuk janë të detyruar që ta bëjnë një gjë të tillë:

- Një nxënës që ka AIDS/HIV mund të jetë në rrezik më të madh për të marrë infeksione. Nëse ka përhapje të sëmundjeve ngjitëse në shkollë të tilla si li e dhenve ose influencë, infermierja e shkollës i cili e di statusin HIV të nxënësit mund të jetë në gjendje të paralajmërojë prindin(ërit) ose kujdestarin(ërt) e nxënësit, të cilët mund të konsultohen me doktorin e tyre personal për trajtime parandaluese.
- Një nxënës i ri me infeksionin AIDS/HIV mund të marrë ilaçe që duhet të administrohen nga profesionistët e kujdesit ndaj shëndetit; atij ose asaj mund t'ju duhet t; vaksinohen ndryshe nga nxënësit e tjerë. (Shiko Administrimin e Barnave gjatë shkollës, faqe 66)

Nëse prindërit ose kujdestarët, në konsultim me doktorin e kujdesit parësor të nxënësit, vendosin të informojnë disa anëtarë të personelit të shkollë, veçanërisht infermierin e shkollës rreth statusit të AIDS/HIV-it të nxënësit, MDHP-ja rekomandon udhëzimet e mëposhtme të dhënies së informacionit:

- Prindi(ërit) ose kujdestari(ëst) ose vetë nxënësit, nën disa rrethana të caktuara, mund të informojnë direkt infermierin e shkollës.
- Duke patur parasysh mbrojtjen e fshehtësisë nga Ligji i Përgjithshëm i Massachusetts, Kapitulli 214, Pjesa 1b, i gjithë personeli i shkollës kanë të njëjtën detyrë të mbrojnë fshehtësinë e informacionit.
- Dhënia e mëtejshme e statusit HIV të nxënësit nga infermierja e shkollës anëtarëve të tjerë të personelit kërkon miratimin specifik të informuar me shkrim të prindit/kujdestarit të nxënësit.
- Doktorët e licencuar, infermieret, punonjësit socialë dhe psikologët (në përputhje me LPM, Kapitullin 111, Pjesën 70F si dhe Kapitullin 112, Pjesën 135A dhe Kapitullin 112, faqen 129A) e kanë për detyrë që të mbrojnë informacionin që ka të bëjë AIDS/HIV-in dhe informacione të tjera private. Formulari i firmosur për dhënien e informacion dhe çdo informacion tjetër që ka të bëjë me HIV/AIDS-in duhet të mbahet nga infermierja e shkollës në një dosje të mbyllur veç nga të dhënat e tjera shëndetësore për shkollën.
- Punonjësit e Shkollave Publike Worcester nuk do të bëjnë organizime për nxënësit që testohet për antitropa të HIV-it ose nuk do të ofrojnë transport për në vendin e testimit.
- I gjithë personeli i shkollës duhet të përdorë masa të përgjithshme, të përcaktuara në këtë politikë, në mënyrë që të reduktojnë rrezikun e infektimit.

SHËNIM: Kjo është vetëm një përmbledhje; udhëzimet e plota gjenden në zyrën e drejtorit, në zyrën e infermieres ose në bibliotekën e shkollës. Ju inkurajojmë ta lexoni të gjithë politikën, dhe mund të merrni një kopje duke bërë kërkesë.

Burimi: Departamenti i Shëndetit Publik të Massachusetts: Manuali i Përgjithshëm i Shëndetit në Shkollë, rinovuar në 2007.

Ndjekja e Shkollës nga Nxënëset Shtatzëna

Nxënëset shtatzëna nxiten të vazhdojnë të ndjekin shkollën. Çdo përpjekje do të bëhet për te parë që programi arsimor i nxënësës të ndërpritet sa më pak që të jetë e mundur, dhe ato do të nxiten të kthehen në shkollë pas lindjes, dhe që t' u ofrohet çdo mundësi e arsyeshme që të përfundojnë shkollën e mesme.

Në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet e Ligjit Federal të Departamenti të Arsimit për ciklin ulët dhe të mesëm të Massachusetts, nxënëseve shtatzëna në Shkollat Publike Worcester ju lejohet të qëndrojnë në klasat e rregullta dhe të marrin pjesë në aktivitetet jashtëshkollore me nxënëset që nuk janë shtatzanë gjatë të gjithë shtatzanisë së tyre. Pas lindjes, nxënësës i lejohet të kthehet në programin akademik në të cilin ajo ishte regjistruar dhe i lejohet të marrë pjesë në programet jashtëshkollore.

Distrikti nuk kërkon që një nxënëse shtatzënë të marrë raport nga mjeku për të vërtetuar që ajo është në gjendje fizike dhe emocionale të vazhdojë shkollën përveç rasteve kur kërkohet një certifikatë për të gjithë nxënësit me kushte të tjera fizike dhe emocionale të cilat kërkojnë vëmendjen e doktorit.

Procedurat 911

Në rastet e një situatë mjekësore, nëse vendimi i infermieres është që të telefonojë 911-in, atëherë administrata e shkollës duhet të ndihmojë infermierën në vendimin e saj. Nëse gjatë situatës, prindi/kujdestari është në vendngjarje dhe nuk do që të telefonohet 911-i, drejtori dhe infermiera duhet të punojnë me prindin/kujdestarin për të shpjeguar se thirrja e 911-it përcaktohet në protokoll. Nëse prindi/kujdestari thonë se ai/ajo merr përgjegjësinë për marrjen e ndihmës mjekësore për fëmijën, atëherë procedura kërkon që prindi/kujdestari të firmosë "Formularin e Heqjes Dorë nga Shërbimet e urgjencës së Shkollave Publike Worcester". Kur mbërrin ambulanca, prindi mund të ushtrojë autoritetin prindëror duke firmosur formularin e refuzimit për pacientin të dhënë nga personeli i ambulancës.

Sugjerime Udhëzuese për Përdorimin e Sigurt të Çantës së Shpinës

Rekomandimet nga Akademia Amerikane e Peditërve për zgjedhjen e duhur të çantës së shpinës përmbajnë:

- Mos mbani peshë më të madhe se 20% të peshës së trupit
- Zgjidhni një stil që ka doreza supesh të mbushura dhe rrip mesi
- Përdorni të dyja dorezat e supeve
- Shtrëngojini rripat në mënyrë çanta të jetë afër trupit
- Shpërndajeni peshën e objekteve në mënyrë të barabartë në çantën e kurrizit
- Përdorni të gjitha ndarjet
- Vendosni objektet më të rënda pranë kurrizit me qendër graviteti pranë pelvisit

Qëndrat Shëndetësore në Shkolla

Qendrat shëndetësore në shkolla ofrojnë shërbime shëndetësore për të ndihmuar mbarëvajtjen fizike dhe emocionale të nxënësve. Shërbimet përfshijnë:; ekzaminime fizike, vaksinim, kujdes shëndetësor për sëmundje të vogla, edukim dhe informacion mbi shëndetin, kontrolle laboratorike, dërgesa tek specialistët dhe përkujdesje të tjera mbi shëndetin. Qendrat janë vendosur në: Burncoat Middle School, Burncoat High School, Claremont Academy, Doherty Memorial High School, Elm Park Community School, , South High Community School, Sullivan Middle School, Woodland Academy, Worcester Technical High School, Goddard School of Science of Technology dhe North High School.

TRANSPORTI

Programi i transportit

Ofrohet transport pa pagesë në nivelet nga kopshti deri në klasën 12 për nxënësit që jetojnë dy (2) milje ose më shumë nga shkolla, te cilin ata kanë të drejtë të ndjekin. **Detyrimet ligjore të Komitetit të Shkollës në lidhje me këtë gjë janë te kufizuara në dispozitat për transportimin e femijeve te shkollës fillore, dhe Komiteti i Shkollës ka të drejtën nëse është e nevojshme t'ju detyrojë të paguani për transportin, ose të mos ofrojë transport në nivelin dytesor pavarësisht se ku mund të jetojnë nxënësit.**

Të gjithë nxënësit nga kopshti në klasën 12 që kanë të drejtë duhet të hypin vetëm në autobusin në të cilin janë caktuar për të vajtur dhe ardhur në shkollë dhe të merren e të çohen në stacionet e autobusëve të caktuar. Nxënësve do t'ju kërkohet të vijnë në këmbë deri tek stacioni i përbashkët i autobusit. Nxënësit e klasave nga kopshti deri në klasën e 6, duhet të shoqërohen nga prindërit ose kujdestarët deri tek stacioni i autobusit. Përgjegjësia e sigurisë për të shoqëruar një fëmijë nga dhe deri tek stacioni i autobusit është e prindërve dhe e kujdestarëve të nxënësit.

Prindërit ose kujdestarët e nxënësve janë përgjegjës për mbikëqyrjen deri në momentin që fëmija hipën në autobus në mëngjes dhe pasi fëmija zbret nga autobusi në fund të ditës së shkollës. Pasi fëmija të ketë hipur në autobus - dhe vetëm në atë kohë - ai bëhet përgjegjës i shkollës së distriktit. Kjo përgjegjësi mbaron kur fëmija silltet në stacionin e rregullt të autobusit në fund të ditës së shkollës. Është përgjegjësia e prindit/kujdestarit që të shoqërojë fëmijën për tek dhe nga stacioni i autobusit atje ku nuk ka trotuare, ku trotuaret janë vetëm në njërën anë, kur stacioni i autobusit është në anën e kundërt të rrugës, ose atje ku prindi/kujdestari ka shqetësime të tjera për trafikun.

Pritet që të gjithë nxënësit do të jenë jashtë në stacionin e autobusit DHJETË minuta përpara se të arrijë autobusi. Shoferët e autobusëve janë udhëzuar të MOS NDALONË nëse asnjë fëmijë nuk po pret. Nxënësit duhet të jenë të dukshëm dhe të mos jenë në makinë, dyqane ose vende të tjera ku nuk mund të shikohen lehtë nga shoferi i autobusit. Për arsye

sigurie, është shumë e rëndësishme që prindi ose kujdestari të jetë tek stacioni i autobusit për të marrë fëmijën në shtëpi.

Fëmijët në kopsht të cilët transportohen do të marrin një etiketë identifikimi në shkollën e tyre për tu siguruar që ata të mos lihen të lirë nga autobusi i shkollës pa prezencën e një prindi/kujdestari. Nxënësit që nuk lirohen nga autobusi i shkollës për shkak se nuk ka prind/kujdestar prezent do të çohen në Quinsigamond School, 14 Blackstone River Road me numër tel (508) 799-3502 që të merren nga prindi ose kujdestari.

Nxënësve të cilëve ju janë dhënë karta autobusi nëpërmjet shkollës së mesme duhet që ta mbajnë kartën me vete gjatë të gjithë kohës kur hipin në autobus dhe duhet t'ia tregojnë shoferit për ta parë, në qoftë se jua kërkon. Vetëm nxënësit me karta të vlefshme do të lejohen të hipin në autobusin e shkollës.

E drejta për të përdorur transportin bazohet vetëm mbi adresën e shtëpisë së nxënësit dhe është vetëm për transportin ndërmjet stacionit të autobusit të shtëpisë së nxënësit dhe shkollës që ndjek nxënësi.

Do të ofrohet edhe transport me shpenzimet e qytetit për fëmijët Plani Individual i Edukimit të të cilëve kërkon transport.

Do të ofrohet transport pa pagesë atje ku për shkak të projekte të mëdha afatgjata të ndërtimit rruga e caktuar krijon rreziqe. Kjo gjë do të aplikohet vetëm për sa kohë që zgjat projekti.

Privilegjet e Transportit me Autobus

Duke patur parasysh se autobusi është një vazhdim i klasës, Shkollat Publike Worcester do të kërkojnë që çdo nxënës të sillet në përputhje me Kodin e Sjelljes dhe Rregullat e Sigurisë dhe të Sjelljes për Nxënësit që përdorin autobusët e shkollave sikurse është përcaktuar në manualin për nxënësit. Shoferët e autobusëve të shkollës kanë autoritetin dhe përgjegjësinë që të mbajnë rregull ndërkohë që drejtojnë autobusin. Shoferët e autobusëve janë udhëzuar të informojnë drejtorin e ndërtesës rreth çdo sjellje të pahijshme të nxënësve që krijojnë shqetësim, ose i terheqin vëmendjen shoferit, kur nget autobusin. Drejtori i ndërtesës do të informojë prindërit/kujdestarët për sjelljen e pahijshme dhe do të kërkoj bashkëpunimin e tyre në monitorimin e sjelljes së fëmijës. Çdo nxënës i cili bëhet problem për disiplinën në autobusin e shkollës mund t'i pezullohet e drejta e përdorimit të autobusit përkohësisht ose për gjithnjë. Në raste të tilla, prindërit/kujdestarët e fëmijës së përfshirë janë përgjegjës që ta marrin dhe çojnë fëmijën në shkollën në mënyrë të sigurt.

Autobuzat e Shkollave Publike Worcester mund të jenë të pajisur me kamera për të filmuar dhe incizuar çdo udhëtim. Materiali mund të përdoret për të ndihmuar drejtorin e shkollës që të përcaktojë ç'fare mase disiplinore, nëse ka ndonjë, është e përshtatshme në rastet e shkeljeve të raportuara të praktikave të udhëtimit të sigurte. Ai mund të përdoret

gjithashtu si vegël që të gjithë studentet të mesojnë dhe përforcojnë praktikën e udhëtimit të sigurtë.

Si gjithnjë siguria është e një rëndësie parësore. Tek stacioni i autobusit dhe në autobusin e shkollës, nxënësit duhet të sillen mirë dhe të bashkëpunojnë gjatë gjithë kohës.

Nxënësit e Transferuar

Do të ofrohet transport për nxënësit e transferuar vetëm nëse transferimi i tyre ka ndikim pozitiv mbi planin e miratuar të shtetit për ç'izolim.

Të Pastrehët

Referojuni shërbimeve të transportit përshkruar në faqen 27 në pajtim me Edukimin e Fëmijëve të Pastrehë.

Kufiri prej dy Miljesh

Matja prej dy miljesh është distanca më e shkurtër automobilistike midis rrugicës ose rruginës më të afërt të shtëpisë së nxënësit deri tek rrugina ose porta që të çon tek dera kryesore e shkollës.

Ndalesat dhe Rrugat e Ndjekur nga Autobusi i Shkollës

Nxënësit do të ecin deri tek stacioni i përbashkët i autobusit. Stacioni i autobusit do të vendoset, miratohet dhe verifikohet vetëm nga Departamenti i Transportit të Shkollave Publike Worcester. Nxënësit nuk kanë të drejtë të merren ose të sillen rrugicë më rrugicë ose derë më derë. Të gjitha ndalesat do të jenë në cepa, kurdo here që të jetë e mundur për ta bërë këtë gjë më të drejtë dhe konsistente për të gjithë. Të gjitha kërkesat për ndalesa autobusi apo ndryshime shtesë duhet të bëhen nëpërmjet Drejtorit të shkollës apo mëkëmbësit të tij. Prindërit ose kujdestarët janë përgjegjës për tu siguruar që fëmijët e tyre ndodhen në stacionin e saktë të autobusit. Çdo fëmijë që qëndron në vendet e paautorizuara ose stacionet e autobusit, që nuk janë caktuar nga Departamenti i Transportit, nuk do mund të hypin në autobus. Mos mendoni që stacionet e autobusëve do të jenë në të njëjtin vend si dhe vitin e mëparshëm, pasi ato mund të ndryshojnë për shkak të vendbanimit dhe popullatës së nxënësve. Shoferët e autobusëve të shkollës nuk lejohen të bëjnë ndryshime, shtesa ose heqje të asnjë stacioni autobusi. Ndërkohë që ligji kërkon që departamenti i shkollës të ofrojë transport për ata nxënës të cilët janë brenda udhëzimeve, kjo gjë nuk i heq përgjegjësinë prindit apo kujdestarit për të mbikëqyrur fëmijën deri sa fëmija të hipi në autobus në mëngjes dhe pasi fëmija të ketë zbritur nga autobusi në fund të ditës. Pasi fëmija të ketë hipur në autobus, vetëm nga ky moment ai/ajo është nën përgjegjësinë e shkollës së distriktit. Kjo përgjegjësi mbaron kur fëmija sillet në stacionin e rregullt të autobusit në fund të ditës së shkollës.

SIGURIA DHE SJELLJA

Përdorimi i autobusëve të shkollës

Rregullat e mëposhtme të sigurisë dhe të sjelljes për nxënësit që përdorin autobusët e shkollës janë publikuar si udhëzime për nxënësit që kanë të drejtën të përdorin transportin e ofruar nga Shkollat Publike Worcester. Një shkelje e këtyre rregullave mund të çojë në humbjen e privilegjit të përdorimit të autobusit.

1. Vetëm nxënësit e caktuar dhe personeli i caktuar ishshkollës, do të lejohen të hyjnë në autobus, si dhe me përjashtim të rasteve kur është dhënë leje nga Departamenti i Transportit.
2. Nxënësit duhet të hyjnë në pikën e marrjes në orarin e caktuar dhe të përgatiten të zbesin nga autobusi duke mos u vonuar në mënyrë që autobusi të funksionojë në orar.
3. Kur ndodhet në një pikë hyrje-zbritje në autobus nxënësi duhet:
 - Të sillet mirë
 - Të mos qëndrojë në rrugë
 - Të respektojë të drejtat e pronave pranë
 - Të qëndrojë të paktën tetë (8) këmbë larg nga autobusi kur ndalon për të hipur dhe të shkojë në drejtim të autobusit vetëm kur hapen dyert
4. Nxënësit duhet të hyjnë vetëm në autobusin në të cilin ata janë caktuar rregullisht.
5. Nxënësi duhet të ulet menjëherë pasi të hyjë në autobus dhe të qëndrojë ulur për sa kohë autobusi është në lëvizje.
6. Nxënësit nuk do të hapin ose mbyllin dritaret përveç rasteve kur ju kërkohet nga shoferi ose mbikëqyrësi i autobusit. Nxënësit duhet që krahët dhe kokën ta mbajnë brenda autobusit.
7. Ndërkohë që është pasagjer në autobus, nxënësi nuk duhet të:
 - pijë duhan
 - të hedhë sende në autobus ose jashtë dritares
 - të shqetësojë shoferin ose nxënësit e tjerë
 - bej plehra
 - të bëjë zhurmë të lartë ose të panevojshme
 - të hajë ose të pijë
 - të transportojë sende që mund të rrezikojnë shëndetin ose sigurinë e çdo pasagjeri tjetër
 - të dëmtojë ose shkatërrojë çdo pjesë të autobusit
8. Nxënësit duhet të qëndrojnë të qetë kur i afrohen kryqëzimeve hekurudhore.
9. Nxënësit që dalin nga autobusi duhet të kalojnë dhjetë (10) këmbë para autobusit dhe të shikojnë në të dyja drejtimet para se të kalojnë rrugën.
10. Në raste urgjence gjatë udhëtimit, nxënësit duhet të qëndrojnë në autobus përveç rasteve kur ju kërkohet të dalin nga shoferi i autobusit.

11. Pasi të dalin nga autobusi, nxënësit duhet të hyjnë në shkollë direkt për arsye sigurie.
12. Një nxënës të cilit i është dhënë një kartë identifikimi nga autoriteti i shkollës duhet ta mbajë këtë kartë me vete gjatë gjithë kohës dhe ta tregojë ku ja kërkojnë.
13. Shoferët/mbikëqyrësit e autobusëve duhet të raportojnë shkelje të rregullave dhe rregulloreve të mësipërme tek zyrtarët e shkollë nëpërmjet Formularit të Sjelljes në Autobus. Hypja në autobus është një privilegj që mund të hiqet përkohësisht ose përherë bazuar në sjelljen e nxënësit.

Siguria në Laboratorët Shkencore

Mesimedhenia e lendeve shkencore bëhet duke përdorur metoda kerkimore në Shkollat Publike Worcester. Kjo gjë mund të bëhet në mënyrë të sigurt vetëm me bashkëpunimin e nxënësve që ndjekin udhëzimet e mësuesit dhe procedurat. Është përgjegjësia e nxënësit të silltet siç duhet në laborator. Nxënësit duhet që:

- Të nënshkruajnë një kontratë sigurie e cila thekson përgjegjësitë e tyre në laboratorët shkencore;
- Prindërit/kujdestarët të nënshkruajnë kontratën që të njohin këto përgjegjësi;
- Të dinë masat që duhen marrë në raste aksidentesh;
- Të njohin procedurat e evakuimit në rast emergjencash; dhe
- Të përdorin pajisje (doreza, përparëse, maska, etj.) sipas udhëzimeve.
- Ushqimet dhe pijet nuk lejohen në laborator.

Masat e Sigurisë

Kufizimit Fizike

Bordi i Edukimit ka adoptuar rregulla të reja mbi përdorimin e mposhtjes fizike në programet e edukimit publik. Rregullat (603 CMR 46.00) kanë për qëllim të promovojnë sigurinë për të gjithë nxënësit. Mposhtja fizike përfshin mposhtjen e prirur, atje ku lejohet, duhet të konsiderohet si një procedurë emergjente e mjetit të fundit dhe të ndalohet në programet e edukimit publik përveç rastit kur sjellja e nxënësit paraqet kërcënim sulmi, ose dëm të pashmangshëm të rëndë fizik për vete ose për të tjerët dhe kur nxënësi nuk është i përgjegjshëm ndaj direktivave verbale ose ndërhyrjeve të tjera ligjore dhe sjelljeve ndërhyrëse më të lehta, ose kur intervenime të tilla konsiderohen të jenë të papërshtatshme në këto rrethana. Mposhtjet mekanike, mjekimet, dhe izolimet janë të ndaluara në programet e edukimit publik.

Rregullat e ndryshuara u aprovuan nga Bordi i Edukimit të Arsimit Fillor dhe të Mesëm në 16 Dhjetor, 2014, dhe do të hyjë në fuqi në 1 Janar, 2016, 603 CMR 46.00 mund të gjendet në <http://www.doe.mass.edu/lawsregs/603cmr46.html>.

Dollapët e Nxënësve

Të gjithë dollapët e nxënësve janë pronë e Shkollave Publike Worcester. Përdorimi i dollapëve nga nxënësit është rregulluar nga administrata e shkollës dhe të gjithë dollapët mund të inspektohen nga administrata e shkollës kur shikohet e përshtatshme.

Çdo nxënësi që i caktohet një dollap duhet të përdorë bravën e dhënë nga shkolla. Administrata do t'i heqë të gjitha bravat që nuk janë lëshuar nga shkolla. Nëse një dollap nuk përdoret/nuk është caktuar, administrata do ta mbyllë ate me çelës.

Nxënësit duhet të mbajnë telefonat celularë, çantat e librave, çantat e fizikuturës, veshjet e rënda (pallto dhe xhupa) në dollapët e tyre gjatë ditës së shkollës.

Për arsye sigurie, nxënësit nuk do të lejohen të mbajnë veshje e rënda (pallto dhe xhupa) gjatë ditës së shkollës. Nxënësit të nivelit të shkollave tetevjeçare do të lejohen të mbajnë çanta shkolle-shpine por që janë material transparent ose rrjete.

Çdo lloj arme dhe/ose droge ose sende ose substanca të tjera të ndaluara të gjetura në dollap, dhe që shkelin rregullat e shkollës mund të konsiderohet të jetë pronë e nxënësit të cilit i është caktuar dollapi për qëllime të masave disiplinore sipas këtij kodi.

Takimi me nxënësit gjatë orarit të shkollës

Zyra Ligjore e Departamentit të Edukimit Parësor dhe Dytesor ka mbështetur politikën aktuale për Shkollat Publike Worcester, në lidhje me lejimin e personave që të takohen me nxënësit gjatë orëve të shkollës pa lejen e prindërve.

Personave të mëposhtëm mund t'ju jepet e drejta të takohen me nxënësit gjatë orarit të shkollës:

1. Prindit kujdestar (prindit me të drejtën ligjore me shume se 50%) ose kujdestarit ose personave ose agjencive të autorizuara ligjërisht të veprojnë në emër të fëmijës në vend të ose për babain, nënën ose kujdestarin. Në përputhje me Ligjin e Përgjithshëm të Massachusetts, Kapitullin 71, § 34H prindi pa të drejtë ligjore kujdestarie duhet t'i paraqesë një kërkesë me shkrim drejtorit të shkollës për një takim të tillë. Për më shumë informacion, kontaktoni drejtorin e fëmijës tuaj.
2. Një nxënës i moshës 14 vjeçe pasi të ketë hyrë në klasën e 9-të, mund të bjerë dakord që të takohet me një individ.

Personeli i mëposhtëm mund të takohet me nxënësin gjatë kryerjes së detyrës së tij zyrtare:

1. Administratorët e shkollës, mësuesit dhe këshilltarët të cilët punojnë direkt me nxënësit.
2. Personeli administrativ i zyrave dhe personeli nëpunës të cilët përpunojnë informacionin për regjistrimet e nxënësve.
3. Ekipi i Vlerësimit i cili vlerëson nxënësin.
4. Personeli shëndetësor i shkollës kur një takim i tillë kërkohet për të kryer detyrat e tyre.
5. Palët përkatëse, përfshi departamentin lokal të policisë dhe Departamentin e Fëmijëve dhe të Familjeve (DCF), në lidhje me një emergjencë për shëndetin apo sigurinë, përfshi raporte mbi armët, nëse njohja e informacionit është e nevojshme për të mbrojtur shëndetin apo sigurinë e nxënësve apo individëve të tjerë.
6. Punonjësit e Departamentit të Fëmijëve dhe Familjeve të cilët hetojnë çështje të abuzimeve ndaj fëmijëve, mund të lejohen të intervistojnë një fëmijë pa lejen e

prindërve nëse ndodh që fëmija mund të vihet në rrezik të mëtejshëm po te njoftohet prindi. Kjo intervistë mund të bëhet në prezencë të një mësuesi ose të një profesionisti tjetër të shkollës për t'i dhënë ndihmë dhe përkrahje fëmijës.

7. Punonjësit e Departamentit të Lirimit me Kusht, Departamentit të Shërbimeve për të Rinjtë ose një punonjës nga Byroja e Hetimeve të Veçanta mbi mashtrimet e ndihmave sociale.

Nëse keni ndonjë urdher ndalimi nga gjykata për fëmijën tuaj, është e detyrueshme që Shkollat Publike të Worcester-it të kenë një kopje në arkiv në mënyrë që ne të zbatojmë urdhrat e gjykatës.

Vizitorët në shkolla

Në të gjitha Shkollat Publike Worcester ka tabela që kërkojnë që të gjithë vizitorët të raportojnë në Zyrën e Drejtorit. Kjo gjë siguron që administrata e shkollës e di se kush po viziton godinën, arsyen për vizitën dhe nëse koha e vizitës është e përshtatshme.

Procedurat e mëposhtme për regjistrimin e hyrjes të cilave duhet t'i nënshtroheni pasi të keni hyrë në godinën e shkollës:

- Hyni nga dera kryesore (disa shkolla kanë sistem Intercom-i i cili ju lejon të hyni pasi t'i bini ziles dhe të identifikoni veten)
- Shkoni menjëherë tek zyra e recepsionit
- Ju lutemi firmosni në regjistër
- Vendosni etiketën e vizitorit në një vend të dukshëm në veshjen tuaj
- Prisni për udhëzime të tjera nga punonjësja e shkollës ose administratori se si duhet të shkoni në zonën përkatëse të vizitave apo në klasën përkatëse

Çdo lloj hyrjeje tjetër në godinën e shkollës nga vizitorë do të konsiderohet hyrje pa leje. Personave që futen pa leje në godinë do t'ju kërkohet menjëherë që të largohen, dhe nëse ata refuzojnë, do të kontaktohen forcat lokale të rendit për ndihmë. Ligji për hyrjen pa leje do të zbatohet në përputhje me këtë politikë.

Përdorimi i automjeteve

Nxënësit kanë të drejtën të sjellin automjetet në shkollë për sa kohë ata respektojnë sigurinë e të tjerëve dhe i binden këtyre rregullave bazë:

1. Automjetet duhet të parkohen në zonat e parkingeve të caktuara për nxënësit.
2. Nxënësit të cilët largohen nga territori me automjete gjatë orarit të shkollës pa ndjekur procedurat e përcaktuara të marrjes së lejes, do të pezullohen.
3. Nxënësit duhet t'i ngasin automjetet ngadalë dhe me kujdes brenda ose afër territorit të shkollës, duke patur gjithnjë parasysh se këmbësorët kanë përparësi.
4. Nuk mund të shkohet tek makina gjatë ditës së shkollës përveçse me miratimin e drejtorit.
5. Privilegjet e parkimit do të hiqen ose pezullohen për arsyet e mëposhtme:
 - a. Shpejtësi më të lartë se 15 milje në orë

- b. Çdo lloj akti që rrezikon jetën ose pronën ndërkohë që janë në territorin e shkollës.
- c. Parkimi në vende të tjera përveç parkingeve për nxënësit.
- d. Privilegjet e parkimit nuk do të jepen, pa u regjistruar dhe pa marrë leje për parkim nga shkolla.

SHËRBIMET E NXËNËSVE

Departamenti i Studimit të Fëmijëve

Departamenti i Studimit të Fëmijëve përbëhet nga Psikologët e shkollave, Këshilltarët e Përshtatshëm të Shkollave të cilët ndihmojnë nxënësit e dërguar për arsye të vështirësive që ata kanë në rezultatet mësimore, shoqërore dhe nësjellje. **Dërgimi i një formulari referues tek Departamenti i Studimit të Fëmijëve nuk përbën dërgim për Vlerësim nga Komisioni për Edukim të Posaçëm.**

Shërbimet e Departamentit të Studimit të Fëmijëve përfshijnë:

- Konsultim bashkëpunimi me mësuesit
- Këshillim individual ose në grup - (dygjuhësor dhe njëgjuhësor) Vlerësim Individual
- Bashkëpunim me shërbimet e agjensive të komunitetit
- Shërbimet e menaxhimit të ceshtjeve dhe drejtimit
- Konsulta me prindërit, mbështetje dhe dërgim tek burimet e duhura të bazuara në komunitet
- Mbikëqyrje e frekuentimit të shkollës
- Ndermjetesim
- Pjesëmarrje në SSP dhe komitetet 504 siç kërkohet nga drejtori i godinës
- Vlerësime të rrezikut/vdekjeprurëse
- Shërbime të stabilizimit dhe ndërhyrjes në kriza
- Menaxhim i specializuar, koordinim shërbimesh dhe ndihmë për nxënësit nën kujdesin e DCF-së dhe atyre të pastrehë.
- Koordinimi, trajnim dhe mbështetje të nismës PBIS e distriktit

Plani 504-Dekreti mbi Amendamentin për Amerikanet Me Aftësi të Kufizuara

Eshtë në rregulloren e SHPW të mbeshtesë Nenin 504 të Dekretit mbi Amendamentin për Amerikanet me Aftësi të Kufizuara (ADAA, 2008) në të gjitha aspektet e tij duke përfshirë si programet akademike edhe aktivitetet jashtëshkollore.

Dekreti mbi Rehabilitimin i 1973, që njihet edhe si "Neni 504" është ligji i Mos-diskriminimit i miratuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Qëllimi i këtij ligji është që të ndalojë diskriminimin nga institucionet që marrin fonde federale dhe për të siguruar që studentët e kualifikuar si me aftësi të kufizuara kanë mundësi arsimimi dhe përfitime të

barabarta me ato të parashikuara për studentët pa aftësi të kufizuara. Neni 504 kërkon që shkolla të sigurojë një arsim të përshtatshëm falas (FAPE) për studentët të kualifikuar me aftësi të kufizuara që kanë një dëmtim fizik ose mendor që në thelb kufizon një ose më shumë aktivitete jetësore.

Një nxënës me aftësi të kufizuara sipas nenit 504 është një nxenes i cili:

- a) Ka një dëmtim fizik ose mendor që si rezultat kufizon një ose më shumë aktivitete jetësore
- b) Ka një rekord të tillë dëmtim
- c) Konsiderohet të ketë një dëmtim të tillë

Aktivitetet kryesore jeteosre përfshijnë por nuk kufizohen, vetëm në kujdesin për veten, kryerjen e detyrave manuale, shikuar, dëgjuar, ngrënie, fjetje, ecje, qendimi në këmbë, ulja, e folura, marrë frymë, të mësuarit, të lexuarit, të përqëndruar, të menduarit, komunikimi, dhe duke punuar.

Sipas Dekretit të Ligjit ADA, nëse një dëmtim i ndjeshëm kufizon një aktivitet të jetës duhet të përcaktohet pa iu referuar efekteve të masave lehtësuese përmirësues. Kjo do të thotë se shkolla nuk mund t'i konsiderojmë përmirësues efektet e masave zbutese me përjashtim të syze dhe lentet e kontaktit-në përcaktimin nëse dikush kualifikohet si me aftësisë së kufizuar.

Mënyra e kualifikimit

Nëse beson se fëmija juaj kualifikohet për akomodimet e Nenit 504 dhe do të kesh njohuri më shumë për programet dhe aktivitetet në SHPW, ju lutemi kontaktoni Drejtorin e shkollës ku fëmija juaj meson. Megjithatë nuk është e kërkuar, do ishte mire që të sillni me vete dokumentat mjekësore ose dokumenta të tjere në mbështetje të diagnostikimit të fëmijes me aktivitetet të kufizuara kur të takoheni me drejtorin. Drejtori ose ai/ajo që është urdheruar nga drejtori të zëvendësojë atë, do të shikoj problemin dhe do të përmbledhi të dhënat nga mesuesit, infermierja e shkollës, prinderit ose të tjere që punojnë me fëmijën. Të gjitha këto informacione do të ndimohen komisionin e Nenit 504 të vendosi nëse dhe se si dëmtimi i fëmijes tuaj limitizon aktivitetet e jetës. Gjithashtu specialistat e shkollës mund të konsultohen. Nëse do duhet një evaluim nga specialist, juve do të duhet që të firmosni një deklaratë që ky evaluim të bëhet në shkollë po që juve nuk do tju kushtoj. Kur të jenë grumbulluar të gjitha të dhënat dhe informacionet komisioni i Nenit 504 do të takohet me ju të vendosi të drejtat e nxënësit nën Nenin 504 dhe do të zhvillojë një plan për të akomoduar i përshtatshëm për fëmijën tuaj. Nëse është vendosur që fëmija juaj nuk mund të konsiderohet i tillë, juve do tju jepet me shkrim vendimi, dhe informacione të mëtejshme për të drejtat tuaja.

Kush mund të ketë të drejta nën Nenin 504?

Nxenesit mund të kenë të drejta për akomodime ose shërbime të ngjashme për disa arsye. Keto me poshtë janë shembuj të nxenesve që mund të kenë të drejta nën Nenin 504 po që varen në shkollën në të cilën aftësia e kufizuar nderhyn në aktivitetet e përditshme të jetës.

- Nxenes që ka mungesë degjimi
- Nxenes që kanë azem
- Nxenes që janë diagnostikuar me ADD/ADHD

- Nxenes me artrit reumatoid per te mitur
- Nxenes me Crohn disease

Masat Kryesore qe duhet të marrë Distrikti i shkollës

Duhet te merret në konsideratë që çdo nxënës për arsye të aktivitetit të kufizuar ka nevojë ose besohet të ketë nevojë për edukim special ose sherbime të ngjashme në mënyrë që të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet në mënyrë të ngjashme me ata të nxënësve të të njëjtës moshë të cilët nuk kanë kufizime të tilla.

Vleresimi do te behet nga mbledhja dhe analazimi i te dhenave te ngjashme te ndikimit qe ka kufizimi i aftesive ne pjesmarrjen ne kurrikulum te nxenesit, mesimin, mundesit sociale qe kompromentojne programet edukative.

Gjithashtu, SHPW duhet "identifikoj dhe lokalizoj te gjithe invalitet midis moshes 3 dhe 22 qe banojne ne distriktin qe nuk ka edukim publik". 3.4CFR104.32(a).

Po ashtu, SHPW duhet te ndjeke hapat e duhur to lajmeroj nxenesit me aktivitet te kufizuar dhe prinderit e tyre ose kujdestaret per keta femije. 34CFR 104.32 (b) Te Drejta tuaja sipas Nenit 504,mund te kerkohen me shkrim nga shkolla e femijes tuaj ose ne faqen elektronike te shkolles: www.worcesterschools.org

Personat pergjegjes per Nenin 504 ne shkollen tuaj jane

<u>Burncoat Quadrant</u>	
Burncoat High	Felicity Boisvert
Burncoat Middle	Jane McNamara
Burncoat Prep	Carmen R.Martinez
Clark Street	Janet Campaniello
Lincoln Street	Donna Fluhr
McGrath	Paula Severin
Norrback	Tabitha Kahura
Thorndyke Road	Lisa Fallavollita
Wawecus Road	Joanna Loftus Rachel Kodra/Heidi
Worcester Arts	Fedorczuk

<u>Doherty Quadrant</u>	
Doherty High	John O'Malley/Chris Whalen
Forest Grove	Fred King/Meg Fisher
Chandler Elem	Marvin Negron
Chandler Mag	Christina Guertin
Elm Park	Kendra Cox
Flagg Street	Patricia Henningson
Jacob Hiatt	Maureen Power
May Street	Luke Robert
Midland Street	Michele Lodowsky
Nelson Place	Deb Daley
Tatnuck Mag.	Caryn McCrohon/ Kim McLaren
West Tatnuck	Steve Soldi

<u>North Quadrant</u>	
North High	Kareem Tatum
Worcester Tech	Heather Courtney
Worcester East	Stacy Homan
Belmont Street	Kelly McNamara ChristineDowel/
City View	Yeu Kue
Grafton Street	Collern Boria
Lake View	Colleen Yoska
Rice Square	Ann Dalianis
Roosevelt	Cindy Cramer
Union Hill	Alan Pettway

Head Start	Darlene Donaldson
------------	-------------------

<u>South Quadrant</u>	
Claremont	Terrence Fontaine
South High	Janelle Person
Sullivan Middle	Kate Maloney
University Park	Lauren Colwell
New Citizens Ctr.	Steve Alzamora
Canterbury St.	Alwinda Melendez
Columbus Park	Kathy Martinelli
Gates Lane	Christine Pappas School Adjustment Counselor
Goddard	Carolyn Armitrano
Heard Street	Triada Frangou- Apostolou
Quinsigamond	Carenza Jackson
Vernon Hill	Patricia Padilla
Woodland	

<u>Programet Alternative</u>			
Shkolla Alternative	Michael O'Neil	Reach/Challenge Acad.	Daisy Rivera
Gerald Creamer Ctr.	Kelly Denault		

Personi qe ka per deturi te siguroj qe distrikti permbush te gjitha kerkesat e Nenit 504 eshte Bertha Elena Rojas, (508) 799-3623 ose rojasbe@worc.k12.ma.us. Ju lutem kontaktoni Dr. Rojas nese keni ndonje pyetje ne lidhje me Nenin 504

Edukimi i Posaçëm

Një vazhdimësi e plotë e shërbimeve të Edukimit të Posaçëm ju ofrohet nxënësve me paaftësi nga mosha 3 deri 22 vjeç (që nuk kanë marrë diplomën të shkollës së mesme) të cilët janë cilësuar me një paaftësi që kërkon edukim të posaçëm.

E drejta e nxënësit për një "Edukim Publik të Posaçëm Falas në një mjedis sa më pak të kufizuar" me 'qasje të plota programin e përgjithshëm arsimore" udhëheqin të gjitha vendimet e komisionit.

Caktimi dhe transferimi i nxënësve me paaftësi të regjistruar në programe thellësisht të ndara

Nëse një Komision i PEI përcakton se një nxënës duhet vendosur në një "program krejtësisht të ndarë", nxënësi do të caktohet në një shkollë e cila i ka programet e caktuara në zonën në të cilën ai banon. Nëse nuk ka një program të tillë në zonën e banimit, ose

programi nuk ka vende, nxënësi do të caktohet "jashtë zonës" në një shkollë të identifikuar nga Departamenti i Edukimit të Posaçëm në bashkëpunim me Departamentin e Transportit.

Nëse një nxënës ka nevoja mjekësore, të cilat kërkojnë vendosjen e tij në një ndërtesë me lehtësira dhe/ose shërbime mjekësore, ai/ajo mund të caktohet jashtë zonës.

Nëse një nxënës është caktuar jashtë zonës për shkak se nuk ka vende bosh, ai/ajo do të ricaktohet në shkollat e zonës vitin pasardhës shkollor nëse pritet që të ketë vende bosh. Familjet do të njoftohen për këtë politikë në mbledhjen me ekipin. Mund të bëhen përjashtime mbi ricaktimet nëse nevojat unike të nxënësve nuk mund të përmbushen në shkollën ekzistuese.

Në rast se një nxënës hyn në vitin e fundit në shkollën ekzistuese, ai/ajo mund të qëndrojë aty nëse mund të organizohet transporti pa patur nevojë për burime shtesë. Nëse nuk është e mundur që të transportohet nxënësi, ai duhet të transferohet në zonën ku banon nëse ka vende të lira në program. Nëse një nxënës hyn në vitin e tij/saj të fundit në shkollën ekzistuese dhe i nevojitet transporti i posaçëm si rezultat i paafësisë së tij/saj në përputhje me PEI, komisioni i PEI-së mund të marrë parasysh alternativa vendosjeje dhe nevojën për të vazhduar transportin e posaçëm.

Nëse një nxënës largohet nga zona ku banon përpara 1 Tetorit, atij/asaj do t'i caktohet një shkollë në një zonë të re, nëse ka vende të lira.

Nëse një nxënës largohet nga zona ku banon pas 1 Tetorit, ai/ajo duhet të lejohet të qëndrojë deri në mbarim të vitit shkollor në pajtim me politikën ekzistuese të Shkollave Publike Worcester. Detyrat që i përkasin kësaj politike nuk duhet të konsiderohen si vendosje në edukimin e posaçëm.

Informacioni dhe procedurat e punësimit

Lejet e punësimit (për moshat 14-18 vjeç) lëshohen në nëntë (9) shkollat e mesme për nxënësit e regjistruar në këto shkolla. Nxënësit e tjerë mund t'i marrin lejet ose certifikatën në Zyrën e Informacionit të Prindërve në adresën 768 Main Street nga ora 8:30 deri 16:00 nga e hëna deri të premten gjatë gjithë vitit. Nxënësit të cilët nuk ndjekin shkollat publike duhet të paraqesin prova të datës së lindjes kur aplikojnë për certifikatë ose leje.

Që nga data 3 janar 2007 të gjithë personat nën moshën 18 vjeç duhet të marrin një leje pune përpara se të fillojnë një punë të re (L.P.M. k. 149 § 86-89). Aplikimet për leje pune dhe informacioni i plotë mbi kufijtë ligjore të orëve të punës dhe kushtet e punësimit mund të merren nga Drejtoria e Sigurisë Profesionale në Departamentin e Punës së Massachusetts në faqen: <http://www.mass.gov/dos/youth/index.htm>

Kufizimet mbi punën

Të miturit nën moshën 14 vjeç nuk mund të punojnë

Ka disa përjashtime në këtë rregull si shitja e gazetave, puna në ferma dhe në art (me leje të posaçme).

Edukimi në Shtëpi dhe Spital

Çdo nxënës i cili do të jetë i mbyllur në spital ose në shtëpi dhe që frekuentohet nga një mjek për katërbëdhjetë (14) ditë shkolle ose një periudhë më të gjatë si rezultat i gjendjes së tij mjeksore kualifikohet për këtë shërbim. Keni parasysh që për nxënësit e sëmurë kronikë, katërbëdhjetë ditët nuk ka nevojë të jenë harmonike, por duhet të rezultojnë nga diagnozë së deklaruar.

Mësimi në shtëpi ose në spital është një shërbim i ofruar nga Shkollat Publike të Worcester-it dhe i kërkuar nga mjeku në përputhje me rregullat e shtetit. Një Formulari i Deklaratës së Mjekut duhet plotësuar nga mjeku që frekuentues dhe duhet të përfshijë të paktën, informacionin e mëposhtëm.

1. datën në të cilën nxënësi u pranua në spital ose qëndroi në shtëpi
2. arësyen mjeksore për qëndresën
3. kohëzgjatjen e pritshme të qëndresës
4. nevojat mjeksore të nxënësit që duhen marrë parasysh në planifikimin e shërbimeve edukative në shtëpi ose spital.

Prindërit /Kujdestarët duhet të njoftojnë drejtorin e shkollës së fëmijës së tyre , këshilltarin udhëzues ose infermierin e shkollës menjëherë nëse kërkohet ky shërbim në Shtëpi dhe në Spital. Programi fillon menjëherë pasi mjeku të ketë kërkuar Mësimin në Shtëpi ose Spital me anë të formularit të detyrueshëm-nga-shteti Deklarata e Mjekut. Në momentin kur Departamenti i Spitalit dhe Shtëpisë merr Deklaratën e Mjekut të plotësuar, do të caktohet një mësues që t'i japë mësim nxënësit dhe mësuesi do të kontaktojë shtëpinë për të caktuar oraret e mësimeve. Mësuesja e shtëpisë dhe spitalit do të kontaktojë këshilltarin udhëzues për detyrat dhe librat e nxënësit të shkollës 8-vjeçare dhe të mesëme, dhe drejtorët dhe mësuesit e klasës, për të marrë detyrat dhe librat e nxënësit në shkollën fillore.

Arsimimi në shtëpi

Prindërit/kujdestarët të cilët zgjedhin që të arsimojnë fëmijët e tyre në shtëpi, sikurse e lejon ligji i Massachusetts, mund të përmbushin kërkesat e statutit të ndjekjes së detyrueshme nëse Shkollat Publike Worcester e rishikojnë programin e tyre arsimor më përpara. Lajmërimet për arsimimin në shtëpi (versionet për ciklin fillestar dhe sekondar) mund të merret duke bërë kërkesë në zyren e Departamentit të Studimit të Nxënësit në numrin (508) 799-3175.

Prindërit pritet të paraqesin evidencë të arsimimit në shtëpi një herë në vit. Nxënësit që përfundojnë shkollën e mesme nëpërmjet programit arsimor në shtëpi nuk do të kenë të drejtë të marrin diplomën e Shkollave Publike të Worcester-it.

Një nxënës i cili edukohet nëpërmjet arsimit në shtëpi ka të drejtë të marrë pjesë në aktivitetet jashtëshkollore (psh. sporte, klube) me aprovimin e Kryeinspektorit ose mëkëmbësi.

Distrikti rezervon të drejtën të lejojë nxënësit të regjistrohen dhe të kenë preçedencë ose prioritet mbi nxënësin që arsimohet në shtëpi në lidhje me vendosjen në ekipet sportive dhe aktivitetet që kanë regjistrim të kufizuar. Me aprovimin e Kryeinspektorit ose mëkëmbësit, dhe në konsultim me Drejtorin, një nxënës që arsimohet në shtëpi mund të marrë pjesë në ekipet sportive dhe aktivitetet që kanë regjistrim të kufizuar për shkak se ai ose ajo nuk zhvendos një nxënës të regjistruar. Nxënësit që arsimohen në shtëpi që aplikojnë të marrin pjesë në sporte të sponsorizuara nga distrikti duhet të ndjekin direktivat e Kualifikimit për Atletikën të përshkruara në faqen 49.

RREGULLAT E MËSIMDHËNIES

Rregulli i Detyrave të Shtëpisë

Komiteti i Shkollës mendon se kërkohet një studim dhe përgatitje e arsyeshme e nevojshme për përpërimin shkollor të të gjithë nxënësve. Komiteti mendon se masa e përgatitjes duhet të rritet ndërsa fëmija kalon nga klasa në klasë. Mesuesit do të bëjnë të sigurtë që detyrat të mbështesin programin e distriktit.

Detyrat e shtëpisë kuptimplote janë të lidhura me shpresat që distrikti ka për përmirësimin e përgatitjes akademike, gadishmerine për kolegjet dhe gadishmerine për punë.

Prinderit/ kujdestaret janë bashkëpunëtorë të rëndësishëm. Ata mund të ndihmojnë suksesin e studentit duke:

- siguruar që nxënësi i mbaron detyrat e shtëpisë;
- kontrolluar punën për të siguruar cilësinë;
- theksuar rëndësinë e studimit sistematik;
- mbikëqyrur dhe ndihmuar kur është e nevojshme; dhe
- afëruar një vend të përshtatshëm për të studiuar.

Shkollat fillore

Qëllimi i detyrave të shtëpisë është të përforcohen aftësitë që shpjegohen në klasë. Detyrat e shtëpisë duhet të jenë të kenë të bëjnë dhe/ose të jenë të lidhura me Kuadrin e Massachusetts.

Detyrat duhet të jenë një vazhdim i mësimave në klasë që i japin nxënësit mundësinë të (1) rrisë ose praktikojë objektivat e mësimit, (2) të angazhohen në një rregull mendimi me të lartë, (3) përforcojë konceptet dhe të aplikojë ato që ka mesuar, (4) punojë mbi probleme të hapura dhe aftësinë për të shkruar, ose (5) punë projekti.

Mësuesit do të ndjekin udhëzimet e mëposhtme dhe do të bashkërendojnë detyrat që do të japin, në mënyrë që nxënësit të mos mbingarkohen me detyra shtëpie asnjë mbrëmje.

Kopshti - klasa e 2-të	Njohja me detyrat e shtëpisë. Nxënësve mund t'ju kërkohet të mbarojnë detyra që kanë filluar në shkollë ose të praktikojnë me perpara aftësitë në lexim dhe matematikë.
Klasa e 3-të	Në këtë nivel fillojnë detyrat e vërteta. Nxënësve ju caktohet rreth 15 deri 30 minuta detyra shtëpie çdo ditë. Nxënësve ju caktohen detyra shtëpie prej 45 dhe 60 minuta.
Klasa e 4-të	detyra çdo ditë.
Klasat 5-6-ta	Nxënësve ju caktohet nga një orë deri në një orë e gjysmë detyra çdo ditë.

Shkollat e mesme

Detyrat e shtëpisë duhet të jenë praktikë e rregullt për të gjithë mësuesit dhe nxënësit dhe duhet të kenë të bëjnë dhe/ose të jenë të lidhura me MCAS-në dhe Kuadrin e Massachusetts. Detyrat duhet të jenë njëvazhdim i mësimave në klasë që i japin nxënësit mundësinë të (1) rrisë ose praktikojë objektivat e mësimit, (2) praktikojë aftësitë, (3) përforcojë konceptet më të fundit, (4) punojë mbi probleme të hapura dhe aftësinë për të shkruar, ose (5) punë projekti.

Detyrat e shtëpisë me qëllim mësimin mund të ndryshojnë nga dita në ditë për çdo nxënës. Minimumi i detyrave të përditshme të shtëpisë, të dhëna nga mësuesit e shkollës për klasat 6-8, duhet të jenë 120 minuta. Minimumi mesatar i detyrave të përditshme të dhëna nga mësuesit e shkollës së mesme, duhet jetë 45 minuta për lëndë akademike.

Mësuesit janë përgjegjës për të përfshirë detyrat e klasës në planin e tyre të mësimit dhe t'i japin nxënësit udhëzime që:

- Detyrat të jenë të lidhura me objektivat e mësimit që reflektojnë dhe mbështesin Kuadrin e Programit Akademik të Massachusetts, kurrikulat WPS, Planet e Përmirësimit të shkollës, dhe objektivat e WPS.
- Të ofrojnë përvoja mësimi që janë rigorozë, me vend dhe që mund të plotësohen në mënyrë të pavarur nga nxënësi;
- Të sigurojnë që detyrat e shtëpisë të jenë një vazhdim i mësimit që bëhet në klasë, dhe të aplikojnë të njëjtat standarde ecurie siç aplikohet për punën në klasë;

- Të caktojnë detyra shtëpie që janë të qarta dhe të një gjatësie të arsyeshme;
- Të sigurohen që cilësia e detyrave të shtëpisë të jetë më e rëndësishme se sasia;
- Të perfundojnë dhe vleresojnë detyrat, si pjesë e progresit të nxënësit drejt standarteve;
- Të tregojnë se si detyrat e shtëpisë pasqyrohen në notat e nxënësit; dhe
- Të mos caktojnë kurrë detyra shtëpie si dënim.
- Të sigurojnë që të gjithë nxënësit të kryejnë detyrat e dhëna pavarësisht nëse familja ka mundësi të ofrojë teknologjinë ose mediat.

Drejtorët janë përgjegjës për nxitjen e komuniteteve të shkollave që të përkrahin detyrat e shtëpisë si një vazhdim i vërtetë i mësimin nga nxënësi dhe të vlerësojnë përdorimin e detyrave të shtëpisë si pjesë e arritjeve të studentit në procesin e mësimin.

Me ndihmën e nxitjen e mësuesve, drejtorëve, prindërve/kujdestarëve, nxënësit duhet të jenë përgjegjës për plotësimin e detyrave të caktuara të shtëpisë me kujdes dhe vazhdimisht.

Procesi i shpërndarjes së teksteve

Nxënësit dhe prindërit/kujdestarët janë përgjegjës për librat dhe pajisjet e tjera që i jepen nxënësit nga Shkollat Publike Worcester. Të gjitha librat dhe pajisjet duhet të kthehen nga nxënësi dhe në kushtet në të cilat ato janë dhënë. Vjeterime te arsyeshme te librave dhe materialeve janë te parashikuar per shkak te perdorimit nga nxenesit.

Shkollat Publike Worcester kanë të drejtën të kërkojnë pagesa nga nxënësi dhe/ose prindërit/kujdestarët për tekstet shkollore dhe pajisjet të cilat janë humbur apo dëmtuar

Rregullat e Promovimit

Të përgjithshme

Drejtori, pasi të shqyrtojë rekomandimet nga anëtarët e Procesit të Përkrahjes së Nxënësit (SSP) mund të vendosë që një fëmijë, i cili përpiqet po nuk ka pjekurinë ose nuk ka fituar aftësitë bazë, dhe mund të përfitojë nga ana akademike nga përsëritja e vitit, mund të mbahet për një (1) vit tjetër në atë vit akademik. Përpara se nxënësi të mbahet në të njëjtën klasë, të gjithë drejtorët e fillores do të takohen me anëtarët e SSP-së për të shqyrtuar dhe diskutuar tetëmbëdhjetë (18) pika të Shkallës së Lehtë së Përsëritjes (pa asnjë rezultat numerik dhe konferencë me prindërit/kujdestarët e nxënësit).

Drejtori është autoriteti i fundit në nivelin e shkollës, dhe për një arsye të mirë mund të anashkalojë kalimin e kërkesave të subjektivit të përkrahjes. Në raste të tilla, drejtori duhet të paraqesë një deklaratë tek mbikëqyrësi i tij/i saj duke paraqitur arsyet për një përkrahje të tillë dhe hapat që duhen marrë për të ofruar ndreqje të mundshme në nivelin tjetër

Fillorja (klasa e 6-të)

Lëndët promovuese

Klasa e 1-rë

Arti i gjuhës së anglishtes:

(Lexim, gjuhë dhe shkrim)

Klasat 2-6

Arti i gjuhës së anglishtes:

(Lexim, Gjuhë dhe shkrim)

Matematikë

Nxënësit duhet të kalojnë Artin e gjuhës angleze (leximin, gjuhën dhe shkrimin) në nivelin e parë. Nxënësit duhet të kalojnë artin e gjuhës angleze dhe matematikën nga niveli i klasës së dytë deri në klasën e gjashtë.

Nxënësit në klasat 2-6 duhet të kalojnë Artin e gjuhës angleze dhe matematikën çdo vit.

Klasat 7-8

Nxënësit e nivelit të ndërmjetëm duhet të përfundojnë subjektet kryesore akademike dhe kurset e zgjeruara, që janë unike për çdo shkollë. Të gjithë nxënësit e shkollës së ndërmjetme marrin pjesë në edukim fizik siç kërkohet nga ligji i shtetit (L.P.M. Kapitulli 71, Pjesa 3).

Kurset akademike kryesore (gjithë vitin)

- Arti i gjuhës angleze
- Matematikë
- Shkencë dhe Teknologji/Inxhinieri
- Histori dhe Shkenca shoqërore

Kurse specifike/kurse plotësuese mund të përfshijnë:

- Literacy akademik, Studimi Word ose Kurset Leximi Intervenimit
- Shkrim akademik - Kurs shtesë math
- AVID
- Art
- Muzikë
- Teknologji industriale
- Njohuri Kompjuterash
- Edukim fizik Shkencë e familjes/konsumatorit
- Familje / Shkencë Konsumatorit
- Tjera: Kërcim, Teatër, etj.

Për te avancuar, nxënësit duhet të kalojnë artin e gjuhës angleze dhe matematikë, dy (2) subjekte akademike kryesore shtesë dhe dy (2) kurse plotësuese çdo vit. Nxënësit nuk mund të ngelin në anglisht e matematikë në klasat 7 dhe 8 dhe të kalojnë në klasën e 9-të.

Pandershmeria Akademike

Vjedhja, kopjimi dhe falsifikimi konsiderohen të jenë pandershmeri akademike. Për çdo punë që përmban informacion të nënshkruar, si të vetin (e vjedhur), ose është plotësuar

jo ndershmerisht ose me mashtrim, duke përfshirë informacione të marra nga interneti që nuk janë thënë si duhet, mxënësi do të ketë pasojat e duhura, të cilat mund të përfshijnë pezullim dhe kërkon që nxënësi të përsërisë detyrën për kredit. Me thyerjen e ketij rregulli studenti mund të marrë një masë disiplinore si, marrje e një note jo kaluese për detyrën deri në pezullim nga shkolla.

Politika e Frekuentimit të Shkollës

Rishikim

Në përputhje me Ligjet e Përgjithshme të Massachusetts, Shkollat Publike Worcester pranojnë dhe zbatojnë politikën që çdo fëmijë, midis moshës nga gjashtë deri në gjashtëmbëdhjetë vjet, duhet të frkutojë shkollën. Personeli i shkollës dhe prindërit/kujdestarët duhet të punojnë së bashku të sigurojnë që të gjithë nxënësit e Parashkollore/Kopsht deri në klasën e 12të, të frekutojnë shkollën çdo ditë, dhe në kohë gjatë periudhës prej 180 ditëve të kalendarit shkollor.

Shkollat Publike Worcester shikojnë vazhdimisht frekuentimin ditor si një prioritet për suksesin dhe arritjen e nxënësit. Rritja akademike, sociale, emocionale dhe zhvillimi i nxënësit varen nga frekuentimi ditor i nxënësit, pjesëmarrja në klasë dhe ekspozimi i tij në mësim dhe mësimdhënie. Ndërveprimet ditore midis mësuesve dhe nxënësve janë komponentë të pazëvendësueshëm të eksperiencës mësimore. Përveç kësaj, frekuentimi ditor dhe saktësia e shprehive që fitohen gjatë shkollimit janë aftësi thelbësore në jetën e një të rrituri, dhe fillon që nga vitet e moshës parashkollore.

Mungesat e Arësyeshme

Lista e mëposhtme paraqet mungesat të cilat nuk do të llogariten ndaj humbjes së krediteve:

1. **Festat fetare:** Besimi fetar i nxënësit kërkon që nxënësi të mos frekutojë shkollën gjatë festës së posaçme fetare ose që ndjekja e shkollës të mos ndikojë në ritet e kërkuara fetare. Prindi/kujdestari duhet të njoftojë shkollën me shkrim brenda dy (2) ditëve të shkollës përpara ose pas mungesës.
2. **Vdekje e një pjestari të afërt të familjes:** Deri në pesë (5) ditë të njëpasnjëshme zie nëraste raste vdekjesh të një anëtarit të afërt të familjes së nxënësit si: nëna, babai, motra, vëllai. Një (1) ditë për të marrë pjesë në funeralin e gjyshërve, tezeve/hallave, xhaxhallarëve/dajave, kushërinjve, mbesave ose nipërve. Prindi/kujdestari duhet të njoftojë shkollën me shkrim brenda pesë (5) ditësh shkollë pas mungesës.
3. **Paraqitja në gjyq:** Nxënësi është thirrur për tu paraqitur në gjykatë. Nxënësi duhet të jetë dëshmitar, paditës ose i paditur në gjyq. Brenda pesë (5) ditësh shkollë para ose pas paraqitjes së kërkuar në gjyq, prindi/kujdestari duhet të njoftojë shkollën me shkrim dhe të ofrojë dokumentacionin nga gjykata.
4. **Shtrimi në spital:** Prindi/kujdestari duhet të paraqesë në shkollë raportin e daljes nga spitali i cili vërteton shtrimin në spital të nxënësit.

5. **Sëmundje të Zgjatura:** Prindi/kujdestari duhet të paraqesë dokumentacion mjekësor në lidhje me sëmundjen e zgjatur i cili kërkon pezullimin e fëmijës nga shkolla.

Drejtori ka të drejtën të kërkojë opinione mjekësore dhe diagnoza të tjera për sëmundjen që ka shkaktuar mungesat e nxënësit.

Nxënësit të cilët do të mungojnë nga shkolla për më shumë se katërmbëdhjetë ditë të njëpasnjëshme për shkak të sëmundjes ose shtrimit në spital do tu ofrohet mësim në shtëpi ose spital (për më shumë informacion, referohuni tek seksioni Mësim në shtëpi)

Pushimet familjare të marra gjatë sezonit të shkollës konsiderohen mungesa. Familjet duhet të planifikojnë pushimet e tyre gjatë sezonit të zakonshëm të pushimeve. Takimet të cilat nuk janë urgjente duhet të kryhen pas orëve të shkollës.

Vonë për Shkollën/ Shkarkimi i hershëm nga shkolla

Një nxënës i cili nuk ndodhet në vëndin e caktuar të tij/saj në klasë konsiderohet të jetë me vonesë.

Nëse një nxënës fillon shkollën pasi ka kaluar gjysma e ditës akademike, atëherë ai nxënës do të marre mungesë nga shkolla për atë ditë. Nxënësi nuk mund të marrë pjesë në asnjë aktivitet shkollor (p.sh. sporte, kërcime, prom) gjatë pjesës së mbetur të ditës.

Nëse një nxënës largohet nga shkolla përpara se të ketë kaluar gjysma e ditës akademike, atëherë ai nxënës do të marrë mungesë nga shkolla për atë ditë. Nxënësi nuk mund të marrë pjesë në asnjë aktivitet shkollor (p.sh. sporte, kërcime, prom) gjatë pjesës së mbetur të ditës.

Çdo drejtor do të takohet me prindin/kujdestarin dhe personelin e shkollës për të caktuar dhe filluar planin e ndërhyrjes, për nxënësit të cilët kanë arritur numrin 10 të vonesave dhe të largimit nga shkolla.

Përgjegjësia e Personelit Mësimdhënës

Pjesëtarët e personelit mësimdhënës do të regjistrojnë të gjitha mungesat, vonesat, dhe largimet e nxënësve nga klasat e tyre të caktuara. Për shkak se nxënësit mund të mungojnë në disa klasa më shumë se në disa të tjera, çdo pjesëtar i personelit të mësimdhënies është përgjegjës që të njoftojë administratën në rastet kur duhen njoftuar prindërit ose kujdestarët.

Njoftimi për Mungesat e Nxënësve Prindërve/Kujdestarëve të tyre

Prindërit dhe kujdestarët njoftohen nëpërmjet telefonit çdo ditë mbi mungesën e fëmijës së tyre. Pas pesë mungesa të paarësyeshme, drejtori (ose personi i tij/saj në ngarkim) do të njoftojë prindin (prindërit) ose kujdestarin (kujdestarët) me shkrim dhe, kur është e përshtatshme, do të bëjnë kërkesë për mbledhje për të diskutuar mbi frekuentimin e nxënësit. Prindërit do të vazhdojnë të marrin njoftim me shkrim nga shkolla për frekuentimin e fëmijës së tyre në çdo të pestën mungesë.

Gjithashtu prindërit dhe kujdestarët do të marrin informacion nëpërmjet:

1. Raportit mbi Progresin e Përkohshëm (çdo pesë javë në secilën periudhë notash)

2. Dëftesës së notave (çdo dhjetë javë). Dëftesat e notave të shkollave të mesme tregojnë mungesat e nxënësve për çdo klasë dhe shumën e mungesave të nxënësve në shkolla.

Mosdhënia dhe/ose Humbja e Kreditit

Katërbëdhjetë mungesa ose më shumë gjatë vitit shkollor mund të rezultojë në mosdhënien dhe/ose në humbjen e kreditit.

Mungesat e akumuluar si rezultat i përjashtimit nga shkolla nuk ndikojnë në humbjen e kreditit akademik. Nxënësit të cilët kanë munguar për shkak të përjashtimit nga shkolla duhet të shlyejnë detyrat e caktuara, duke përfshirë detyrat e shtëpisë dhe test(et).

Drejtori mund të vendosë nëse të tjeaar rrethana lehtësuese justifikojnë mungesat të cilat nuk meritojnë humbjen e kreditit akademik.

Mungesat pa Arësye

Kur një nxënës akumulon mungesa pa arsye të njëpasnjëshme, drejtori (ose mëkëmësi i tij/saj) mund të kërkojë ndihmë nga Gjykata e të Miturve dhe/ose nga Departamenti i Fëmijëve dhe Familjeve me qëllim që të zgjidhë çështjet mbi frekuentimin.

Rregulli i Frkuentimit të Shkollës së Mesme dhe Kreditet Akademike

1. Frekuentimi i duhur për të marrë kredite.
Një nxënës i cili është rregjistruar në një klasë pritet të jetë i pranishëm sa herë që zhvillohet mësimi. Për vitin shkollor 2016-2017, nxënësit e shkollës së mesme nuk do të marrin kredit kur ata tejkalojnë numrin e mungesave të mëposhtme:
 - Katërbëdhjetë (14) mungesa klase të pajustificuara për një-kredit klasë
 - -Shtatë (7) mungesa klase të pajustificuara për klasa me më pak se një kredit
2. Procedura Administrative për Humbje Kredit
 - Në çdo rast kur një nxënës dështon të marrë kredit për çdo klasë, nota përfundimtare për atë klasë do të rregjistrohet në dokumentat e rekordeve të përhershme të nxënësit.
 - Në rastin kur krediti nuk merret për një klasë që është e detyruar për diplomim (për shembull..., Historia e Amerikës) dhe për të cilën nxënësi ka marrë notë kaluese, kërkohet që klasa të përsëritet.
 - Një minimum prej njëzet e katër kredite (24) nevojitet për diplomim
3. Programi mbi Shlyerjen e Frekuentimit
 - Gjatë vitit shkollor 2016-2017, nxënësit e shkollës së mesme që kualifikohen do të kenë mundësi të marrin pjesë në mënyrë vullnetare në Programin e Shlyerjes së Frekuentimit. Nëpërmjet këtij programi,

nxënësit kanë mundësi të shlyejnë kreditet të cilat i kanë humbur si rezultat i mungesave të njëpasnjëshme. Në mënyrë që nxënësit të kualifikohen për të marrë pjesë në Programin e Shlyerjes së Frekuentimit , duhet të kenë kaluar klasën dhe të kenë midis 15 deri në 22 mungesa. Nxënësit e kualifikuar të cilët kryejnë orë mësimi shtesë përtej ditës së shkollës ose të shtunave paradite do të mund të marrin kreditin e plotë për klasën. Nxënësit të cilët tregojnë interes për këtë program, duhet të kontaktojnë këshilltarin e shkollës së mesme për të marrë më shumë informacion.

4. Procedura e Apelit

- Fushat e mëposhtme do të merren parasysh në procesin e apelit:
Sëmundjet e dokumentuara
Aktivitetet e detyrueshme të sponsorizuara nga shkolla
Ekskursionet të sponsorizuara nga shkolla
Programet Alternative të Edukimit
Arsimim në shtëpi të caktuar nga shkolla
- Apelet për mos marrje parasysh të politikës do të dëgjohen nga drejtori ose mëkëmbësi i tij/saj tek Menaxheri i Zonës.
- Prindi/kujdestari mund të apelojë një vendim një vendim të disfavorshëm të Menaxherit të Zonës tek Shefi i Arsimit/Kryeinspektori.
- Prindi/kujdestari mund të apelojë një vendim të disfavorshëm nga Kryeinspektori i Shkollave tek Komiteti i Shkollës. Apelimet tek Komiteti i Shkollës i duhen paraqitur me shkrim Kryeinspektorit i cili do të vendosë apelin e prindit ose kujdestarit në axhendën e Komitetit të Shkollës për tu shqyrtuar në mbledhjen e ardhme të rregullt. Prindi ose kujdestari do të njoftohet për datën, kohën dhe vendin e mbledhjes të Komitetit të Shkollës.

Shënim: Për largimet dhe lëniet e konfirmuara të mësimin, nuk mund të apelohet.

Rregulli e Transmetimeve Televizive

Shumë herë aktivitetet dhe programe jashtë shkollore të Shkollave Publike Worcester transmetohen në Kanalin Charter 191 WEA-TV, dhe pjesëmarrësit mund të dalin në televizor gjatë këtyre transmetimeve. Ritransmetimi i të gjitha programeve mund të bëhet gjatë gjithë vitit pa njoftuar për orarin.

Siguria e Internetit dhe Rregulli i Pranimit të Përdorimit

Qëllimi

Shkollat Publike Worcester e njohin vlerën e kompjuterit dhe burimeve të tjera elektronike për të përmirësuar mësimin e nxënësit dhe për të përforcuar administrimin dhe funksionimin e shkollës së tij/saj. Shkollat Publike Worcester nxisin përdorimin e

përgjegjshëm të kompjuterëve; rrjeteve kompjuterike; përfshi internetin; dhe burime të tjera elektronike për të mbështetur misionin dhe qëllimin e distriktit tonë.

Është politika e Shkollave Publike Worcester që të: (a) të ndalojnë të tjerët, që të përdorin rrjetin kompjuterik të tyre, ose transmetimin e materialeve të papërshtatshme nëpërmjet Internetit, postës elektronike ose formave të tjera elektronike ose komunikimeve të drejtpërdrejta elektronike; (b) ndalojnë përdorimin e paautorizuar dhe aktivitetet e tjera të jashtëligjshme online; (c) të ndalojnë dhënien, përdorimin ose shpërndarjen e paautorizuar të informacioneve identifikuese të te miturve online; dhe (d) të pajtohen me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve në Internet [Ligji Publik Nr. 106-554 dhe 47 USC 254(h)]. Sistemi i Shkollave Publike të Worcester-it vërteton se shkollat e tij kanë adoptuar dhe zbatojnë politikat e sigurta për internetin si pjesë e ligjit "Të mbrojmë Fëmijët në shekullin e 21-të". Ligji i Mbrojtjes së Fëmijëve në Internet (CIPA), është modifikuar në Aktin e Permiresimit të Dhenave në Internet S. 1492, për të përfshirë edukimin e te miturve, në lidhje me sjelljen e duhur online, duke përfshirë ketu dhe bashkëveprimin me individë të tjerë në faqet e rrjeteve sociale dhe në dhomat e bisedave si dhe ngacmimet dhe përgjigjet në internet. Distrikti ka miratuar kurikulin që të jetë në përputhje me Raportin e fundit FCC dhe rendin FCC 11-125.

Kushtet e Marrëveshjes

Në mënyrë që të përdoren burimet e rrjeteve dhe të internetit, të gjithë nxënësit dhe prindërit/kujdestarët duhet të firmosin dhe të kthejnë deklaratën e cila ndodhet në faqen e mbrapme të kopertines të Manualit të Politikave, dhe ata që janë nën moshën 18 vjeç duhet të marrin lejen e prindërve.

Siguria e Internetit

Shkollat Publike Worcester zbatojnë Ligjin e Mbrojtjes së Fëmijëve në Internet (CIPA), Ligjin e të drejtave të edukimit të familjes dhe fshehtësisë (FERPA) dhe Ligjin e mbrojtjes së fshehtësisë online të fëmijëve (COPPA). Shkollat Publike Worcester do të pajtohen me çdo lloj rregullorë tjetër shtesë shtetërore ose federale, që ka të bëjë me përdorimin e teknologjisë brenda distriktit dhe nëpërmjet përdorimit të infrastrukturës së rrjeteve dhe shërbimeve të distriktit të Shkollave Publike Worcester, që janë të disponueshme nga agjencitë rregullatore vendore, shtetërore dhe federale.

Është vendosur një sistem filtrimi nga një palë e tretë e cila parandalon përdorimin e faqeve të internetit që janë 1) të pahijshme, 2) pornografike, ose 3) që konsiderohen të jenë të dëmshme për të miturit. Distrikti do të monitorojë aktivitet online të përdoruesve. Personeli dhe nxënësit këshillohen të mos hapin, mbajnë apo dërgojnë asnjë gjë që ata nuk duan që të bëhet publike. Ndërkohë që disa faqe janë bllokuar nga ndërhyrja e njerëzve, faqe të tjera janë bllokuar bazuar në një kalkulim, i cili përpiket të dallojë faqe të papërshtatshme. Janë bërë përpjekjet më të mëdha për të bërë një filtër sa më të përpiktë që të jetë e mundur, duke patur parasysh numrin e faqeve në internet. Masat e mbrojtjes ndaj teknologjisë mund të hiqen kur ka personel që mbikëqyr punën dhe në rastin e te miturve, mund të minimizohen vetëm për kërkime në mirëbesim ose qëllime të tjera të ligjshme.

Përdorimi i Papërshtatshëm i Rrjetit

Personeli dhe nxënësit duhet të dinë se disa materiale që mund të gjenden nëpërmjet internetit mund të përmbajnë gjëra që janë të jashtëligjshme, shpifëse, të pasakta ose mundësisht fyese. Interneti duhet të përdoret vetëm për qëllime konstruktive edukimi. Drejtimit dhe dosjet ne internet mund të shikohen herë pas here nga administratorët e rrjetit për të mirëmbajtur integritetin e sistemit.

Deri në masën e mundshme, do të merren masa për të ndihmuar sigurinë e përdoruesve në rrjetet online të kompjuterëve të Shkollave Publike Worcester kur përdoret posta elektronike, dhomat e bisedave, mesazhet e menjëhershme, dhe forma të tjera të komunikimit të drejtpërdrejtë elektronik.

Në mënyrë specifike, sikurse kërkohet nga ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve në internet, parandalimi i përdorimit të papërshtatshëm të rrjetit përfshin: a) përdorimi i paautorizuar, përfshi të ashtuquajturin "piraterine" dhe aktivitete të tjera të jashtëligjshme; dhe b) dhënia e paautorizuar, përdorimi dhe shpërndarja e të dhënave identifikuese të të miturve.

Përdorimet e Papranueshme

Aktivitetet e renditura më poshtë nuk lejohen. Lista e aktiviteteve të përshkruara më poshtë nuk është gjithëpërfshirëse. Shkollat Publike Worcester kanë të drejtën të vendosin, se çfarë përbën sjellje të papërshtatshme ashtu dhe pasojat që mund të dalin.

- Dërgimi ose publikimi i mesazheve ose fotografive fyese
- Përdorimi i gjuhës së pahijshme
- Dhënia e informacionit personal, të tilla si: emri i plotë, numri i telefonit, adresa ose fotografi të identifikueshme pa lejen nga mësuesi dhe prindi ose kujdestari.
- Ngacimimet, fyerjet ose sulmet ndaj të tjerëve (cyber-bullying)
- Dëmtimi ose modifikimi i kompjuterave, sistemeve të kompjuterave ose burimeve të rrjeteve me mjete fizike ose programe të tilla si fshirjet, formatimet, viruset, pirateri, falsifikim, thyerje
- Përpjekjet për të anashkaluar filtrin e përmbajtjes së web nëpërmjet faqeve elektronike proxy apo me anë të mjeteve të tjera.
- Shkelja e ligjeve të të drejtës së autorit
- Përdorimi i kodeve të të tjerëve
- Hyrja në dosjet, punën, skedarët e të tjerëve
- Shpërdorimi me qëllim i burimeve të kufizuara
- Instalimi i çdo programi, shareware ose freeware pa miratimin e drejtorit dhe instalimin nga një personi përgjegjës në shkollë
- Përdorimi i rrjetit për qëllime komerciale, fitim financiar ose mashtrim
- Rrjeti, me kabull ose pa kabull, duhet përdorur vetëm për qëllime edukimi. Çdo pajisje që nuk është e Shkollës Publike Worcester në rrjetet e Shkollave Publike Worcester, do të përdoret vetëm për qëllime edukimi. Ndalohet përdorimi për qëllime që nuk janë arsimore.

Dënimet

Shkelja e çdonjërës prej kushteve të përcaktuara në këtë politikë mund të çojë në humbjen e privilegjeve të përdorimit të kompjuterëve të rrjetit të Shkollave Publike Worcester, në masa disiplinore dhe/ose veprime ligjore të përshtatshme.

Udhëzimet për mesazhet elektronike

Shkollat Publike të Worcester kontrtojnë me palën shitëse për të ofruar telefonata, tekste dhe email për emergjencë dhe informacion. Ligji i Mbrojtjes së Klientit në Telefonin vitit 1991 (TCPA) (Telephone Consumer Protection Act) (dhe amendamentet shtesë) është krijuar për të parandaluar që klientët të marrin telefonata marketingi "rodo" nga telemarketuesit. Duke firmosur broshurën e prindit ju po jepni pëlqim paraprak që distrikti shkollor t'ju kontaktojë ju dhe familjen tuaj me telefon, email, dhe mesazhe me tekst për qëllim informativ dhe emergjent. Nëse nuk dëshironi që të merrni këto mesazhe informuese ju mund të bëni këtë tek www.worcesterschools.org/tcpa. Mesazhet e emergjencës do të vazhdojnë që të dërgohen tek numrat e dhënë të kontaktit, siç autorizohet nga TCPA. Nëse nuk keni asnjë nxënës në distriktin e Shkollave të Worcester dhe keni marrë aksidentalisht një telefonatë, ju lutem telefononi 508-799-3067 për ta hequr numrin nga rekordet tona.

Shënim: Personeli mësimdhënës i Shkollave Publike Worcester nuk është i detyruar ligjërisht të kontrollojë emailet ose sistemet e tjera të mesazheve elektronike. Ju lutemi kontaktoni mësuesin e fëmijës tuaj personalisht për të konfirmuar. Nëse ata i përdorin këto sisteme. Kur përdorni postë elektronike, ju lutemi ndiqni këto udhëzime të rëndësishme: Email-et nuk janë të fshehta. Mësuesit nuk do të përgjigjen nëpërmjet email-it për të diskutuar çështje të diskutueshme, emocionale ose teper të fshehta. Këto çështje duhet të sqarohen nëpërmjet telefonit ose duke kontaktuar personalisht. Email-et duhet të përdoren për informacion të përgjithshëm që nuk është i rëndësishëm. Për shembull, mos përdorni email-e për të informuar mësuesin se fëmija juaj nuk do të kthehet në shtëpi me autobus. Mësuesi mund të mos e lexojë emailin në kohë. Duhet të bëni telefonatë për t'u siguruar që mesazhi është marrë.

Miratimi

Komiteti i Shkollës së Shkollave Publike Worcester e ka miratuar këtë Politikë të Sigurisë dhe Përdorimit të Pranueshëm të Internetit në një mbledhje publike, pas njoftimit të publikut më 21 maj 2009. Kjo politikë e ndryshuar u miratua nga Komiteti i shkollës së Shkollave Publike Worcester në 5 Qershor, 2014.

Rregullat e Ekskursioneve*

Shkollat Publike Worcester kanë adoptuar një Politikë mbi Ekskursionet e cila është në përputhje me kërkesat e Kapitullit 346 të Ligjit 2002, një Ligj që ka të bëjë me Udhëtimet e Sponsorizuara nga Shkolla. Rregulli përcakton procedurat për udhëtimet e nxënësve të sponsorizuara nga shkolla që janë planifikuar ndërmjet mesnatës dhe orës 6.00 të mëngjesit, qëndrimet gjatë natës ose udhëtimet jashtë vendit dhe udhëtimet me anije ose avionë.

Një kopje e këtij rregulli mund të merret në Zyrën e Menaxherit të Zonës.

Rregulli i anulimit: Kryeinspektori ka të drejtën të anulojë një ekskursion të miratuar deri në kohën e nisjes. Në rast anulimi, sistemi i shkollës nuk është përgjegjës për asnjë nga shpenzimet e bëra.

***Shkollat Publike Worcester nuk merrin parasysh ose nuk mbajnë përgjegjësi për udhëtime të financuara privatisht pa autorizimin e drejtorit të shkollës.**

Rregulli i Nderit – Shkolla e Mesme

Statusi i Nderit në Shkollat Publike Worcester, përcaktohet në baze të mesatares së studentit në të gjitha fushat e lendeve kryesore. Lenda përcaktohet si kryesore, kur sjell një minimum prej 1.00 kreditesh.

Kualifikimi

Titulli i nderit të klasit të parë jepet kur nxënësit marrin rezultate 90 ose më shumë në të gjitha lëndët.

Titulli i nderit të klasit të dytë jepet kur nxënësit marrin rezultate 80 ose më shumë në të gjitha lëndët.

Shënim: Nuk ka barazvlefshmëri kursesh.

Roll Nderi Politika– Klasat 7-8

Statusi i titullit të nderit në Shkollat Publike Worcester përcaktohet nga mesatarja e nxënësve individë në të gjitha lëndët kryesore dhe kurset shtesë. Një subjekt i madh është përcaktuar si një kurs vit të plotë ose ekuivalent

E drejta për t'u kualifikuar

Nderi i parë u jepet atyre nxënësve të cilët marrin nota nga 90 e lart në të gjitha lëndët kryesore.

Nderi i dytë u jepet atyre nxënësve të cilët marrin nota nga 80 e lart në të gjitha lëndët kryesore.

Testet e Standardizuara

Gjatë arsimimit të tyre, nxënësit do të nënshtrohen disa testeve standarte të zgjedhura. Një test standart është ai që jepet në kushte të kontrolluara dhe uniforme. Kjo siguron që çdo ndryshim në rezultate (para-dhe pas testit, midis nxënësve etj...) të reflektojë ndryshimet në dije dhe aftësi sesa e palidhura me faktorët si kushtet e testit. Keto teste janë një nga mënyrat e shumta të përdorura nga mësuesit për të vlerësuar dijen e nxënësit dhe atë që ai është në gjendje të bëjë. Këtu përfshihen teste me shkrim ose teste virtuale, detyra me gojë dhe me shkrim observime në klasë dhe dosje me përmbledhje të punëve të kryera nga nxënësit. Këto metoda përdoren për të monitoruar ecurinë e nxënësve, për të përmirësuar praktikatat e mësimdhënies dhe kapacitetin tonë për të siguruar atë që të gjithë nxënësit të

arrijnë dhe të kalojnë nivelin e caktuar dhe të diplomohen nga Shkollat Publike të Worcesterit dhe të jenë të përgatitur për karrierë/universitet. Nxënësit, prindërit e të cilëve zgjedhin për fëmijët e tyre vlerësime standarte jashtë shtetit ose distriktit, nuk do të ndëshkohen akademikisht ose nuk do të përballen me masa ndëshkimore vetëm nëse është e ndaluar nga Komënuelthi i Massachusetts ose nga Shetet e Bashkuara.

Testimet e Distriktit

Mjetet standarte që perdoren për interpretimin e testeve të distriktit janë:

- *Inventari i Rishikuar i Kontrollit të Hershëm (ESI -R; K)* një provim i shpejtë që është dizenuar tju jepet në mënyre individuale nxënësve që fillojnë kopshtin
- *Treguesit Dinamikë të Aftësive Bazë për Lexim dhe Shkrim (DIBELS NEXT; K-1)*: masa të administruara individualisht për rrjedhshmëri për monitorimin e rregullt të zhvillimit të aftësive të hershme në lexim dhe shkrim. Ky mjet përdoret në përgjithësi në kopsht, por mund të administrohet dhe tek nxënësit e klasave të tjera.
- *Fountas & Pinnell Benchmark i vlerësimit të sistemit (Benchmark; k-8)*: ky është një format që vlerëson aftësinë në fjalor, rrjedhshmëri dhe llogjike. Ky provim mund tju jepet fëmijëve nga kopshti deri në klasën e tete, po me shume përdoret në klasën e parë dhe të dytë.
- *Matesi i Ecurisë Akademike (Measures of Academic Progress (MAP))*. Ky test përdoret për të matur ecurinë e studenteve në përgjithësi dhe janë teste të kompjuterizuara adaptive që reflektojnë me përpikëri nivelin e secilit nxënës
 - Qëllimi në fushën e Leximit: (1) Literature; (2) Tekst Informativ, (3) Fjalori Përvetësimi dhe Përdorimi
 - Qëllimi në fushën e Matematikës;
 - Klasa 2-5: (1) Gjeometri; (2) Matje dhe të Dhëna; (3) Numra dhe Zgjidhje problemesh; (4) Zgjidhja e problemeve Algjebrike;
 - Klasa 6+: (1) Gjeometri; (2) Zgjidhje e Problemeve Algjebrike; (3) Statistika dhe Probabiliteti; (4) Sistemi i Vertete dhe Kompleks i Numrave;

Shkollat mund të administrojnë gjithashtu vlerësime shtesë-të përbashkëta (për shembull, ato vlerësime të cilat përdoren gjatë gjithë një niveli të caktuar në një shkollë të caktuar ose në të gjithë distriktin). Kjo gjithashtu siguron që një grup të dhënash është në dispozicion për të gjithë nxënësit nëse një nxënës duhet të ndërrojë shkollën.

Testimi Shtetëror

Nxënësit duhet gjithashtu të marrin pjesë në testimet shtetërore, siç kërkohet nga Ligji për Reformën Arsimore të Massachusetts i vitit 1993 dhe Ligjit Federal Asnje Fëmije të Mos Ngelet Mbrapa (ESSA). Nxënësve në klasat e 3-8 dhe 10-ta u kërkohet të testohen në Artin e

Gjuhës Angleze dhe Matematikë. Pritet që shteti të kalojë në një testim "MCAS 2.0" të ri në Pranverë 2016-2016; megjithatë në momentin e botimit, nuk dihen detajet specifike të implementimit. Lexuesi duhet të konsultojë faqen elektronike të Departamentit të Edukimit të Massachusetts për informacionin më të fundit në adresën: <http://www.doe.mass.edu/Assess/>

Ashtu si në vitet e mëparshme, testet e MCAS-it do të vazhdojnë të administrohen në Shkencë dhe Teknologji/Inxhinieri (klasat 5, 8, 9-12) në 2016-17. Testet e shkollave të mesme që administrohen në klasat 9-12 përfshijnë biologjinë, kiminë, hyrje në fizikë, dhe teknologji/inxhinieri.

Përveç kësaj, një numër i vogël nxënësish "me paaftësitë më të mëdha të cilët nuk janë në gjendje të japin testet standarte të MCAS-it edhe me akomodime" mund të marrin pjesë në Vlerësimin Alternativ të MCAS-it (klasat 3-10) në vënd të testeve të MCAS-it. Vlerësimi Alternativ i MCAS-it përbëhet nga një dosje me materiale të grumbulluara nga mësuesi dhe nxënësi, ku përfshihen mostrat e punës, të dhëna mësimore, videokaseta dhe informacione të tjera mbështetëse.

Vlerësimi i Kuptimit dhe Komunikimit në Gjuhën Angleze nga Shteti-në-Shtet për Nxënësit Fillestarë të Gjuhës Angleze (ACCESS for ELLs)

ACCESS për ELLs do tju jepet nxënësve nga kopshti deri në klasen e 12- të cilët janë cilësuar si nxënës fillestarë të mësimin të gjuhës angleze(ELLs). Rezultatet do të përdoren për të monitoruar ecurinë e nxënësve në nivelin akademik. Pikët raportohen për (aftësitë në dëgjim, në të folur, në të lexuar, dhe në të shkruar) dhe në disa rezultate si (Gjuha e folur, Letërsia, Kuptimi, dhe Aftësitë në përgjithësi).

Sistemi i Mostrave (WSS)

Shkollat gjithashtu administrojnë Sistemin e Mostrave (WSS, gjithashtu i quajtur si Vlerësimi Fillestar për Kopshtin në Massachusetts) në të gjitha kopshtet. WSS përbëhet nga tre elementë të ndërlidhura: lista vëzhgimore, dosje dhe raporte përmbledhëse të punës së nxënësve. Dosje me mostra janë grumbulluar gjatë gjithë vitit dhe ndihmojnë për të treguar ecurinë dhe progresin nëpërmjet ilustrimeve konkrete të porcesit të të menduarit të fëmijës. Udhëzimet mbi zhvillimin dhe listat kontrolluese mbulojnë shtatë aspekte të mëdha të kurrikulumit: zhvillimin personal dhe shoqëror, gjuhën dhe leximin, mendimin matematikor, mendimin shkencor, studimet shoqërore, artet, zhvillimin fizik dhe shëndetin. Kjo ofron strukturë observimeve të mësuesve për nxënësit, ndihma në grumbullimin e të dhënave sistematike për të monitoruar përparimin e nxënësit, dhe ndihmon të identifikojë se cilët fëmijë mësojnë, çfarë kanë filluar të mjeshtrojnë dhe në çfarë aspekte kanë ende nevojë për të punuar.

Akomodimet në Testim

Nxënësit me PIE ose planin 504 mund tu ofrohen akomodime gjatë dhënies së testit. Akomodimi i testit është ndryshimi i mënyrës së të administruarit të testit ose të mënyrës së

të përgjigjurit të nxënësit në test. Akomodimet e testit janë të destinuara të kompesojnë efektet e një aftësie të kufizuar e cila mund të parandalojë nxënësin të kuptojë përmbajtjen e testit dhe përdoren të sigurojnë që të gjithë nxënësit kanë mundësinë të demonstrojnë dijet dhe aftësitë e tyre në vlerësimet e bëra në të gjithë vendin.

Teste të Tjera Për Shkollat e Mesme

Për të monitoruar ecurin e nxeneseve drejt shkollave dhe karrieres së tyre, ata mund të kerkohen që të marrin pjesë edhe në provime të tjera nga klasa 9-12.

Provimet e Klasave të Avancuara (AP (Provimet e AP-Klsat 9-12)) janë vlerësimet e bëra në fund të vitit shkollor. Format i këtij testi mund të ndryshojë dhe mund të përfshijë pyetje që kanë me shume se një përgjigje për të zgjedhur, përgjigje të lira ose ti kërkoj nxeneseve të përgatisin një dosje me punën e tyre. Nxenesit që marrin pikët e duhura (zakonisht me shume se 3, megjithatë edhe keto pikë kualifikimi mund të ndryshojnë në baze të lendeve dhe shkollave) do të kenë mundësi që të marrin kredit për kolegje.

SAT Paraprake (PSAT- Klasat 10-11) u ofrohen të gjithë nxënësve të klasës 10 dhe 11. PSAT është test me shkrim dhe përdoret për të përgatitur nxenesit për SAT, konkurrenca për bursa (për shembull Bursa National E Meritave) dhe vlerëson nivelin akademik të nxeneseve të nevojshme për kolegje. Vlerëson aftësitë në të lexuar, arsyetimin matematikor, dhe të arsyetimin dhe të shkruajturën në mënyrë kritike.

SAT (klasa 11-12) është një provim standart para hyrjes në kolegje që mund të ndihmojë kolegjet dhe universitetet për të identifikuar kandidatet e ardhshëm nëpër shkollat e tyre dhe të bëjë lidhjen e nxeneseve me mundësi edukimi përtej shkolles së mesme. Tre pikët në lexim, matematike dhe hartim raportohen midis 200 dhe 800.

SAT e lendeve të caktuara (klasa 10-11) merret nga nxenes për t'ju treguar kolegjeve aftësitë e tyre të përkryera në lende të caktuara si Gjuha Angleze, histori, matematike, shkenca, dhe gjuhët e huaja. Ky test nuk bazohet në kurikulimin e shkolles por në trendet e përdorura sot në shkollat e mesme.

Accuplacer është një test i avancuar me kompjuter që ofrohet nga intucionet e edukimit të lart që jep informacion për nivelin akademik të personit që testohet për të përcaktuar nëse ato do të përfitonin nga klasa përparimtare përpara se të fillonin kolegjet. Nxenesit në Sistemin Publik të Shkollave në Worcester, mund ta marrin këtë test për të futur në dy institucione të studimit të lart njëkohsisht.

Informacione mbi Testimin

Gjate vitit shkollor nxenesit mund të marrin pjesë edhe në teste dhe programe të tjera (për shembull, MCAS për herë të dytë, testim për diagnostikim). Nepermjet gazetës së

shkolles dhe informacioneve te tjera stafi i shkolles do te lajmerojë prinderit/kujdestaret per keto teste shtese dhe per testet e rregullta.

Për pyetje dhe shqetësime të lidhura me procedurat dhe sigurinë e testit ose për informacion mbi ecurinë e fëmijës ose pjesëmarrjen në test, ju lutemi kontaktoni drejtorin ose mësuesin e fëmijës tuaj. Për pyetje të përgjithshme për testet ose për pyetje ose shqetësime të lidhura me procedurat dhe sigurinë e testit ose për informacion lidhur me ecurinë e fëmijës ose për pjesëmarrjen në test në Shkollat Publike të Worcester-it, ju lutem kontaktoni Amanda Gorham në zyrën e Kërkimeve dhe Përgjegjësisë (508-799-3019) ose me email GorhamA@worc.k12.ma.us). Mund të vizitoni gjithashtu faqen elektronike të Shkollave Publike të Worcester-it në adresën (<http://www.worcesterschools.org>) për informacion mbi testin. Informacion nga Departamenti i Arsimit Fillor dhe të Mesëm të lidhur me vlerësimin e shtetit mund të gjeni në internet me adresën <http://www.doe.mass.edu/Assess/> ose duke kontaktuar Zyrën e Shtetit për Vlerësimin e Nxënësit me numër telefoni (781)-338-3625.

Kërkesat për Diplomim në Shkollën e Mesme

Në mënyrë që të diplomohen të gjithë nxënësit duhet:

- Të marrin rezultate 240 ose më të larta në Artin e Gjuhës Angleze (ELA) dhe Matematikë, në klasen e 10 të Sistemit Gjithëpërfshirës së Vlerësimit të Massachusetts-it (MCAS) ose të marrin një rezultat kalues 220 në ELA dhe Matematikë të testeve të MCAS, dhe të përfundojnë një Plan Diturie Arsimor (EPPO) në përputhje me udhëzimet e përcaktuara nga Departamenti i Edukimit Elementar dhe Sekondar (DESE).
- Të marrin një rezultat kalues prej 220 në një nga lëndet shkencore të Sistemit Gjithëpërfshirës të Vlerësimit të Massachusetts, si : biologji, Kimi, Inxhinieri/Teknologji ose Fizikë.
- Të plotësojnë njëzet e katër (24) kredite
- Nxënësit e Shkollave të Mesme Teknike Worcester duhet po ashtu të plotësojnë kreditet minimale të kërkuara dhe lëndët e kërkuara për diplomim të caktuara nga Komiteti i Shkollës.

Për të marrë diplomën me emrin specifik të një shkolle, një nxënës duhet të plotësojë kërkesat e diplomimit të Shkollave Publike Worcester, të cilat duhet të përfshijnë një minimum prej 10 kreditesh të fituara pikërisht nga ajo shkollë e mesme. Nëse një nxënës ka marrë më pak se 10 kredite por i plotëson kërkesat e diplomimit të Shkollave Publike Worcester, do të ketë të drejtën të marrë një Diplomë të përgjithshme të Shkollave Publike Worcester.

Kërkesat për Lëndët e Detyruara për Diplomim

Klasa e 9-të Duke Filluar nga 2013-2014

4 kredite Anglisht

4 kredite Matematikë

3 kredite në Shkencë dhe Teknologji/Inxhinieri

3 kredite Histori/Shkenca Shoqërore (përfshirë 1 kredit Histori e Botës dhe 2 kredite histori e SHBA-së)

2 kredite Gjuhë e Huaj(e njëjta gjuhë)

1 kredit Art

5 kredite në klasat shtesë të programit

Përveç kësaj, nxënësit duhet të përfundojnë me sukses një klasë të edukimit fizik çdo vit.

Klasa e 10-të, 11-të, 12-të. Nxënësit e regjistruar para 2013-2014

4 kredite Anglisht

3 kredite Matematikë

3 kredite Shkencë dhe Teknologji/Inxhinieri

3 kredite Shkencat Shoqërore(përfshihen 2 kredite të Historisë së SHBA-së)

½ krediti Shëndet

1 kredit Edukim Fizik

1. Duke filluar me nxënësit që u futën në klasën e 9-të në Shtator 2013, Kërkesat për Diplomim nga Shkolla e Mesme u zëvendësuan me kërkesat e Mass Core.
2. Nxënësit të cilët përfundojnë me sukses lëndën e Algjebërës në klasën e 8-të kanë alternativën të marrin (1) kredit të shkollës së mesme i cili do të rregjistrohet në dëftesën e tyre të shkollës së mesme. (Kolegjet e Massachusetts do të pranojnë kurset që janë marrë në klasen e 8-të, nëse nxënësi përfundon me notë "C" ose më mirë kursin e nivelit më lart). Nxënësit që zgjedhin të marrin Algjebërën I në shkollë të mesme nuk do të marrin kredit për Algjebërën që kanë marrë në klasën e 8-të. Nxënësit të cilët kanë merituar 1 kredit në Algjebërë në klasën e 8-të duhet të plotësojnë 4 kredite në Matematikë gjatë viteve të shkollës së mesme.
3. Nxënësit të cilët përfundojnë me sukses dy kurse të Gjuhës së Huaj në klasën e 8-të kanë mundësinë të marrin një(1) kredit të shkollës së mesme i cili do të rregjistrohet në dëftesën e shkollës së mesme. (Pranuesit e Kolegjeve të Massachusetts lejojnë kurse Pregatitore Kolegji për Klasën e 8-të, me kusht që nxënësi të ketë përfunduar me sukses nivelin pasardhës me notën "C" ose më lart). Nxënësit që zgjedhin të marrin kursin e parë të Gjuhës së Huaj në shkollën e mesme nuk do të marrin kredit për kursin e marrë në klasë të 8-të.
4. Qëllimi i dhënies së kreditit për kurse Pregatitore Kolegji të marra në klasën e 8-të është i tillë që nxënësit të kenë mundësi të mëtejshme studimi gjatë kohës që ata

janë në shkollë të mesme. Këto mundësi të mëtejshme përfshijnë por nuk janë të kufizuara në Klasa të Avancuara, Rregjistrim të Dyfishtë, Klasa Virtuale, Shërbime Studimi dhe Kurse Studimi /Pune. Të gjithë nxënësit duhet të plotësojnë 24 kredite në kurset mësimore në shkollë të mesme përveç përmbushjes së kërkesave të tjera ashtu si shkruhen në manualin e rregullave.

5. Përjashtime Shtesë

- a. Nxënësit Fillestarë të Gjuhës Angleze (ELL) të identifikuar nga Testet Standarte të Shtetit të Massachusetts-it (ACCESS) si nxënës me Nivel Zotërues të Anglishtes (EPL) 1,2, 3, 4, ose 5 mund të zëvendësojnë dy klasa të zgjedhura përgatitore kolegji për dy klasa të kërkuara të gjuhës së huaj. Nxënësve të cilët arrijnë nivelin 6 të EPL-it ndërkohë që janë në klasën e 9-të ose të 10-të do tu këkohet të marrin dy klasa të gjuhës së huaj me qëllim që të plotësojnë kërkesat për diplomim.
- b. Nxënësit me aftësi të kufizuara për të cilët vlerësimi psiko-edukativ jep një diagnozë të veçantë për paaftësinë e tyre në të mësuar dhe që përjashton nxënësin nga përfundimi me sukses i një klase të gjuhës së huaj mund të zëvendësohet me dy klasa të zgjedhura përgatitore kolegji në vend të dy klasave të kërkuara të gjuhës së huaj.

<p>Minimumi për Kolegjet Shtetërore dhe Universitetet në Massachusetts</p> <p>Kurset e kërkuara për pranim</p>
<p><i>Agnlisht</i> 4 kurse <i>Matematikë</i> 3 kurse (Algebër I & II dhe Gjeometri ose Trigonometri ose detyra kursi të barazvlefshme <i>Shkencë</i> 3 kurse (përfshi dy me punë laboratorike) <i>Shkenca sociale</i> 2 kurse (përfshi një në histori të ShBA-së) Gjuhë të huaj 2 kurse (në të njëjtën gjuhë)* <i>Elektive</i> 2 kurse (nga lëndët e mësipërme ose nga Arti & Humanizmi ose Shkenca Kompjuterike)</p>

Proceset e Apeleve për MCAS

Shkollat Publike Worcester kryejnë proceset e apelit të Departamentit të Shtetit për Arsimin për nxënësit e arsimit të rregullt dhe të posaçëm të shkollave të mesme të cilët nuk kanë kaluar MCAS. Apelimi për performancën në MCAS është vendosur në 2002 që t’ju japi nxënësve të kualifikuar që nuk e kanë kaluar provimin mundësinë për të demonstruar nepernjë punë se tyre që i arrijnë standartet e vendosura nga shteti në mënyrë që të diplomohen. Ka kërkesa specifike në lidhje me arritjet e studentit në Artet e Gjuhës Angleze, Matematikë dhe Shkenca, Teknologji/Inxhinieri, frekuentim dhe pjesëmarrje në perpjekjet për shlyerje dhe kujdestari. Më shumë informacion për këto procese mund të merret në shkollën e fëmijës tuaj, ose në Zyren e Kerkimeve dhe Rendesise (508-799-3063).

Me shume informacion per apelimin e MCAS mund te gjeni edhe ne internet ne websiting e Ministrise Te Edukimit te Ulet dhe Mesatar <http://www.doe.mass.edu/mcasappeals/>

Rregulli i Vendosjes në Klasa të Avancuara

Vendosja në kurse të avancuara i jep mundësi unike studentëve për të mësuar në mënyrë që të kenë sukses në kolegji. Nxënësit do të marrin pjese në bisedime intensive, zgjidhje problemesh në grupe, dhe mësojnë të shkruajnë qartë dhe bukur, dhe në të njëjtën kohë do të krijojnë aftësi për të menaxhuar, disiplinë dhe dëshirë për të mësuar. Nxënësit që arrijnë pikët 3, 4 ose 5 në Testing e Kursit të Avancuar mund të marrin kredite shkollore për shumicën e kolegjeve katër-vjecare në SHBA. Shkollat Publike të Worcesterit ofrojnë më shumë se 20 Kurse Avancuara në shkollë, në komunitet ose mësim virtual.

Rekomandimet për Regjistrim në Klasat e Avancuara

Nxënësit që janë të interesuar që të regjistrohen në këto Kurse të Avancuara duhet të konsultohen me prindërit, mësuesit dhe këshilltarët e shkollës me qëllim që të diskutojnë gatishmërinë e tyre për këtë mundësi që paraqet sfida gjatë procesit të të mësuarit.

Për të vlerësuar nëse nxënësi është gati ndiqen edhe këta tregues. Këta tregues kanë të njëjtën rëndësi në këtë vlerësim.

- Potencialin e Kurseve të Avancuara duke përdorur rezultatet e PSAT
- Motivimi dhe interesi
- Detyrat e kryera në klasa
- Notat në të njëjtën degë kursesh
- Numri i kurseve që nxënësi ka marrë në të njëjtën degë

Mësuesit mund tju caktojnë punë studentëve gjatë verës që ti përgatisin për kursin. Kurset e verës janë të rekomandueshme, por nuk janë të detyrueshme për notat përfundimtare të nxënësve; mësuesit mund ti heqin për raste specifike kur është e nevojshme .

Provimi i Klasave të Avancuara

Nxënësit të cilën ndjekin Kurset në Vendet e Avancuara, janë përgjegjës për koston e provimeve të këtyre kurseve. Çmimi për një Provim të Klasës së Avancuar është \$ 90.00. Bursa dhe pagesa të ulura janë në dispozicion për nxënësit e përshtatshëm. Informacion më të zgjeruar mund të merrni nëpërmjet Zyrës së Udhëzimit. Nxënësit duhet ta marrin testin e Kurseve të Avancuara në kurse që të marrin kredit për Kurse të Avancuara. Çdo nxënës në Kurset e Avancuara, i cili e kalon kursin, por nuk i nënshtrohet provimit për Klasën e Avancuar, do të marrë kredit si për një kurs të nivelit të nderit (honors, not Advance).

Mesatarja e Pikëve në Përshtatshmëri me Nivelin e Klasës

Niveli i klasës llogaritet në fund të semestrit të 6-të, duke përdorur vetëm lëndët kryesore. Niveli zyrtar i klasës do të llogaritet përsëri në fund të periudhës së parë të rezultate në vitin e fundit, për qëllime të pranimit në Universitet. Niveli i klasës do të llogaritet përsëri

në fund të periudhës së tretë të rezultateve në vitin e fundit, me qëllim që të përcaktohet nxënësi cili do të mbajë fjalimin në ceremoninë e diplomimit, si dhe folesit e tjere .

Mesatarja	A.P.	Honors	Kolegj
100-99	5.3	4.8	4.3
98-97	5.2	4.7	4.2
96	5.1	4.6	4.1
95-94	5.0	4.5	4.0
93	4.9	4.4	3.9
92	4.8	4.3	3.8
91	4.7	4.2	3.7
90	4.6	4.1	3.6
89	4.4	3.9	3.4
88	4.3	3.8	3.3
87	4.2	3.7	3.2
86	4.1	3.6	3.1
85	4.0	3.5	3.0
84	3.9	3.4	2.9
83	3.8	3.3	2.8
82	3.7	3.2	2.7
81	3.6	3.1	2.6
80	3.4	2.9	2.4
79	3.3	2.8	2.3
78	3.2	2.7	2.2
77	3.1	2.6	2.1
76	3.0	2.5	2.0
75	2.9	2.4	1.9
74	2.8	2.3	1.8
73	2.7	2.2	1.7
72	2.6	2.1	1.6
71	2.4	1.9	1.4
70	2.3	1.8	1.3
69	2.2	1.7	1.2
68	2.1	1.6	1.1
67	1.9	1.4	0.9
66	1.8	1.3	0.8
65	1.7	1.2	0.7
64-0	0.0	0.0	0.0

Sistemi i vendosjes së Notave

A=100-90

B=89-80

C=79-70

D=69-65

F=64-0

Kurset e Kolegjit për Nxënësit e Shkollës së Mesme

Nxënësit e shkollës së mesme në Shkollat Publike Worcester, të cilët dëshirojnë të ndjekin kurse të avancuara apo të specializuara, përtej atyre të ofruar në shkollat e tyre të mesme, mund të ndjekin kurse në këto kolegje të zonave:

Anna Maria College

Assumption College

Becker College

Clark University

College of the Holy Cross

Quinsigamond Community College

Worcester Polytechnic Institute*

Worcester State University

*Instituti Politeknik Worcester ofron kurse me pagesa të ulura për nxënësit e shkollave të mesme.

Me rekomandimet e këshilltarit të shkollës dhe me aprovimin e kolegjit/universitetit, nxënësit mund të marrin një klasë kolegji për semestër në akordim me Shkollat Publike Worcester dhe me kolegjin/universitetin individual. I quajtur Regjistrim i Dyfishtë , nxënësit marrin kredit të shkollës së mesme dhe kolegji pa pagesë nga Assumption College, Backer College, Clark University, dhe për klasa të nivelit të kolegjit nga Quinsigamond Community College dhe Worcester State University. Për llogaritjen e GPA-së nxënësit e Shkollave Publike Worcester do të marrin të njëjtën vlerë note të një klase A.P. për çdo klasë kolegji të përfunduar.

ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME TË SHKOLLËS

Rregulli i Hapjes së Shkollës me Vonesë/Mbarimit herët të shkollës/Anullimit të shkollës

Administrata e shkollës do të ushtrojë një nga mundësitë e mëposhtme, kur kushtet e kohës diktojnë një ndryshim në oraret e hapjes së ditës shkollore:

- a) Anullojë shkollën
- b) Të shtyjë një orë hapjen e shkollës
- c) Të shtyjë dy orë hapjen e shkollës
- d) Nëse është në fuqi një hapje me vonesë klase parashkollore për paraditen do të anulohet, dhe do të mbahet klase parashkollore për mbasditen.

Hapja me vonesë e shkollës paradite

Nëse ka një orë vonesë në hapjen e shkollës, të gjitha procedurat e përcaktuara do të shtyhen për një orë. Një vonesë prej dy orësh kërkon që të gjitha procedurat të shtyhen për dy orë. Këto procedura përfshijnë:

- a) kohën e paraqitjes së nxënësit

- b) kohën e marrjes nga autobusi në të gjitha itineraret (p.sh. Nëse normalisht autobusi e merr një fëmijë në orën 7.15 të mëngjesit një orë vonesë do të jetë 8.15 e mëngjesit. Nëse autobusi normalisht e merr nxënësit në orën 7.15 të mëngjesit dy orë vonesë do të jetë 9.15 e mëngjesit.

Mbyllja Më Herët e Shkollës

***Ju lutem vini re.** Kur shkollat mbyllen më herët, të gjitha programet passhkollore do të anulohen.

Administrata e shkollës mund të zbatojë hapat e mëposhtme gjatë kushteve të këqia të kohës, që ndikojnë mbi mbylljen para koheë të shkollës:

Hapi 1 - Niveli 1 Shkollat do të mbyllen në orën 12:45 pasdite

Shkolla Alternative
Burncoat High School
Burncoat Middle School
Doherty Memorial High School
Holy Name
North High School
St. Peter-Marian High School
South High Community School
The Gerald Creamer Center
University Park Campus School
Woodward Day School
Woodward Day Satellite
Worcester East Middle School
Worcester Technical High School

Hapi 2 - Niveli 2 Shkollat do të mbyllen në orën 01:25 pasdite

Canterbury Street Magnet Computer-Based School
Chandler Elementary Community School
Columbus Park Preparatory Academy
Lincoln Street School
Union Hill School
Vernon Hill School

Hapi 3 - Niveli 3 Shkollat do të mbyllen në orën 01:25 pasdite

Challenge and Reach Academies
Norrback Avenue School

Hapi 4 - Niveli 4 Shkollat do të mbyllen në orën 01:25 pasdite

Belmont Street Community School
Claremont Academy
Goddard School of Science and Technology
Roosevelt School
Woodland Academy

Hapi 5 - Niveli 5 Shkollat do të mbyllen në orarin e rregullt **(14:50 pasdite)**

Bancroft School

Our Lady of the Angels School

Hapi 6 - Niveli 6 Shkollat do të mbyllen në orën **14:00 pasdite**.

Chandler Magnet School

Clark Street Developmental Learning School

Flagg Street School

Grafton Street School

Heard Street School

Lake View School

May Street School

McGrath Elementary School

Midland Street School

New Citizens Center Elementary

Quinsigamond School

Rice Square School

Tatnuck Magnet School

Thorndyke Road School

Wawecus Road School

Worcester Arts Magnet School

Hapi 7 - Niveli 7 Shkollat do të mbyllen në orarin e rregullt **(15:10 pasdite)**

Forest Grove Middle School

Sullivan Middle School

Hapi 8 - Niveli 8 Shkollat do të mbyllen në orarin e rregullt **(15:10 pasdite)**

Alhuda Academy **(15:15 pasdite)**

Gates Lane School of International Studies

Nelson Place School

St. Peter Central Catholic Elementary School Venerini Academy

West Tatnuck School

Yeshiva Academy

Orari i Posaçëm:

Burncoat Street Preparatory School 15:25 **Orari i Rregullt**

Chandler Elementary 15:25 **Orari i Rregullt**

City View School 16:10 **Orari i Rregullt**

Head Start 11:45 **Orari i Rregullt**

Jacob Hiatt Magnet School 15:35 **Orari i Rregullt**

New Citizens Center Secondary 13:30

Seven Hill Charter School 15:15 **Orari i Rregullt**

Union Hill K-6 2:55 **Orari i Rregullt**

Elm Park Community School 3:45 **Orari i Rregullt**

Njoftimet mbi Mbylljen/Hapjen me Vonesë të Shkollës

Njoftimet kur shkolla nuk do të funksionojë ose do të hapet me vonesë, do të bëhen me ane te stacioneve të radios dhe të televizorit:

WTAG 580 AM	WORC 1310 AM	WBZ 1030 AM
WXLO 104.5 FM	WSRS 96.1 FM	WCUW 93.1 FM*
WHDH-TV Channel 7	WCVB-TV Channel 5	WBZ-TV Channel 4

*Këto njoftime do të transmetohen në spanjisht ndërmjet orëve 05.00 - 06.00 e mëngjesit në WCUW FM 93.1.

Stacionet radiofonike kanë kërkuar që nxënësit dhe prindërit/kujdestarët të mos telefonojnë që të pyesin për statusin e shkollës.

Përveç kësaj, informacionet në lidhje me ditët kur shkolla është e mbyllur, hapjen me vonesë të shkollës dhe daljes nga shkolla parakohe, do ti gjeni në faqen e internetit të SHPW dhe një mesazh i automatizuar telefonik do të dërgohet tek prindërit/kujdestarët.

Rregullorja dhe Procedura për Pushimet

Rregullorja

Edukimi me cilësi kërkon një ambient të shëndoshë mësimi që u bën të mundur të gjithë studentëve (K-6) të kenë mundësi të kalojnë të paktën 30 minuta pushim në një ditë mësimi. Pushimi gjatë ditës së mësimi është ndërtuar në mënyrë të tillë që të angazhojë nxënësit në aktivitete që zhvillojnë të mesuarit, dhe në aktivitete shoqërore fizike. Një pushim i me ose pa konstrukt duhet shumë rrallë ose nuk duhet t'ju hiqet fëmijëve dhe të përdoret si një formë ndëshkimi. Po ashtu as ushtrime fizike nuk duhen të përdoren si mënyre ndëshkimi. Pushimi nuk duhet të zëvendësojë orën e edukatës fizike.

Drejtori i shkollës mban përgjegjësinë për komunikimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe evaluimin e Rregullores së Pushimit. Drejtori duhet ta rishikojë këtë rregullore me anëtarët e Këshillit të Qendrës së Shkollës çdo vit dhe të paraesë rezultatet e këtij rishikimi tek Drejtori i Zyrës Akademike në Maj të çdo viti.

Udhëzimet e Procedurës

Nëse është e mundur nga koha, pushimi duhet të jetë gjithmonë jashtë, ose nëse situata të detyron ndryshe për një periudhë të caktuar kohe. Nxënësit duhet të jenë në mbikqyrjen e një të rrituri, anëtar i personelit, prind, ose vullnetar i shkollës. Drejtori i shkollës duhet të sigurojë që të gjithë të rriturit kanë njohuritë e duhura të mbështesin nxënësit dhe tju pergjigjen kërkesave. Drejtori duhet të sigurojë që nxënësit kanë aparaturat e duhura për zhvillim. Vende publike, që janë afër me shkollën si për shembull parqe që nuk jane shumë larg nga shkolla mund të përdoren si vend për të luajtur.

Komiteti i shkollës duhet të mbështesë kërkesat buxhetore që janë të nevojshme për të pajisur shkollat fillore me materiale per pushim. Ky akordim do te behet në bazë të numrit

të nxënësve që i jepen çdo shkollë. Drejtori i shkollës duhet të ketë autonominë të zgjerorë shpërndarjen dhe të mbështesë nevojat e nxënësve për pushim.

PRINDËRIT DHE KOMUNITETI

Këshilli Konsultativ i Prindërve

Këshilli Konsultativ i Prindërve për Shkollën

Ligji i Reformës Arsimore të Massachusetts i vitit 1993, Neni 53, kërkon krijimin e këshillave të shkollës në të gjitha shkollat i përbere nga prinderit/kujdestarete nxenesve qe shkojne ne kete shkollë, që përfshijnë prindërit/kujdestar, mësuesit, nxënësit dhe përfaqësuesit e komunitetit dhe të bashkë-drejtuar nga drejtorët e shkollës. Keshilli duhet te kete perfaqesues nga raca dhe ethicitetet e ndryshme qe jane pjese e komunitetit te shkolles. Këshilli do të takohet me drejtorin dhe do të ndihmojë në identifikimin e nevojave arsimore të nxënësve, rishikimin e buxhetit vjetor të shkollës, dhe formulimin e planit të përmirësimit të shkollës. Për më shumë informacion kontaktoni drejtorin e fëmijës tuaj

Këshilli Konsultativ i Prindërve për Arsimit të Posaçëm

Prindërit/kujdestarët e nxënësve me aftësi të kufizuara takohen çdo muaj për tu angazhuar në seanca përgatitore për arsimin e posaçëm. Këto takime u japin mundësi prindërve për të bashkëpunuar dhe shkëmbyer ndërkohë që thellojnë mendimet e tyre mbi burimet e ndryshme që janë në dispozicion për nxënësit me aftësi të kufizuara. Për më shumë informacion telefononi në numrin (508) 799-3093.

Këshilli Konsultativ i Prindërve të Gjithë Qytetit për Planifikimin (CPPAC)

Çdo shkollë përfaqësohet nga dy (2) prindër anëtarë të zgjedhur nga grupi i prindërve dhe drejtorët e tyre. Mbledhjet do të mbahen të Mërkurën e dyte të çdo muaji. Objektivat e CPPAC-së janë:

1. Të përfshijnë prindërit/kujdestarët për të adresuar çështje përkatëse në Shkollat Publike Worcester përfshi integrimin dhe ndryshimin (rritjen/uljen) e regjistrimeve.
2. Për të ofruar një forum të hapur për të diskutuar ndërmjet prindërve/kujdestarëve dhe administratorëve në lidhje me çështjet e shkollës dhe politikave të votuara.
3. Për t'i dhënë anëtarëve të sajë përgjegjësi për të informuar shkollat e tyre përkatëse.

Përfshirja e Prindit Titulli I

Është politika e Shkollave Publike të Worcester-it të veprojë në përputhje me Udhëzimet Jo-Rregullatore të Përshirjes së Prindit në Ligjin Asnjë Fëmijë të Mos Ngelet Mbrapa (Titulli I, Pjesa A, Departamenti i Edukimit të SHBA, 2004) të promovojë

pjesmarrjen e prindërve dhe kujdestarëve ne komunikim kuptimplotë me shkollat dhe të përkrahë të mësuarit akademik të nxënësve. Zyra e Nxënësve të Gjuhës Angleze dhe Përkrahjes Suplementare punon me shkollat, prindërit dhe partnerët nga komuniteti me mënyra të ndryshme që të ndihmojë ngjarjet dhe burimet për përfshirjen e prindërve ne edukimin e fëmijëve të tyre.

Mundësi dhe Mbështetje për prindërit/kujdestarët

- **Bashkëpunim i Komunitetit me Familjet në Worcester**
Familjet në Worcester me fëmijë të moshës 0-8 vjeç.
Lojë Grupesh, grupe prindërishe dhe seanca përgatitore, Program Vizitash në Shtëpi të Fëmijës dhe Prindit. Kontrollë dhe informacion mbi Moshat dhe Fazat e Zhvillimit të Fëmijës.
130 Leeds Street
Old Greendale School
Worcester, MA 01606
Kontakti: Beth Vietze **(508) 799-3136**
- **PPAL Central MA Chapter (Parent/Professional Advocacy League)**
Përkrahje/Informacion për familjet që kanë fëmijë me probleme emocionale, mendore dhe në sjellje.
Kontakti: **Worcester Community Connection Coalition**
Tel: (508) 796-1411
- **Southeast Asian Coalition of Central Mass**
Qendër edukimi dhe me shërbime të shumta për familjet Aziatike.
Southeast Asian Center of Worcester,
484 Main Street, Suite 400
Worcester, MA 01608
Kontakti: Anh V. Sawyer (508) 791-4373
- **Worcester Community Connections Coalition (WCCC)**
484 Main Street, Suite 460
Worcester, MA-01608
Kontakti: Ann Bureau: **(508) 754-1176 X126**
- **The Latino Education Institute**
Shërbime arsimore për studentët latin dhe familjet e tyre.
Gjendet pranë Worcester State University, 537 Chandler Street,
Worcester, MA 01602
Kontakti: kathy Orenge**(508) 798-6507**

- **Parental Stress Line**

Një linjë telefoni që funksionon 24 orë në ditë për prindërit/kujdestarët të cilët dëshirojnë të bisedojnë rreth problemeve që kanë me fëmijët e tyre. Telefonatat janë anonime dhe konfidenciale.

1-800-632-8188

- **Community Healthlink (ish Worcester Youth Guidance Center)**

Shërbime për të Rinjtë dhe Familjet

Konsultime për të rinjtë dhe prindërit, ashtu si dhe për terapi familjare.

275 Belmont Street, Worcester, MA 01604

Tel: 508-791-3261

Rregullat për Personelin Vullnetar

Procesi i aplikimit

Të gjithë vullnetarët e shkollës duhet të plotësojnë aplikimet për vullnetarët. Një kopje duhet të mbahet në zyrën e shkollës dhe një kopje duhet t'i dërgohet Zyrës së Vullnetarëve. Kjo aplikohet për çdo individ i cili ndihmon vullnetarisht në një godinë. Të gjithë vullnetarët duhet të kalojnë në një proces kontrolli përpara se të fillojë shërbimi.

Procesi i kontrollit

Commonwealthi Massachusetts ka vendosur që të gjithë vullnetarët në shkolla, duhet të plotësojnë formularin CORI (Regjistrimi i Informacionit për Shkelësit Kriminalë) për procesin e kontrollit. Ky proces duhet të plotësohet përpara se të fillojë puna vullnetare në çdo program shkollor. Për arsye se kontrollat CORI mund të zgjasin disa javë, të gjithë vullnetarët inkurajohen të plotësojnë formularin CORI, sa më shpejt që të jetë e mundur. Ju lutemi dhe ju bëjmë me dije që kontrolli i CORI-t skadon çdo tre vjet dhe nevojitet të ridërgohet në Zyrën e Burimeve Njerëzore.

Puna e vullnetarëve

Kur një vullnetar kontakton direkt Zyrën e Vullnetarëve dhe do të punojë si vullnetar shkolle, ai/ajo do të vendoset në një shkollë, e cila ka dorëzuar një formular zyrtar te nje

Kërkese për Vullnetarë

Zyra e Vullnetarëve do të kontaktojë drejtorin e godinës ose mëkëmbësin e tij/ të saj për të marrë miratimin, përpara se të vendosë cilindo vullnetarë në shkollë.

Prindërit/kujdestarët vullnetarë të cilët duan të punojnë vullnetarisht në shkollën e fëmijës së tyre duhet të ndjekin udhëzimet e mësipërme.

Organizatat vullnetare

Ka patur një sërë nismash në komunitet për të forcuar programet e punës vullnetare në shkollë.

Disa prej tyre përfshijnë:

- Programin "State Employees Voluntary Leave Services"
- Retired and Senior Volunteer Program (R.S.V.P.)
- Transitional Assistance Program (Zyra e Punëve Sociale)

Këto lloj iniciativash janë shumë specifike ndaj kërkesave për pjesëmarrje. Vullnetarët që janë pjesë e këtyre programeve ose programeve të ngjashme duhet të kontaktojnë Zyrën e Vullnetarëve, për të ndjekur një seancë orientimi dhe për të marrë dokumenta shtesë përpara se të bëjnë punë vullnetare në shkollë. Procesi i kontrollit CORI është një pjesë rutinë e procesit të tyre të kontrollit.

Prindërit vullnetarë të cilët sjellin fëmijët e tyre

Disa prindër/kujdestarë vullnetarë kanë ardhur në shkollë për të kryer një detyrë vullnetare dhe kanë sjellë fëmijët e vegjël me vete. Çdo drejtor është përgjegjës për zhvillimin e një politike konstruktive në bashkëpunim me Këshillim e Shkollës së tij/të saj në lidhje me këtë çështje.

Nëse godina juaj lejon që fëmijët e vegjël të shoqërojnë prindin/kujdestarin vullnetar, këta prindër/kujdestarë duhet të kryejnë një detyrë e cila është e sigurt dhe e padëmshme për fëmijët e vegjël.

Këta vullnetarë nuk duhet të perdorin makineri të tilla si:

- prerëse letre
- makina fotokopjimi

Shumë grupe prindërishe, në të kaluarën, kanë caktuar Bashkësi Përkujdesjeje për Fëmijët brenda grupit që të lejojnë prindërit/kujdestarët të bëjnë punë vullnetare pa qenë nevoja që të sjellin fëmijët e vegjël me ta.

TË GJITHË vullnetarët duhet të shënojnë emrin në zyrë. Prindërit/kujdestarët vullnetarë duhet të firmosin si për veten ashtu dhe për fëmijën i cili i shoqëron.

Rregulli i Medias të Distriktit të Shkollave Publike Worcester

Qellimi: Gjata vitit shkollor, fëmijes tuaj mund t'i jepet mundësia për të publikuar punën ose aktivitetet e tij. Shembujt përfshijnë por nuk kufizojnë: publikim i punës së nxënësit në website(s) të distriktit; publikim i prezantimeve të studentit ose i ngjarjeve në mase të gjera të shkolles në gazeta ose në televizor (Kanali 11 WEA-TV i distriktit ose lajme kombëtare/lokale); dhe fotografi dhe video të studentit "në veprim" në website(s) dhe në gazeta lokale dhe rajonale. Emri dhe initialet e mbiemrit të

studentit (p.sh: Paul F.) jane perdorur per te identifikuar fotografite e tre ose me pak studenteve dhe puna e studentit ne website(s) te distriktit. Kur reporteret vizitojne distriktin, shpesh ata flasin me studente dhe perdorin emrat e tyre te plote ne dhenien e lajmit.

Lajme te Pergjithshme te Medias: Gjate vitit shkollor mund te kete programe ne-shkolle, ngjarje ose takime (si: mbledhje e mbare-shkolles ose ngjarje PTA), te cilat jane te hapura per publikun dhe ku do te behen nje numer i madh fotografish ose xhirimesh nga prinder, media, ose stafi i distriktit te shkolles. Ne kete rast, studentet nuk do te identifikohen me emer dhe presupozohet qe ju jeni dakort. Ne se ju nuk deshironi qe femija juaj te fotografohet ose xhirohet ne keto ngjarje publike, lutemi flisni me drejtorin ose kordinatorin e ngjarjes per t' u siguruar qe femija juaj nuk do te perfshihet ne lajme

Procedura: Cdo prind, i cili nuk deshiron, qe emri, fotografia, ose puna e studentit te publikohet ne website(s) te distriktit, ose te perfshihet ne lajmet e gazetes ose televizorit, duhet te plotesoje dhe ktheje kete formular me librin e studentit tek mësuesi kujdestar

NUMËRATORI TELEFONIK

SHKOLLAT E MESME

Burncoat	(508) 799-3300
Claremont Academy	(508) 799-3077
Doherty Memorial	(508) 799-3270
North	(508) 799-3370
South High Community	(508) 799-3325
The Gerald Creamer Center	(508) 799-3476
Worcester Technical High	(508) 799-1940
Alternative St. Casimir.....	(508) 799-3245
University Park Campus	(508) 799-3591

SHKOLLAT 8-VJECARE

Burncoat	(508) 799-3390
Claremont Academy	(508) 799-3077
Forest Grove	(508) 799-3420
Sullivan Middle	(508) 799-3350
Worcester East Middle	(508) 799-3430
University Park Campus.....	(508) 799-3591
Challenge and Reach Academies.....	(508) 757-3084

SHKOLLAT FILLORE

Belmont.....	(508) 799-3588	May Street.....	(508) 799-3520
Burncoat.....	(508) 799-3537	McGrath.....	(508) 799-3584
Canterbury.....	(508) 799-3484	Midland.....	(508) 799-3548
Chandler Elementary...	(508) 799-3572	Nelson Place.....	(508) 799-3548
City View.....	(508) 799-3670	Norrback.....	(508) 799-3500
Clark Street.....	(508) 799-3545	Quinsigamond....	(508) 799-3502
Columbus Park.....	(508) 799-3490	Rice Square.....	(508) 799-3556
Elm Park.....	(508) 799-3568	Roosevelt.....	(508) 799-3482
Flagg Street.....	(508) 799-3522	Tatnuck.....	(508) 799-3554
Gates Lane.....	(508) 799-3488	Thorndyke.....	(508) 799-3550
Goddard.....	(508) 799-3594	Union Hill.....	(508) 799-3600
Grafton Street.....	(508) 799-3478	Vernon Hill.....	(508) 799-3630
Heard Street.....	(508) 799-3525	Wawecus Road....	(508) 799-3527
Jacob Hiatt.....	(508) 799-3601	West Tatnuck.....	(508) 799-3596
Lake View.....	(508) 799-3536	Woodland.....	(508) 799-3557
Lincoln.....	(508) 799-3504	Worcester Arts....	(508) 799-3575

Dr. James L. Garvey Qendra e informacioneve te prinderve (508)799-3299, (508)799-3068,
 (508)799-3069
 (508) 799-3450

Dr. James Caradonio New Citizens Center (508) 799-3494

ZYRA E MENAXHEREVE

Burncoat/South	(508) 799-3264
Doherty/North/Worcester Technical.....	(508) 799-3221

Politika e Medias së Distriktit të Shkollave Publike Worcester

Qëllimi: Gjate vitit shkollor, fëmijës tuaj mund t'i jepet mundësia për të publikuar punën ose aktivitetet e tij. Shembujt përfshijnë por nuk kufizojnë: publikimin e punës së studentit në website(s) të distriktit; publikimin e prezantimeve të studentit ose i ngjarjeve në masë të gjërë të shkollës në gazeta ose në televizor (Kanali Charter 191 WEA-TV i distriktit ose lajme kombëtare/lokale); dhe fotografi dhe video të studentit “në aktivitet” në website(s) dhe në gazeta lokale dhe rajonale. Emri dhe inicialet e mbiemrit të studentit (p.sh: Paul F.) janë përdorur për të identifikuar fotografitë e tre ose më pak studentëve dhe puna e studentit në website(s) të distriktit. Kur reporterët vizitojnë distriktin, shpesh ata flasin me studentë dhe përdorin emrat e tyre të plotë në transmetimin e lajmit.

Transmetim i Lajmeve të Përgjithshme të Medias: Gjate vitit shkollor mund të ketë programe në-shkollë, ngjarje ose takime (si: mbledhje e mbarë-shkollës ose ngjarje PTA), të cilat janë të hapura për publikun dhe ku do të bëhen një numër i madh fotografish ose xhirimesh nga prindër, media, ose stafi i distriktit të shkollës. Në këtë rast, studentët nuk do të identifikohen me emër dhe presupozohet që ju jeni dakort. Nëse ju nuk dëshironi që fëmija juaj të fotografohet ose xhirohet në këto ngjarje publike, lutemi flisni me drejtorin ose koordinatorin e ngjarjes për t'u siguruar që fëmija juaj nuk do të përfshihet në lajme.

Dispozita të zgjedhura nga Rregulli i Medias të Distriktit të WPS

Lutemi shënoni më poshtë vetëm ato për të cilat ju nuk jepni leje.

Publikim i Punës së Studentit në Internet

Unë/ne nuk japim leje që puna e studentit të publikohet në website(s) të Distriktit të Shkollës.

Publikim i Emrit të Studentit, Mbiemrit, Inicialit të fundit, dhe/ose Fotografive në internet.

Unë/ne nuk japim leje që fotografitë të cilat përfshijnë këtë student, të publikohen në website(s) të Distriktit të Shkollës, duke përdorur emrin dhe inicialin e fundit të tij/saj për të identifikuar atë.

Intervista dhe Fotografi me Gazetat, Radio dhe Reporterë Televizioni

Unë/ne nuk japim leje që kjo/ky student të fotografohet ose intervistohet nga reporterët të cilët raportojnë ngjarjet në Shkollën e Distriktit.

Nëse një nga kutitë nuk është shënuar dhe prindi/kujdestari firmos librin e studentit, leja juaj do të konsiderohet për të gjithë vitin shkollor. Ky vendim mund të ndryshojë në çdo kohë, duke kontaktuar shkollën e fëmijës, me shkrim.

Për të gjithë prindërit dhe kujdestarët

Shkollat Publike Worcester dhe Komiteti i Shkollës e konsideron shkeljen e Rregullit të Armëmbajtjes që gjendet në këtë manual, një çështje serioze. Lutemi rishikoni Rregullin e Medias për Shkollat Publike Worcester në anën e mbrapme të kësaj faqe. Firma juaj më poshte, vërteton që ju e keni riparë atë. Ju lutemi kushtoni pak kohë për të diskutuar me fëmijën tuaj këtë rregull, dhe rregulla të tjera që gjenden në këtë manual.

Rregullat në këtë manual mbulojnë veprimet e nxënësve brenda dhe jashtë territorit të shkollës dhe situatat që kanë të bëjnë me shkollën (përfshi transportin për në shkollë dhe nga shkolla). Rregullat e përcaktuara në këtë manual zbatohen jo vetëm gjatë vitit akademik, por gjatë gjithë programeve pas shkollës dhe programeve verore, duke përfshire këtu Puna për Rinine e Worcesterit, por nuk kufizohen vetëm në këtë program.

Komiteti i Shkollës kërkon që të gjithë prindërit/kujdestarët e nxënësve në Shkollat Publike Worcester të firmosin deklaratën e mëposhtme, për të konfirmuar marrjen e këtij manuali dhe t'ia kthejnë atë shkollës së fëmijëve të tyre.

Si prind/kujdestar i nxënësit brenda Shkollave Publike Worcester, konfirmoj marrjen e Manualit të Rregullave 2016-2017 për Shkollat Publike Worcester. Shkollat Publike Worcester marrin pjesë në Zgjedhjen e Shkollës jashtë distriktit, por nxënësit që banojnë jashtë qytetit mund të ndjekin Shkollat Publike Worcester vetëm, nëse ata pranohen për tu regjistruar në bazë të këtij programi. Nëse pranohem sipas këtij programi, unë deklaroj se banoj në qytetin Worcester.

(Emri i nxënësit)

(Shkolla)

--	--	--

(Firma e prindit/kujdestarit)

(Data)

--	--	--

Nxënësve të Shkollave Publike Worcester të regjistruar në shkollat e mesme ju kërkohet gjithashtu të firmosin më poshtë, për të konfirmuar marrjen e këtij manual i dhe se pranojnë rregullat që përmban ky manual.

(Firma e nxënësit)

--	--	--